

# PROGRAMI BUXHETOR AFATMESEM 2024-2026

## BUXHETI I VITIT 2024



## LËNDA

1. HYRJE.....	1
1.1 PROÇESI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM DHE ROLI I TIJ .....	1
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË.....	3
2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË .....	5
3. PRIORITETET AFATMESME 2024-2026.....	9
3.1 Objektivat Strategjikë.....	9
3.2 Objektivat Specifike.....	10
3.3 Projekte Strategjike .....	13
4. BUXHETI AFATMESËM SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE DHE NJËSIVE SHPENZUESE .....	20
5. PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE TË VETA TË BASHKISË TIRANË PËR PERIUDHËN 24-26 .....	36
5.1.1 Taksa mbi ndërtesën.....	37
5.1.2 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.....	41
5.1.3 Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore.....	42
5.1.4 Taksa e tabelës.....	44
5.1.5 Taksa për fjetjen në hotel .....	46
5.1.6 Taksa mbi truallin.....	47
5.1.7 Taksa mbi tokën bujqësore .....	48
5.1.8 Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme .....	49
5.1.9 Taksa vjetore e mjeteve të përdorura .....	50
5.1.10 Tatimi mbi të ardhurat personale.....	51
5.1.11 Tarifa e pastrimit.....	52
5.1.12 Tarifa për zënien e hapësirave publike .....	54
5.1.13 Tarifa e parkimit.....	55
5.1.14 Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime.....	57
5.1.15 Të ardhura të tjera .....	58
Të ardhura nga pagesat për kopshte, çerdhe e konvikte .....	59
6. PARASHIKIMET BUXHETORE AFATMESME 2024-2026.....	61
6.1 Transfertat nga Buxheti i Shtetit dhe Fonde të mbartura.....	61
6.2 PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN 2024 -2026.....	65
6.1.1 Shpenzime Kapitale.....	70
6.1.2 Shpenzime për Personelin .....	71
6.1.3 Shpenzime Operative dhe të tjera.....	77
7. PLANET E MENAXHIMIT TË RISQEVE QË NDIKOJNË NË PBA 2024-2026 .....	81
7.1 ANALIZA E RISQEVE DHE MASAT PARANDALUESE.....	88
7.2 PARASHIKIMI I PLANIT TË ARKËS PËR VITIN 2024 .....	89

## HYRJE

### 1. 1 PROÇESI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM DHE ROLI I TIJ

Programi buxhetor afatmesëm që po prezantohet është një dokument i cili miratohet çdo vit, nga Këshilli Bashkiak. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu PBA-ja siguron mekanizmat e nevojshme përmes të cilave, objektivat prioritarë, të identifikuar në politikat dhe strategjitë e Bashkisë së Tiranës, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

PBA-ja prezantohet pranë Këshillit Bashkiak së bashku me buxhetin vjetor të vitit 2024 i cili përbën vitin e parë të PBA-së, me qëllim prezantimin me politikat tre vjeçare të financimit të Bashkisë së Tiranës dhe krijimin e një vizioni të qartë për të vlerësuar objektivisht propozimet e Kryetarit të Bashkisë për periudhën afatmesme.

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe realizimin e shpenzimeve për shërbime publike.

Hartimi i projektit buxhetor afatmesëm 2024-2026 është bërë bazuar në ligjin nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore“, të ndryshuar, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar , ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV”, udhëzimit plotësues nr. 6 datë 28.02.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026”.

Qëllimet e Programit Buxhetor Afatmesëm( PBA):

- Krijimi i një lidhje të drejpërdrejtë ndërmjet prioritetëve politike, të shprehura në strategjinë e përgjithshme dhe strategjitë sektoriale të Bashkisë së Tiranës, dhe prioritetëve në shpenzime me qëllim shpërndarjen efektive të burimeve në dispozicion
- Forcimi i disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal
- Inkurajimi i efektivitetit, efijensës dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike dhe alokimin e burimeve
- Një parashikim më të mirë buxhetor mbështetur në objektiva dhe prioritete të vendosura për një periudhë tre vjeçare, për të gjitha programet e shpenzimeve.

Objektivat Programit Buxhetor Afatmesëm( PBA):

- Përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve publike dhe rritja e efikasitetit të përdorimit të fondeve buxhetore, është objektivi parësor i PBA-së, në funksion të të cilit, angazhimi dhe mbështetja serioze e me përgjegjësi të lartë e të gjitha njësive shpenzuese pjesëmarrëse në PBA, mbetet thelbësore për ecurinë e suksesshme të këtij procesi.
- Sigurimi i një shpërndarjeje dhe përdorimi efektiv dhe eficient i burimeve është objektivi nëpërmjet të cilit synohet të arrihet jo vetëm forcimi i lidhjes mes programeve buxhetore dhe alokimit të fondeve por dhe një kuadër i qëndrueshëm planifikimi afatmesëm brenda të cilit planifikohen buxhetet vjetore.

Kush përfshihet në Programin Buxhetor Afatmesëm( PBA):

- a. Aparati i Administratës së Bashkisë së Tiranës
- b. Institucionet e Varësisë

### **Struktura e përgjithshme e Programit Buxhetor Afatmesëm:**

PBA-ja është hartuar në bazë të funksioneve, ku çdo funksion lidhet me disa programe të pushtetit vendor, brenda të cilave janë përfshirë një ose më shumë Njësi Shpenzuese, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse për të cilat janë krijuar këto njësi. Dokumenti i PBA-së, prezanton analitikisht qëllimet, objektivat dhe produktet për çdo program. PBA-ja është hartuar për të gjitha programet e Bashkisë në total 20 dhe është fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe nevojave të komunitetit duke u ndërtuar me Strategjitë 4 vjeçare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë dhe programin politik të Kryetarit të Bashkisë.

Për çdo program janë parashikuar të gjitha shpenzimet që do të shërbejnë për realizimin e objektivave të tij, sipas llojit dhe Njësive Shpenzuese.

Shpenzimet e buxhetit të Bashkisë Tiranë sipas grupeve kryesore janë:

- a. Shpenzimet Administrative (paga, sigurime dhe shpenzime operative dhe korrente)
- b. Fondi i veçantë
- c. Shpenzimet kapitale
- d. Fondi rezervë
- e. Fondi i kontigjencës

## **1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË**

Këshilli Bashkiak me Vendimin Nr. 126 datë 23.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit vjetor të vitit 2023” ka miratuar dhe kalendarin e përgatitjes së PBA 2024-2026. Në zbatim të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë, në rolin e nëpunësit autorizues, me Urdhërin Nr. 13988, datë 05.04.2023 “Për ngritjen e grupit për menaxhim strategjik” ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik i cili është përgjegjës për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të planifikimit për Bashkinë Tiranë, si dhe me Urdhërin Nr. 13989, datë 05.04.2023 “Për ngritjen e ekipeve të menaxhimit të programeve” ka ngritur grupet e menaxhimit të programeve për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026.

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 32, datë 17.03.2023 “Për miratimin e tavaneve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2023-2026” janë miratuar tavanet përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2024-2026, sipas programeve dhe për çdo njësi shpenzuese. Gjithashtu me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 81, datë 20.07.2023 “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2023-2026” janë miratuar tavanet përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2024 - 2026, sipas programeve dhe për çdo njësi shpenzuese.

Në zbatim të Ligjit nr.68 datë 27.04.2027 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe të Udhëzimit Vjetor Nr.6 datë 28.02.2023, pasi u hartua projekt dokumenti i parë i PBA 2024-2026 ju dërgua për rekomandime dhe komente Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të cilët kthyen përgjigje me shkresën me Nr.Prot 11099 datë 19.06.2023 me lëndë: “Dërgohen mendimet mbi programin buxhetor afatmesëm 2024-2026”.

Referuar analizës së bërë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ndër të tjera është cituar se në relacionin shoqëruar është paraqitur një informacion i detajuar për procesin e PBA 2024-2026 lidhur me të ardhurat nga taksat dhe tarifat, faktorët që kanë ndikuar dhe do të ndikojnë në të ardhmen në rritjen e nivelit të të ardhurave si dhe për shpenzimet sipas funksioneve, kategorive ekonomike dhe sipas programeve buxhetore. Raporti për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme është hartuar bazuar në politikat fiskale ekzistuese, në të dhënat historike të arkëtimit dhe trendit vjetor përkatës të ndryshimeve të arkëtimit për këtë taksë, vlerësimet mbi zhvillimet e mundshme ekonomike. Përsa i përket shpenzimeve rekomandohet që në periudhë afatmesme Bashkia Tiranë të synojë që peshën më të madhe të shpenzimeve buxhetore ta zënë shpenzimet për investime duke ulur nivelin e shpenzimeve operative dhe shpenzimeve të personelit. Një tjetër rekomandim është që Bashkia Tiranë në fazën e dytë të përgatitjes së PBA 2024-2026 të bazohet në formatet e përcaktuara në Instrumentin e Planifikimit Financiar.

Në lidhje me këtë pikë Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbetet në kuadër të rekomandimit në lidhje me instrumentin, duke njohur faktin e vështirësive që kanë hasur dhe njësi të tjera vendore për vitin 2023 në plotësimin e formatit të ri të IPF-së dhe planifikimit afatmesëm me tregues performance dhe produkte për cdo program.

Instrumenti i Planifikimit është një diskutim i vazhdueshëm me këtë institucion, duke qenë se instrumenti është një risi në planifikim dhe është një ushtrim shumë kompleks që paraqet vështirësi për zbatim. Pavarësisht sa sqaruar më sipër, në cdo rast, formatet e përdorura për miratimin e PBA janë konform kërkesave ligjore për planifikimin buxhetor, duke përfshirë të gjithë elementët e nevojshëm si pema e programeve me qëllimet e objektivat, pema e produkteve, klasifikimi buxhetor, klasifikimi ekonomik, klasifikimi në bazë artikujsh e llogarish buxhetore, etj., pavarësisht instrumentit që përdoret për ti plotësuar e finalizuar.

### **Konsultimi i Programit Buxhetor Afatmesëm:**

Në përmbyllje të procesit të buxhetimit, janë realizuar sërish dëgjesat dhe konsultimet publike mbi projektbuxhetin 2024-2026.

Bashkia e Tiranës i jep përparësi thelbësore përfshirjes qytetare si hallkë e rëndësishme në vendimmarrje, për sa i përket projekteve, investimeve dhe shërbimeve që ky institucion garanton ndaj qytetarëve të kryeqytetit. Vendimmarrjen me pjesëmarrje Bashkia e zbaton edhe në bazë të parimeve themelore të funksionimit të një qeverisje demokratike dhe të shtetit të së drejtës, parime të tilla si: parimi i transparencës, gjithëpërfshirës, zbatimit të ligjshmërisë, subsidiaritetit etj.

Dëgjesat dhe konsultimet publike mbi projektbuxhetin me pjesëmarrje u realizuan edhe këtë vit duke u ndarë sipas tematikave si: a-Zhvillimi i qytetit–Ekonomia–Inovacioni (infrastruktura, hapësirat publike, urbanizimi, mobiliteti), b-Shërbimi Social dhe Komuniteti (gjelbërimi, pastrimi, uji, rregulli, strehimi), c-Arsimi, Rinia dhe Sporti (arti, kultura, studentët, sporti, shëndeti, trashëgimia, turizmi).

Në këto dëgjesa u paraqitën projektet e nisura tanimë, të cilat do të vijojnë edhe gjatë vitit 2024, si edhe ato risi në punë dhe investime publike, të cilat parashikohen të financohen dhe realizohen gjatë vitit të ardhshëm. Gjithashtu u morën në konsideratë kërkesat dhe sugjerimet e banorëve për përmirësimin e cilësisë së jetesës sipas nevojave për secilën njësi.

Krahas dëgjesave, Bashkia e Tiranës gjatë fazës së hartimit të Projekt-buxhetit 2024 ka zhvilluar edhe një sondazh të opinionit publik për të marrë mendimet, evidentuar nevojat dhe pritshmëritë e qytetarëve lidhur me buxhetin e vitit të ardhshëm, gjithashtu për të marrë një vlerësim për punët dhe realizimin e objektivave të deritanishme.

Në sondazh kanë marrë pjesë më shumë se 1000 qytetarë, kampion i cili është anketuar në disa kanale: qytetarë rastësorë të anketuar ballë për ballë në pikat kryesore në Tiranë, qytetarë që marrin shërbime pranë zyrave të secilës njësi administrative urbane, rurale dhe lagje, si edhe

nëpërmjet anketim online Projekt-buxheti i Bashkisë Tiranë për vitin 2024 (google.com), duke publikuar pyetësoin në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë dhe promovuar në rrjete sociale.


Ndër objektivat strategjike më të realizuar gjatë katër viteve të fundit është vlerësuar “Arsimi për të gjithë” objektivi ky lidhet më së shumti me ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës arsimore, siguria në këto objekte, gjithëpërfshirja etj.

Si projekt strategjik i deritanishëm i vlerësuar më shumë nga të gjithë është “Rijetësimi i Piramidës” ndërsa pyetjes se ku duhet të fokusohet më tepër Bashkia Tiranë për vitin 2024, të anketuarit kanë përzgjedhur “Transportin publik”, si fushën me më shumë rëndësi për t’u patur në fokus gjatë viteve të ardhshëm.

## 2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË

---

Bashkia e Tiranës me një sipërfaqe totale prej 1,111 km<sup>2</sup> kufizohet në veri me bashkitë Vorë, Kamëz dhe Krujë, në verilindje me bashkinë Klos, në lindje me bashkitë Bulqizë dhe Librazhd, në jug me bashkitë Elbasan dhe Peqin dhe në perëndim me bashkitë Rrogozhinë, Kavajë, Durrës dhe Shijak.



Kjo bashki përbëhet nga 24 njësi administrative si dhe 3 Lagje, të cilat janë: 11 Njësitë Administrative Urbane, zonat rurale si Petrela, Farka, Dajti, Zall-Bastari, Bërzhitë, Krraba, Baldushku, Shëngjergji, Vaqarri, Kashari, Peza, Ndroqi dhe Zall Herri si Lagja 12, Lagja 13 dhe Lagja 14.

Tirana është bashkia më e madhe në vend si për nga popullsia, ashtu edhe nga territori. Ajo shtrihet në tri zona gjeografike të veçanta; zona bujqësore në veri, perëndim dhe jug, zona urbane e Tiranës dhe e katër komunave rrethuese, pjesërisht të urbanizuara si dhe zona e thyer malore në lindje. Tirana është një zonë e pasur me burime ujore, pasi përshkohet nga lumenjtë Erzen, Lumi i Tiranës dhe Lumi Tërkuçë. Në territorin e saj ndodhen edhe një numër i konsiderueshëm liqenesh artificiale, të ndërtuara si në zonat malore, ashtu edhe në ultësi. Në territorin e bashkisë së re gjenden edhe Parku Kombëtar i Dajtit.

Qyteti i Tiranës është zemra ekonomike e Shqipërisë, me përqendrimin e numrit më të madh të bizneseve në shkallë vendi si dhe me zhvillimin e industrisë së lehtë. Fuqia ekonomike e Tiranës dallohet te sasia shumë më e lartë e kursimeve dhe e kreditit në rang kombëtar, te të ardhurat tatimore, të cilat në masë dërrmuese realizohen në Tiranë si dhe te zhvillimi i sektorit të ndërtimit.


Njësia Administrative e Kasharit, e cila përfshihet në territorin e bashkisë së re konsiderohet zona më e industrializuar e vendit, si pasojë e përqendrimit të bizneseve dhe industrisë përgjatë autostradës Tiranë-Durrës. Zonat bujqësore të Tiranës janë përqendruar në shkallë të gjerë te blegtoria dhe prodhimet e qumështit, por edhe tek agroturizmi. Zonat kodrinore rreth Tiranës kanë gjithashtu traditë ullirin dhe drurët frutorë.

Në territorin e Tiranës gjenden disa vendburime qymyrguri të pashfrytëzuara, ndërsa aktiviteti më i përhapur sa i përket shfrytëzimit të burimeve natyrore është përpunimi i gurit për ndërtim dhe atij dekorativ.

Sipas të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, popullsia e Tiranës më 1 Janar 2023 llogaritet në 875,529 banorë me një dendësi prej 788 banorë/km<sup>2</sup>. Popullsinë më të madhe e kanë Njësitë Administrative Nr. 2 dhe Nr. 5 ku secila prej tyre zë 10% të popullsisë totale të Tiranës. Kjo lidhet edhe me faktin që këto Njësi kanë sipërfaqe të madhe në krahasim me Njësitë e tjera Administrative të Bashkisë Tiranë. Numrin më të vogël të popullsisë e kanë Njësitë Administrative Shëngjergj dhe Krrabë respektivisht me 0.3% dhe 0.4% të totalit të popullsisë. Në Tiranë 50.62 % të popullsisë e përbëjnë femrat ndërsa 49.38 % meshkujt.



### Popullsia e Tiranës sipas gjinisë




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile pranë Ministrisë së Brendshme

Pjesa më e madhe e popullsisë rreth 64.44 % i përket grupmoshës 18-64 vjeç, grupmoshë kjo që ka vlerë në llogaritjen e forcave të punës.

### Piramida e popullsisë së Tiranës

#### Popullsia e Tiranës



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile pranë Ministrisë së Brendshme

Informacion më i detajuar lidhur me numrin e popullsisë, gjininë dhe dendësinë shpërndarë sipas Njësive Administrative.

Njësia Administrative	Sipërfaqja km2	Numër Banoresh	Femra	Meshkuj	Dëndësia
Njesia Administrative Nr. 1	3.06	51,834	26,398	25,436	16,939
Njesia Administrative Nr. 2	9.58	84,615	43,131	41,484	8,832
Njesia Administrative Nr. 3	2.01	46,186	23,693	22,493	22,978
Njesia Administrative Nr. 4	4.92	66,324	33,765	32,559	13,480
Njesia Administrative Nr. 5	2.87	88,497	45,658	42,839	30,835
Njesia Administrative Nr. 6	5.48	71,117	35,721	35,396	12,978
Njesia Administrative Nr. 7	3.06	78,483	40,484	37,999	25,648
Njesia Administrative Nr. 8	1.95	41,558	21,403	20,155	21,312
Njesia Administrative Nr. 9	2.82	65,696	33,638	32,058	23,296
Njesia Administrative Nr. 10	0.77	27,572	14,421	13,151	35,808
Njesia Administrative Nr. 11	5.21	65,212	32,494	32,718	12,517
Njesia Administrative Baldushk	112.88	5,363	2,507	2,856	48
Njesia Administrative Bërzhitë	72.47	5,956	2,896	3,060	82
Njesia Administrative Dajt	94.64	29,797	14,694	15,103	315
Njesia Administrative Farkë	27.49	27,375	13,525	13,850	996
Njesia Administrative Kashar	39.08	62,871	31,389	31,482	1,609
Njesia Administrative Ndroq	63.31	9,566	4,616	4,950	151
Njesia Administrative Petrelë	67.26	6,930	3,348	3,582	103
Njesia Administrative Pezë	108.25	6,442	3,087	3,355	60
Njesia Administrative Shengjergj	206.34	2,500	1,193	1,307	12
Njesia Administrative Vaqarr	46.69	10,713	5,116	5,597	229
Njesia Administrative Zall Bastar	153.97	5,129	2,451	2,678	33
Njesia Administrative Zall Herr	58.29	12,771	6,058	6,713	219
Njesia Administrative Krrabë	18.63	3,022	1,479	1,543	162
<b>Totali</b>	<b>1,111.03</b>	<b>875,529</b>	<b>443,165</b>	<b>432,364</b>	<b>788</b>

### **3. PRIORITETET AFATMESME 2024-2026** **Prioritetet e Programit Buxhetor Afatmesëm:**

Tirana, një qytet i jetueshëm dhe i aksesueshëm falë përmirësimit të infrastrukturës publike në nivel kapilar; një qytet që zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme duke ruajtur ekuilibrat mes zhvillimit ekonomik dhe zhvillimit social, mbrojtjes së mjedisit dhe adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike; një qytet gjithëpërfshirës që prioritetizojnë ndërtimin e një mjedisi të sigurt për zhvillimin e pjesëmarrjen e të rinjve dhe që garanton mbrojtje dhe përkujdesje për grupet në nevojë.

Programet Buxhetore të deritanishme kanë arritur tashmë objektivat e vendosura dhe Tirana është sot më mirë se në cdo kohë. Kanë përfunduar disa nga projektet e mëdha strategjike; është ndërhyrë në pjesën dërrmuese të lagjeve të qytetit me projekte rigjenerimi urban; është siguruar pastërtia e qytetit dhe reduktuar ndotja; janë shtuar sipërfaqet e gjelbëra; është përmirësuar ndjeshëm infrastruktura në të gjithë çerdhet e kopshtet e qytetit; janë krijuar hapësira të reja rekreative; është rigjallëruar jeta kulturore dhe masivizimi i sporteve.

Bashkia e Tiranës ka hartuar Strategjinë e re 5 vjeçare për Zhvillimin e Qendrueshëm të Tiranës, në përputhje me të gjitha ndryshimet ligjore dhe strategjitë zhvillimore e sektoriale në proces, e cila është tashmë në fazën finale, të konsultimit publik.

Qëllimet kryesore të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026, janë mbështetur pikërisht në objektivat strategjike dhe specifike të Strategjisë 5 vjeçare.

#### **Objektivat Strategjike**

- 1: Zgjerimi dhe përmirësimi i infrastrukturës publike në nivel kapilar dhe lagjet e reja për një Tiranë më të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse.
- 2: Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm që siguron ekuilibër të njëkohshëm të veprimtarive ekonomike, sociale dhe mjedisore.
- 3: Zhvillimi i Tiranës në një bashki më standard europian të jetesës, të gjelbër dhe të përgatitur për të përballuar ndryshimet, përfshi ato klimaterike.
- 4: Përmirësim i sistemit të shërbimeve shoqërore që siguron mbrojtje, zhvillim, pavarësi dhe lehtësi pjesëmarrjeje në jetën e komunitetit.
- 5: Investim afatgjatë për rininë duke zhvilluar politika dhe infrastrukturë që sigurojnë një mjedis të sigurt social dhe ekonomik për një rini aktive dhe me akses të barabartë.

## **Objektivat Specifike**

### **Objektivi Strategjik 1: Zgjerimi dhe përmirësimi i infrastrukturës publike në nivel kapilar dhe lagjet e reja për një Tiranë më të aksesueshme dhe gjithpërfshirëse.**

- Rehabilitim dhe Mobilim infrastrukturor në partneritet me komunitetin për të profilizuar fizionominë e Tiranës Policentrike në të paktën 7 qendra brenda vitit 2025.
- Sigurimi i furnizimit të pandërprerë me ujë të pijshëm (24/7) për të përmbushur nevojat e qytetarëve dhe sistem i përmirësuar i grumbullimit, trajtimit dhe largimit të ujërave të ndotura për të paktën 30% të popullsisë të Tiranës brenda vitit 2027.
- Përmirësimi i shërbimit të transportit publik duke rritur shpejtësinë e lëvizjes në 20 km/h duke rritur me 100% kapacitetin e transportit të udhëtarëve dhe duke rinovuar flotën me autobusë elektrikë për të paktën 3 linja deri në vitin 2027;
- Përmirësimi i organizimit të transportit ndërrurban dhe rrethqytetas duke bërë operacionale 2 Terminalet dhe Stacionin e Tiranës deri në fund të vitit 2027
- Përmirësimi i shërbimit të parkimit publik duke shtuar të paktën 1,500 vendparkime të në sheshe reja dhe duke favorizuar zgjidhjet inovative në informacion dhe kontrollin e territorit deri në fund të 2027
- Infrastrukturë arsimore dhe akomoduese e përmirësuar përmes ndërtimit të 13 shkollave dhe 22 kopshteve e çerdheve të reja si edhe ndërtimit të 3 godinave të konvikteve e rikonstruksionit të 19 godinave të tjera deri në fund të vitit 2027.

### **Objektivi Strategjik 2: Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm që siguron ekuilibër të njëkohëshëm të veprimtarive ekonomike, sociale dhe mjedisore.**

- Rritja e investimeve të huaja me të paktën 50% duke përmirësuar konkurueshmërinë përmes përfundimit të punimeve në TEDA Tirana dhe Teknoparkut si edhe zhvillimit të rrjeteve lidhëse kombëtare dhe ndërkombëtare deri në fund të vitit 2027;
- Mbështetja dhe orientimi i bizneseve vendore drejt artizanatit, inovacionit dhe teknologjive miqësore me mjedisin duke synuar mbështetjen e të paktën 100 bizneseve në vit deri në fund të vitit 2025;
- Administrimi, formalizimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e fondit pyjor, përmes krijimit të Regjistrat Digjital të Fermerëve, përditësimit të Regjistrat të Pyjeve dhe përmirësimit të aksesit në treg deri në fund të vitit 2025;

- Ngritja e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor duke synuar këshillimin e të paktën 3 mijë fermerëve në vit, si dhe mbështetje e fermerëve nëpërmjet skemave të granteve për zhvillimin rural duke synuar mbështetjen e të paktën 200 fermerëve në vit deri në fund të vitit 2025;
- Nxitja e programeve të formimit dhe aftësimit për punë në përputhje me kërkesat e tregut si për të rinjtë dhe për të rriturit me qëllim trajnimin e të paktën 500 individëve në vit deri në fund të vitit 2025
- Forcimi i financave vendore duke rritur të ardhurat me 20% dhe investimet publike me 30% deri në fund të vitit 2027 .
- Nxitjen e industrisë së turizmit urban dhe atij rural përmes përmirësimit të cilësisë dhe sasisë e shërbimeve dhe informacionit për ta, duke synuar rritjen me të paktën 50% të numrit të turistëve që vizitojnë Tiranën deri në fund të vitit 2027;
- Zhvillimi i turizmit të biznesit (MICE), përmes hartimit të një strategjie sektoriale për orientimin e tij si edhe përmes ndërtimit të Qendrës së Konventave dhe Ekspozitave dhe Qendrës Ndërkombëtare të Panairëve deri në fund të vitit 2027.

**Objektivi Strategjik 3: Zhvillimi i Tiranës në një bashki më standard europian të jetesës, të gjelbër dhe të përgatitur për të përballuar ndryshimet, përfshi ato klimaterike.**

- Rigjenerim dhe transformim urban me qëllim rritjen e cilësisë së jetesës, duke rehabilituar 100 blloqe banimi, asfaltuar 750,000 m<sup>2</sup> rrugë, shtruar 40,000 m<sup>2</sup> trotuare dhe pajisur me ndriçim LED 40,000 pika deri në fund të vitit 2027.
- Përmirësimi i sistemit dhe instrumentave për mirëmenaxhimin e emergjencave natyrore, si edhe infrastrukturës kritike me qëllim rritjen e nivelit të ëndrueshmërisë së qytetit kundër ndikimeve dhe pasojave të ndryshimeve klimaterike dhe fatkeqësive natyrore;
- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane duke zëvendësuar të gjithë kontenierët me teknologjinë këmbanë e duke ngritur programe për nxitjen e ekonomisë qarkulluese duke synuar riciklimin e të paktën 20% të mbetjeve deri në fund të vitit 2027;
- Shtimi me të paktën 20% i sipërfaqes së gjelbër dhe reduktimi i gjurmës së karbonit për të paktën 35 objekte publike duke vendosur panele diellore në tarracat e tyre deri në fund të vitit 2027;

**Objektivi Strategjik 4: Përmirësim i sistemit të shërbimeve shoqërore që siguron mbrojtje, zhvillim, pavarësi dhe lehtësi pjesëmarrjeje në jetën e komunitetit.**

- Krijimi i programeve favorizuese për familjet në nevojë duke ofruar një mbështetje shtesë përmes “bonusit social” për 2,800 familje dhe duke mbështetur e orientuar drejt punësimit të paktën 100 familje në vit deri në fund të vitit 2026;
- Ngritja e të paktën 6 qendrave komunitare për fëmijet dhe familjen deri në fund të vitit 2027;
- Diversifikim i programeve vendore me një qasje drejt strehimit social të përballueshëm duke synuar që deri në fund të vitit 2027 numri vjetor i familjeve përfituese të jetë rritur nga rreth 1,000 në mbi 1,500 familje;
- Rritje e përgjegjshmërisë dhe transparencës për barazinë dhe integrimin gjinor në nivel vendor dhe mbështetje financiare për zhvillimin profesional të grave;

**Objektivi Strategjik 5: Investim afatgjatë për rininë duke krijuar një mjedis të sigurt social dhe ekonomik, për një rini aktive dhe me akses të barabartë në të gjitha fushat e jetës dhe me status të konsoliduar për të ardhmen e tyre.**

- Ngritja dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së shërbimeve të përkujdesit social që ofrojnë shërbimet vendore për të rinjtë dhe kategoritë në nevojë duke rritur me të paktën 25% kapacitetin ofrues të këtyre shërbimeve deri në vitin 2026;
- Mbështetje financiare e nismave rinore për të nxitur punësimin dhe vëtpunësimin si dhe rritja e kapaciteteve për tu integruar sa më mirë në tregun e punës duke synuar punësimin e të paktën 1,000 të rinjve deri në vitin 2027;
- Ngritja e një programi special për indentifikimin, mbështetjen dhe promovimin e start-ujeve duke synuar shndërrimin e 50 prej tyre në biznese të mirëfillta deri në fund të vitit 2027;
- Rritja me të paktën 20% e shkollave pjesë e projektit “shkolla si qendër komunitare” dhe nxitja e zhvillimit edhe të aktiviteteve socio-kulturore të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë deri në fund të vitit 2027;
- Pjesëmarrja dhe aktivizimi i të paktën 1,000 të rinjve në proceset e vendimarrjes vendore dhe aktivitetet vullnetare deri në fund të vitit 2027;

Sikurse kemi cituar më sipër, Strategjia është në fazën e konsultimit publik dhe mund të pësojë ndryshime, si rrjedhim i këtij procesi, deri në finalizimin dhe publikimin e saj.

Në vijim paraqesim projektet madhore me rëndësi strategjike të Bashkisë së Tiranës për 3 vjecarin e ardhshëm.

### ➤ **Projekte Strategjike:**

Pas një sërë projektesh strategjike që rigjallëruan jetën e qytetit gjatë mandatit të parë, të dytë dhe të tretë qeverisës si, Projekti i Rigjenerimit Urban të Pazarit të Ri dhe Sheshit Avni Rustemi; Projekti i Bulevardit të ri, Sheshi Skënderbej, Rehabilitimi i Parkut të Madh të Tiranës, Kopshti Zoologjik, Rijetësimi i Piramidës po vijohet me projekte të reja strategjike të cilat synojnë jo vetëm përmirësimin e infrastrukturës por edhe rritjen ekonomike, zhvillime teknologjike dhe rritjen e punësimit në qytet.

### **Projektet strategjike të Bashkisë Tiranë për periudhën 2024-2026:**

- Teatri i ri i Tiranës,
- Zona e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik- TEDA,
- Tirana Policentrike,
- Zgjerimi i Lumit Lana,
- Unazat e Tiranës
- Transporti i Gjelbër në Tiranë – Green Transport Tirana
- Muzeu i Tiranës
- Stadiumi Lojrave me Dorë
- Stadiumi ‘Selman Stërmasi’
- Kopshti Botanik
- Qendra e Konventave, Ekspozitave
- Qendra Ndërkombëtare e Panairëve
- Muzeu i Artit Modern
- Rindërtimi

### **TEATRI I RI I TIRANES**

Kryeqyteti ka nevojë për një godinë të re të Teatrit Kombëtar që plotëson të gjitha standartet ndryshe nga ai ekzistues. Shtëpia e re e aktrimit është konceptuar të jetë si zemra kulturore e Tiranës dhe e gjithë Shqipërisë dhe e dedikuar vetëm për art. Projekti i prezantuar nga një nga studiot më të mëdha ndërkombëtare të arkitekturës në botë, “Bjarke Ingels Group” me qendër në Danimarkë, ofron një godinë të arkitekturës me dizajn modern dhe që krijon një hapësirë unike në qytetin e Tiranës, duke ofruar të gjitha kushtet e nevojshme dhe frymëzuese për zhvillimin e talentit të aktrimit, ashtu edhe për vetë publikun i cili mund të angazhojë imagjinatën.

Projekti gjithashtu garanton një akses të këmbësorëve që përdorin rrugën “Sermedin Said Toptani” në rrugën paralele me të. Hyrja kryesore në teatër është e mundur përmes shëtitores “Murat Toptani”, ndërsa hapësira e sheshit publik në nivelin përdhes, siguron hyrje të mbuluar në teatër, së bashku me hapësirën publike për mbledhje ose argëtim. Me ndërtimin e teatrit të ri aktorët do kenë mundësi të punojnë në ambiente kontemporane, cilësore dhe jo të dëmshme për shëndetin e tyre. Njëkohësisht edhe qytetarët do të kenë mundësi të shijojnë artin e ofruar nga artistët në ambiente të rehatshme me të gjitha kushtet që meriton të ketë një godinë e tillë.

## **ZONA E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK- TEDA**

Zona e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik, TEDA Tirana (Technological Economic Development Area), do të jetë një pol i zhvillimit ekonomik që do të tërheqë Investime të Huaja Direkte në Tiranë duke ndihmuar zhvillimin ekonomik dhe rritjen e punësimit. Sipas studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit të hartuar për implementimin e këtij projekti do të investohen në total 1,505,274,104 Lekë dhe parashikohet të krijohen rreth 5-7 mijë vende pune të reja.

Tirana është tregu më i madh i punës në vend dhe ka një pozicionim mjaft të favorshëm gjeografik sa i përket eksportit. Fuqia punëtore e re dhe e kualifikuar, si dhe pozita mjaft e favorshme gjeografike e vendos TEDA Tirana në një pozicion të favorshëm jo vetëm me TEDA-t e tjera në vend, por edhe me zonat e tjera të ngjashme në rajon.

**Misioni:** Krijimi dhe funksionimi i një Zone Teknologjike të Zhvillimit Ekonomik konkurrenente në tregun global, me prosperitet të lartë dhe e orientuar nga zhvillimi i qendrueshëm ekonomik me mundësi për punësim dhe infrastrukturë konkurruese.

**Qëllimi:** Funksionimi i TEDA Tiranë synon krijimin e një territori të veçantë me një regjim fiskal dhe doganor tepër lehtësues për ushtrimin e aktivitet ekonomik që nxit investimet, hapjen e vendeve të punës dhe rritjen e të ardhurave, përsheptimin e zhvillimit rajonal dhe zgjerimin e lidhjeve ekonomike të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar, futjen e teknologjisë së përparuar dhe përsheptimin e qarkullimit të mallrave dhe kapitaleve.

Një nga konceptet e synuara risi të këtij projekti është ai i “Greenfield” ose, me fjalë të tjera, i personalizuar që në themele. Investitorët e interesuar do të kenë mundësinë të marrin truallin që u nevojitet dhe të ndërtojnë vetë, në bazë të specifikave përkatëse, facilitetet e nevojshme për vendosjen e impianteve të prodhimit. Bashkia Tiranë, në cilësinë e zhvilluesit të zonës, do të përfitojë të ardhura nga tarifat e qiradhënies, mirëmbajtjes dhe shërbimit, por mbi të gjitha llogaritet se do të përfitojë 5–7 mijë vende të reja pune për qytetarët e saj dhe një shtysë domethënëse për rritjen e ekonomisë së kryeqytetit dhe të kontributit të saj në ekonominë e vendit.

## **TIRANA POLICENTRIKE**

Vizioni i Planit të Pergjithshëm të Tiranës është të zhvillojë një metropol policentrik dhe kaleidoskopik i cili do të presë në cdo pjesë të tij një ekulibër të gjetur ndërmjet qytetit dhe



natyrës. Tirana në 2030 synon të bëhet një qytet i aksesueshëm që nxit mobilitetin e qëndrueshëm përmes rrjetit efikas të transportit publik dhe lëvizshmërisë së përbashkët. Një metropol intensiv në rritje brenda kufijve ekzistues, duke rivendosur hapësirat e tij të pashfrytëzuara dhe duke zëvendësuar ndërtesat e vjetra, që konsumojmë sasi të lartë të energjisë me një arkitekturë të re estetike dhe funksionale për mjedisin.

Koncepti i vjetër i zgjerimit dhe zhvillimit urban të Tiranës synonte që kryeqyteti të zhvillohej në mënyrë Monocentrike ku cdo shërbim, funksion kryesor dhe aktivitet parësor zhvillohej në qendër të qytetit. Kjo mund të ketë funksionuar mirë në të kaluarën, por me zhvillimin urban të tanishëm të Tiranës, rritjen e popullsisë dhe për rrjedhim zgjerimin e territorit sjell trafik të rënduar, pabarazi në zhvillimin ekonomik mes zonave qendrore dhe atyre periferike të qytetit, stres urban, ndotje ajri, etj.

Jemi duke zhvilluar Organizimin e Tiranës në disa qendra kryesore dhe dytësore të cilat do të ndihmojnë në procesin e dendësimit me anë të përdorimit të zgjuar të tokës dhe shpërndarjes së funksioneve dhe shërbimeve të njëjta në gjithë territorin. Ky prioritet ka në qendër krijimin e 5 epiqendrave urbane për kapërcimin e dyzimit qendër-periferi dhe për të nxitur zhvillimin e balancuar të qytetit. Kombinati, Bulevardi i Ri dhe zona e ish Unizës Autotraktori në Shkozë janë polet e parashikuara për t'u zhvilluar nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të Planeve të Detajuara Vendore që do të sigurojnë rivitalizimin dhe forcimin e identiteveve sipas karakterit të çdo poli. Përmbushja e këtij objekti do të jetë një nga sfidat kryesore të 4-vjecarit të ardhshëm por që në fund do të sjellë një rikonceptim të strukturës urbane të qytetit, shtimin e pesë zonave atraktive të reja për qytetarët dhe vizitorët e huaj dhe një rritje me rreth 20% të investimeve në këto pole të reja. Polet për të cilat po punohet sot janë:

Poli Verior- Bulevardi i Ri i Tiranës, pasi është përfunduar dhe segmenti i fundit i zgjatimit të bulevardit me sinjalistikë rrugore, korsi të dedikuara autobuzësh dhe bicikletash, ndriçim led dhe gjelbërim. Tashmë do të nisë puna për realizimin e sheshit fundor dhe gjatë 4-vjecarit në vazhdim kjo zonë do të ketë një karakter Fin-Tech, pra do të jetë zona e financave dhe e teknologjisë për qytetin. Gjithashtu, gjatë lumit të Tiranës do të mbizotërojnë korridoret blu dhe të gjelbër me hapësira shlodhëse e rekreative, korsi bicikletash në natyrë të cilat do të promovojnë jetesën e balancuar dhe të shëndetshme në qytet.

Poli Kombinat - Sot po punohet për rivitalizimin e Sheshit Garibaldi dhe godinave të vjetra përreth, ndërkohë që janë bërë shumë investime në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe ndricimit të zonës. Vizioni dhe objektivat tona për 4-vjecarin e ardhshëm synojnë kthimin e Kombinatit në një zonë urbane me karakter kreativ artistik dhe mjeshtëror i cili sjell më shumë mundësi biznesi dhe do të zbatohet modeli i Pazarit të Ri.

Poli ish Uniza Autotraktori në Shkozë. Ky është një pol tjetër për të cilin po punohet për hartimin e planeve të detajuara vendore. Për të kemi parashikuar gjithashtu një sërë investimesh infrastrukturore në qendrat dhe pikat referuese të zonës e cila do të kthehet në pol të mirëfilltë zhvillimi ekonomik dhe zhvillimi i jetës sociale e rekreative për komunitetin duke ngushtuar hendekun dhe diferencat mes saj dhe qendrës së qytetit. Për një pjesë të këtij poli kanë filluar

punimet për përmirësimin e infrastrukturës së qendrës së tij dhe infrastrukturës rrugore, ndriçimit dhe gjelbërimit përreth. Ndërkohë që një pjesë tjetër është ende në fazë projektimi.

## **ZGJERIMI I LUMIT LANA**

Rehabilitimi i Lanës është një tjetër projekt madhor me impakt zgjerimin e aksit infrastrukturor lindje-perëndim, si dhe eliminimin e përmytjeve në segmentet fundore perëndimore të Lanës. Ky projekt i jep fund edhe historisë së gjatë të lumit të qytetit - një histori me tre epoka: (1) atë të informalitetit (2) atë të rikthimit në identitet dhe rigjelbërimit të Lanës, (3) dhe epokën e sotme, zgjerimin e Lanës dhe transformimin e saj në një aks të gjelbër, që kalon tej përtej qytetit, me fokus mobilitetin e qendrueshëm urban, autobusët dhe biçikletat.

Puna për zgjerimin e Lanës po vazhdon dhe Lana do të zgjatet nga Kashari deri në Shkozë. Duke vazhduar nga Lanabrgas e poshtë deri në Kashar. Duke u zgjeruar kështu 2 km në Veri e 2 km në Jug. Disiplinimi i ujrave të një lumi në territore urbane tashmë të zhvilluara, është shumë i rëndësishëm dhe ka një impakt shumë pozitiv në mjedis e komunitet. Përmes kësaj veprë madhore, qyteti do të fitojë shumë përmes disiplinimit të rrjedhës së lumit të Lanës duke ulur rrezikun e përmytjeve, por edhe për krijimin e një ambienti pozitiv. Prania e një lumi për një qytet është shumë e rëndësishme. Disiplinimi i ujrave sjell transformimin e hapësirave publike, duke i transformuar ato në vlera për lagjen duke qenë se Lana ka qënë historikisht një shenjë e rëndësishme në territorin e qytetit dhe ka dhënë drejtimet për zhvillimin e tij.

## **UNAZAT E TIRANËS**

Përmirësimi i situatës së trafikut në Tiranë është një nga sfidat tona më të mëdha me të cilat kemi punuar këto 8 vite dhe do vijojmë të punojmë gjatë 4-vjecarit të ardhshëm. Përfundimi i Unazës së Madhe të Tiranës (Unaza 5-të) përbën një hap të rëndësishëm drejt lehtësimit të trafikut duke qenë se shërben si bypass për transportin e mallrave larg zonës urbane. Unazat i shërbejnë mirëfunksionimit të lëvizjes duke larguar shumicën e trafikut nga zemra e qytetit. Njëkohësisht ato shkurtojnë kohën e lëvizjes duke rritur shpejtësinë dhe ulur koston e udhëtimit. Në planin tonë të lëvizshmërisë së qendrueshme për të cilën sapo kemi filluar punën, unazat do të shërbejnë si shtylla të zhvillimit duke siguruar akses në të gjitha zonat e Tiranës.

Unaza e Madhe e Tiranës përfshin në gjatësinë e saj ura, nyje dhe kryqëzime në nivel me qëllim lehtësimin e impaktit që kjo vepër e madhe infrastrukturore do të ketë në qytet.

Mirëfunksionimi i Unazës së Vogël të Tiranës, Unazës së Ndërmjetme dhe Unazës së Madhe do të çlirojnë qendrën e Tiranës nga trafiku duke e ndryshuar destinacionin e një pjese të rrugëve në hapësira pedonale dhe të lëvizjes me biçikletë.

Unazat do të rrisin cilësinë e lëvizjes, por edhe rëndësinë e Tiranës si një qytet ndërlidhës për të gjithë rajonin duke lejuar kalimin e natyrshëm nga akset lindore në ato veriore e perëndimore dhe duke larguar trafikun e tranzitit ndërrurban nga qendra e qytetit.

Projekti më i rëndësishëm i mobiliteti në qytet, që do të mundësojë lëvizjen e pandërprerë në të gjithë perimetrin e qytetit dhe të shmangë kalimin nëpërmjet qendrës.

## **TRANSPORTI I GJELBËR NË TIRANË**

Objekti i përgjithshëm i këtij projekti i projektit është përmirësimi i ofrimit të shërbimeve në transportin publik si dhe reduktimit të emetimeve të CO<sub>2</sub> dhe ndotësve lokalë, duke kontribuar ndër të tjera, në mbrojtjen e klimës dhe mjedisit si dhe përmirësimet në efikasitetin e energjisë.

Projekti synon ndërtimin e BRT, i cili është një sistem tranziti me cilësi të lartë i bazuar në autobuzë që lëvizin me bateri/energji elektrike dhe që ofrojnë shërbime të shpejta dhe komode me kosto efektive, në kapacitet pothuajse të nivelit të metrosë, por me investime shumë më të vogla. Kjo do të realizohet nëpërmjet ofrimit të korsive të dedikuara për autobusa dhe të aksesueshme nga të gjithë njerëzit, mbledhjen e tarifave jashtë autobuzit me veprime të shpejta dhe të shpeshta. BRT do të ketë prioritet nëpër kryqëzime në referencë me mjetet e tjera të transportit duke e bërë këtë sistem qarkullimi publik më të besueshëm dhe më komod për qytetrët e Tiranës. Linjat që parashikohen në kuadër të projektit janë:

- Tirana e Re (L13 aktuale)
- Unaza (L14 aktuale)
- Kombinat – Kinostudio (L15 aktual)

Projekti përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:

- Realizimi i Autobusëve elektronikë dhe infrastrukturës me tarifim të shpejtë në rrugë;
- Punimet civile përgjatë 3 korridoreve të BRT (përfshirë stacionet e BRT);
- Ndërtimi zonës së autobusëve me infrastrukturë për karikimin e tyre me energji (“e-depo”);
- Ndërtimin e Qendrës së Menaxhimit të BRT dhe informacioni dhe komunikimit të sistemeve (“TIK”); dhe
- Termocentrali opsional fotovoltaik (“PVPP”).

Projekti i Transportit të Gjellbër në Tiranë do të financohet nga KfE, në emër të Republikës Federale të Gjermanisë, nëpërmjet një granti në vlerën 31.5 milionë euro dhe një kredie për Republikën e Shqipërisë, në vlerën 50 milionë euro, e cila do të kanalizohet nëpërmjet një marrëveshje nënhuaje për Bashkinë e Tiranës. Gjithashtu projekti do të ketë financim nga buxheti

i Bashkisë së Tiranës me një fond që parashikohet rreth 29 milionë euro, për një periudhë rreth 5 vjecare.

## **MUZEU I TIRANËS**

Një shembull i mirëfilltë i përpjekjes sonë për të ruajtur me çdo kusht identitetin e Tiranës, siç janë edhe Sarajet e Toptanëve. Do të kenë statusin e një shtëpie muze, ku në njërin kat do të jetë Muzeu Etnografik i Tiranës, kurse kati tjetër do t'i kushtohet përkujtimin të marrëdhënieve speciale Shqipëri-Amerikë, duke qenë se ka qenë selia e parë e legatës Amerikane në Tiranë.

## **STADIUMI LOJRAVE ME DORË**

Pallati i Sportit “Asllan Rusi” u projektua dikur si hangar ku parkoheshin avionët e kohës së Italisë dhe më pas u adaptua në një arenë sportive gjatë viteve të komunizmit, ndërkohë sot është në gjendje të degraduar. Ndaj, shumë shpejt do të fillojë puna për rindërtimin e një pallati të ri të sportit, modern dhe me standarde europiane.

## **STADIUMI ‘SELMAN STËRMASI’**

Me këtë projekt duam të përsërisim historinë e suksesshme të transformimit të Stadiumit Arena dhe zonës përreth, që sot është kthyer në një nga stadiumet më të bukura në Europë dhe një hapësirë e ekselencës urbane. Ndaj, ‘Selman Stërmasi’ do të jetë jo vetëm një stadium modern, me standarde bashkëkohore, por edhe një pol i ri urban, ku ka gjallëri, investime, ekonomi dhe hapësira publike të dedikuara ekskluzivisht për qytetarin.

## **KOPSHTI BOTANIK**

Një qytet në rritje ka gjithnjë e më shumë nevojë për hapësira të reja e të gjelbra. Nëpërmjet planit për zhvillimin e Tiranës, ne i rikthejmë qytetit 55-80% të hapësirës përdhese të çdo trualli që aplikon për leje ndërtimi. Transformime si ai që duam të zbatojmë në Kopshtin Botanik lejojnë krijimin e një mase kritike me hapësirë të gjelbër në një nga zonat më të dendura të Tiranës. Krijon një oaz edukimi në të njëjtën kohë për brezin e ri dhe për forcimin e dashurisë për natyrën.

## **QENDRA E KONVENTAVE, EKSPOZITAVE**

Sot Tirana është një qytet që pret qindra evente në ditë dhe dhjetra konferenca në javë. Me qëllim vazhdimin e transformimit të Tiranës në një qendër të rëndësishme rajonale, falë edhe pozicionimit të saj ideal në qendër të Ballkanit dhe ndërlidhjes së mirë ajrore, projekti ynë për qendrën e konventave dhe ekspozitave do të ndërtojë infrastrukturën e nevojshme për konsolidimin e të ardhmes.

## **QENDRA NDËRKOMBËTARE E PANAIREVE**

Kërkesa për hapësira ekspozuese në Tiranë për sektorët e rëndësishëm që operojnë në treg, tregon se ekziston mundësia dhe nevoja që në kryeqytetin e Shqipërisë të ketë një qendër të qenësishme, e cila ofron shërbime për sektorë të ndryshëm lokalisht e ndërkombëtarisht, për të ekspozuar produktet e tyre në panaire të mëdha e të mirëorganizuara. Kjo qendër do t'i japë Tiranës mundësinë që të organizojë evente të rëndësishme lokale, rajonale dhe ndërkombëtare në sektorët kryesorë të ekonomisë tonë.

## **MUZEU I ARTIT MODERN**

Një mundësi për t'i ekspozuar qytetarët ndaj formave të reja të shprehjes krijuese dhe të kontribuojë në zhvillimin kulturor dhe intelektual të qytetit. Ai do të ketë një ndikim pozitiv në ekonominë lokale, duke tërhequr turistë, duke gjeneruar të ardhura dhe duke krijuar mundësi të reja punësimi. Do të shërbejë edhe si një qendër edukimi për studentët dhe artistët e rinj, si dhe do të ofrojë mundësi për zhvillimin artit bashkëkohor dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore në të njëjtën kohë.

## **RINDËRTIMI**

Që prej vitit 2019, si rrjedhojë e pasojave të tërmetit të 26 Nëntorit 2019 si dhe Pandemisë COVID-2019, Tirana ka qenë përpara një sfide, e cila ka sjellë të nevojshme riorientimin e objektivave strategjike. Në fund të vitit 2019 nisën programet e rindërtimit, fillimisht me subvencionimin e qerasë për familjet e prekura nga tërmeti, dhe më tej në vitin 2020, me akordimin e fondeve buxhetore nga Qeveria, për programet e tjera si, për rindërtimin e banesave individuale, për ndërtimin e infrastrukturës arsimore, publike, ndërtimin e njësive të banimit, akt-ekspertiza, plane të detajuara vendore, grante rikonstruksioni.

Gjatë vitit 2023, ka vazhduar procesi për programet e rindërtimit, të cilat përveçse do t'i japin zgjidhje strehimit të banorëve të prekur nga tërmeti, do të ndikojnë në rimëkëmbjen ekonomike të qytetit. Programet e rindërtimit të nisur në vitin 2020, si një mundësi për të sjellë më tepër zhvillim në zonat e prekura, dhe jo vetëm riparimin e dëmeve të shkaktura, janë programe ambicioze që kanë synuar rikonceptimin tërësor të zonave të prekura, në shumicën e rasteve. Si të tilla, këto projekte kërkojnë një shtrirje kohore të nevojshme për arritjen e synimeve e objektivave dhe zbatimi i tyre do të vijojë edhe gjatë vitit 2024.

#### **4. BUXHETI AFATMESËM SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE DHE NJËSIVE SHPENZUESE**

Në këtë kapitull të PBA-së do të japim informacion në mënyrë të përmbledhur mbi njësitë shpenzuese: Aparati i Bashkisë dhe Institucionet e Varësisë lidhur me PBA-në dhe konkretisht qëllimet dhe objektivat për secilin nga programet buxhetore renditur si më poshtë:

1. 01110: Planifikim, menaxhim dhe administrim
2. 03140: Shërbimet e Policisë Vendore
3. 03280: Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile
4. 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik
5. 04220: Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve
6. 04240: Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit
7. 04260 :Administrimi i pyjeve dhe kullotave
8. 04520: Rrjeti rrugor
9. 04570: Transporti Publik
10. 05100: Menaxhimi i mbetjeve
11. 06140: Planifikimi Urban Vendor
12. 06210: Programi I Zhvillimit
13. 06260: Shërbimet publike vendore
14. 08130: Sport dhe argëtim
15. 08220: Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore
16. 09120: Arsimit bazë përfshirë arsimin parashkollor
17. 09230: Arsimit i mesëm i përgjithshëm
18. 10430: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët
19. 10661: Strehimi social
20. 04910: Fondi rezervë
21. 04940: Fondi i Kontigjencës

## **PROGRAMI PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM**

Njësitë shpenzuese: Aparati i Bashkisë Tiranë  
Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore

Në këtë program buxhetor përfshihen të gjithë objektivat si më poshtë:

### Aparati i Bashkisë Tiranë

#### **a. Shërbimi i Stafit të Administrim & Menaxhim;**

- Këtu përfshihen shërbimet e dhëna nga stafi Bashkisë së Tiranës, Kryetari, Nënkyetarët, kabineti, drejtuesit dhe specialistët e lidhur me funksionet mbështetëse si Burimet Njerëzore, Financa, IT, Juridike, Prokurime, Auditit, etj. (përfshirë NJA, kryepleqtë). Paga e Pagave dhe sigurimeve për stafin.

#### **b. Akte të miratuara nga Këshilli Bashkiak;**

- Shërbime të ofruara nga Këshilli Bashkiak dhe stafi i tij kundrejt administratës dhe komunitetit. Paga e honorareve për anëtarët e KB dhe shpenzimeve të tjera për funksionimin e KB.

#### **c. Mirëmbajtja e Infrastrukturës dhe Funksionimi i Aparatit të Bashkisë;**

- Funksionimi dhe mirëmbajtja e Infrastrukturës fizike të bashkisë përmes sigurimit të shpenzimeve korente apo kapitale për ujë, energji elektrike, internet, telefon, mirëmbajtje, kancelari, karburant dhe mirëmbajtje për mjetet e transportit, pajisje apo furnitura të tjera IT, etj.

#### **ç. Përbushja e Detyrimeve Gjyqësore;**

- Ndjekja e çështjeve gjyqësore dhe shlyerja e detyrimeve financiare që rrjedhin nga vendimet gjyqësore.

#### **d. Nëpunës të trajnuar;**

- Zhvillimi i burimeve njerëzore përmes trajnimeve apo programeve kualifikuese të zhvilluara nga vetë Bashkia apo palë të treta (p.sh. ASPA, projekte të ndryshme, etj.) Këtu do të përfshihen të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me trajnimet, si p.sh. materialet, qera ambiente trajnimi, paga për trajnuesit, shpenzime transporti, akomodimi, dieta, etj.

#### **dh. Transparenca publike;**

- Shërbime dhe kostot përkatëse të printimit (ftesa, broshura, baner, city light, kartolina, albume), prodhim spoti promovues, mbështetje për hostimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e ëeb-site, promovimi i aktiviteteve në rrjetet sociale, etj.

### Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifa Vendore:

- Këtu përfshihen të gjitha aktivitetet dhe shpenzimet e lidhura me këtë drejtori, duke filluar nga kostot e personelit; shpenzime korente apo kapitale për funksionimin (utilitare, karburant, kancelari, etj.) apo mirëmbajtje (automjetesh apo infrastrukture tjetër fizike); shpenzimet për dieta, transport, etj.; shpenzime për promovime apo fushata sensibilizuese; shpenzimet për barrën siguroese dhe hipotekore, urdhra bllokimi, pagesa per RBS nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, etj.
- Asistenca dhe nxitja e tatimpaguesve në mënyrë që të likuidojnë detyrimet në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor. Sigurimi dhe zgjerimi i bazës së taksueshme, rritja e numrit të taksapaguesve, dhe reduktimi i elementëve të evazionit.

### **PROGRAMI “SHËRBIMET E POLICISË VENDORE”**

Njësitë shpenzuese:

Aparati i Bashkisë Tiranë  
Policia Bashkiake

Në këtë program buxhetor përfshihen objektivat si më poshtë:

- Përfshihen të gjitha aktivitetet e Policisë Bashkiake në lidhje me inspektimet e patrullimet për parandalimin e kundravajtjeve administrative (shpenzime karburant, automjete, uniforma); Kostot e personelit të policisë bashkiake (paga dhe sigurime), etj.

### **PROGRAMI “MBROJTJA NGA ZJARRI DHE MBROJTJA CIVILE”**

Njësitë shpenzuese:

Aparati i Bashkisë Tiranë  
Drejtoria e MZSH-së  
Drejtoria e Emergjencave Civile

Në këtë program buxhetor përfshihen të gjithë objektivat si më poshtë:

#### 1. Aparati i Bashkisë Tiranë, Drejtoria e MZSH-së

##### **a. Raste të menaxhuara të zjarrit dhe shpëtimit;**

- Krijimin e gadishmërisë së duhur njerëzore, mjete dhe materiale për t'ju përgjigjur në kohë rasteve të zjarrit dhe shpëtimit në objekte banimi, pyje dhe kullota, aksidente në rrugë, etj. Këtu do të përfshihen njëkohësisht edhe aktivitetet dhe kostot përkatëse në lidhje me marrjen e masave parandaluese të zjarrit apo aksidenteve, përfshirë mjete apo materiale të nevojshme si dhe fushata të ndryshme sensibilizuese.

##### **b. Punonjës zjarrfikës të trajnuar;**



- Zhvillimi i stafit në lidhje me proceset e trajtimit të rasteve të zjarrit dhe shpëtimit përmes trajnimeve apo programeve kualifikuese të zhvilluara nga vetë njësia apo palë të treta (p.sh. MB, projekte të ndryshme, etj.) Këtu do të përfshihen të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me trajnimet, si p.sh. materialet, qera ambiente trajnimi, etj.

## 2. Aparati i Bashkisë, Drejtoria e Emergjencave Civile:

### *a. Familje të dëmshpërblyera për dëme nga fatkeqësitë natyrore;*

- Shpenzimet e parashikuara në buxhetin e Bashkisë për dëmshpërblimin e familjeve të cilat preken nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore.

### *b. Familje të dëmshpërblyera për dëme nga zjarri;*

- Shpenzimet nga buxheti i Bashkisë për shpërblimin e familjeve të dëmtuara nga zjarri sipas legjislacionit për mbrojtjen civile

### *c. Shërbime të mbrojtjes civile*

- Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në fushën e mbrojtjes civile.

### *d. Shërbime të mbrojtjes civile*

- Shpenzime kapitale që përfshijnë marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe reabilituese në objektet infrastrukturore që përbëjnë kërcënim serioz për jetën e njerëzve, pronat e tyre dhe mjedisin.

## **PROGRAMI “MBËSHTETJE E ZHVILLIMIT EKONOMIK”**

Njësiti shpenzuese:

Aparati i Bashkisë Tiranë

Agjencia e Administrimit të Tregjeve

Në këtë program buxhetor përfshihen të gjithë objektivat si më poshtë:

### 1. Aparati i Bashkisë përfshin:

#### *a. Plani Strategjik i Zhvillimit;*

- Ky produkt përfshin të gjitha aktivitetet dhe kostot përkatëse në lidhje me hartimin apo rishikimin e planit strategjik të zhvillimit të.

#### *b. Mbështetje me grante për biznesin e vogël;*

- Ky produkt paraqet buxhetin e caktuar nga Bashkia Tiranë për skemën e granteve konkurrese që do të akordohen me qëllim zhvillimin e startup-eve, biznesit të vogël, etj.

#### *c. Promovimi i Biznesit dhe zhvillimit Ekonomik;*

- Zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme me qëllim ndihmesën dhe promovimin e biznesit dhe zhvillimit ekonomik.

#### *ç. Shërbimi i Stafit të zhvillimit të Turizmit;*

- Ofrimi i shërbimit turistik dhe pagesa e pagave e sigurimeve për stafin e turizmit dhe mbështetjen operative.

**d. Promovimi i Turizmit;**

- Promovimi i turizmit realizohet, por nuk kufizohet në shërbimet e Zyrës së Info Point, promovimi i destinacioneve të ndryshme turistike; hartimi dhe shpërndarja e hartave turistike, udhërrëfyesve, etj.; realizimi i aktiviteteve të ndryshme promovuese si dita botërore e turizmit; etj.

**2. Agjencia e Administrimit të Tregjeve përfshin:**

**a. Tregje të inspektuara;**

- Ky produkt përfshin aktivitetet dhe kostot që lidhen me inspektimin dhe kontrollin e vazhdueshëm në pikat e prodhimit dhe tregtimit të produkteve blektoriale dhe bujqësore. Këtu do të përfshihen si shpenzimet e personelit, ashtu edhe ato të operimit të shërbimit.

**b. Subjekte të sistemuara në Tregun e Ushqimeve dhe Gjësë së Gjallë;**

- Materiale konsumi, energjia elektrike, shërbimi dhe materiale të tjera mirëmbajtjeje, materiale hidraulike, shpenzime mirëmbajtjeje kaldaje, materiale ndricimi, pagesa e ujit, shpenzime pastrimi dhe disinfektimi, shpenzime sigurimi, etj. për tregun ushqimor.

**c. Mbështetje për infrastrukturën e tregjeve si dhe rritjen e kapaciteteve përmes ngritjes dhe funksionimit të tregjeve të reja vendore dhe të rrjetit të tregtisë.**

**PROGRAMI “SHËRBIMET BUJQËSORE, INSPEKTIMI, SIGURIA USHQIMORE DHE MBROJTJA E KONSUMATORËVE”**

Njësitë shpenzuese:

Aparati i Bashkisë Tiranë

Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit

Në këtë program buxhetor përfshihen të gjithë objektivat si më poshtë:

**1. Aparati i Bashkisë përfshin:**

**a. Grante për fermerët;**

- Ky produkt përfshin shpenzimet për grantet e dhëna fermerëve për zhvillimin e kulturave apo projekteve të ndryshme.

**b. Fermerë të mbështetur për zhvillimin rural dhe bujqësor;**

- Ky produkt përfshin aktivitetet dhe kostot përkatëse të lidhura shërbimin e këshillimit dhe ekstensionit bujqësor.

**2. Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit përfshin:**

- Trajtimi i kafshëve endacake;
- Shpenzime për trajtimin e kafshëve endacake (ushqime, disterilizime etj) në formë ambulante apo nëpërmjet qendrës së ngritur për këtë qëllim.
- Kontrolli ushqimor, mbrojtja e konsumatorit.

- Inspektimi dhe shërbimet për qytetarët si dhe mbrojtja e trajtimi i kafshëve endacakë.

### **PROGRAMI “MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT”**

(Transferta e pakushtëzuar sektoriale si funksion i deleguar)

Njësitë shpenzuese: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik

Në këtë program buxhetor përfshihen të gjithë objektivat si më poshtë:

**a. Mirëmbajtja rutinë e kanaleve ujitëse dhe kanale kulluese.**

- Mirëmbajtja rutinë e Km lineare kanale ujitës dhe Km lineare kanale kulluese nëpërmjet pastrimit, sistemimeve, mirëmbajtjeve, meremetimeve apo zëvendësimit të torbinove, etj. Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e çdo sistem kullimi dhe vepër mbrojtje nga përmytja brenda zonës përkatëse nën shërbim në mënyrë që të largojë ujin e tepërt dhe të parandalojë grumbullimin e ujit, zhvillimin e kripëzimit dhe toksifikimit dhe të parandaloje përmytjen. Pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve kulluese, mbledhëse, tubat dhe strukturat;

### **PROGRAMI “ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE”**

(Transferta e pakushtëzuar sektoriale si funksion i deleguar)

Njësitë shpenzuese: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit

Në këtë program buxhetor përfshihen të gjithë objektivat si më poshtë:

**a. Shërbimi i Stafit të menaxhimit të fondit Pyjor dhe Kullosor;**

- Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për sektorin e monitorimit dhe mbrojtjes së tokës dhe pyjeve.

**b. Inspektim dhe kontroll i sipërfaqes pyjore/kullosore;**

- Ky produkt përfshin aktivitetet e inspektimit të të gjitha hapësirave kullosore dhe pyjore për prerje të paligjshme të lëndës drusore duke marrë parasysh hapësirat e shfrytëzuara dhe ato të pashfrytëzueshme, si edhe kostove të nevojshme të lidhura me funksionimin e këtij shërbimi.

### **PROGRAMI “RRJETI RRUGOR RURAL”**

Njësitë shpenzuese: Aparati i Bashkisë Tiranë  
Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik

Në këtë program buxhetor përfshihen të gjithë objektivat si më poshtë:

**a. Rrjet Rrugor Rural i rehabilituar;**

- Rehabilitimi i infrastrukturës rrugore rurale dhe lidhja e rrugëve dytësore me ato kryesore dhe nacionale. Monitorimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi i gjendjes së infrastrukturës rrugore; Hartimi i planeve, procedurave të prokurimit dhe zbatimi i ndërhyrjeve në rehabilitimin e rrugëve përmes zëvendësimit të shtresave të asfaltit, shtrimi i shtresave shtesë, pajisja e infrastrukturës rrugore rurale me sinjalistikë horizontale dhe vertikale, etj.

**2. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik përfshin:**

**a. Shërbimi i stafit të mirëmbajtjes Rrjetit Rrugor Rural;**

- Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për sektorin e Rrugëve Rurale

**b. Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur;**

- Mirëmbajtje rutinë dhe periodike e infrastrukturës rrugore rurale. Monitorimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi i gjendjes së infrastrukturës rrugore; sigurimi i mjeteve dhe bazës materiale për pastrim kanali, mbushjes së gropave me cakull, beton ose asfalt; etj.

**c. Ndriçimi i qytetit:**

- Përmirësimi i vazhdueshëm i punimeve mirëmbajtëse që ndriçimi i qytetit të jetë sa më funksional; Përmirësimi i rrjetit semaforik nëpër kryqëzime duke zëvendësuar Plotësimin e rrugëve kryesore e dytësore me sinjalistikë vertikale (tabela) dhe horizontale (vijëzime, police të shtirë, grerësa), barriera mbrojtëse për këmbësorët. Përmirësimi i gjendjes teknike të rrugëve rurale lidhëse midis fshatrave, që përgjithësisht janë të shtruara vetëm me çakëll dhe rindërtimi i veprave të artit dhe mbrojtëse të trasesë së rrugës/Përmirësimin e gjendjes teknikeve të urave grumbullimin e ujit, zhvillimin e kripezimit dhe toksifikimit dhe te parandaloje përmytjen.

**PROGRAMI “TRANSPORTI PUBLIK”**

Njësitë shpenzuese:

Aparati i Bashkisë Tiranë  
Tirana Parking

Në këtë program buxhetor përfshihen të gjithë objektivat si më poshtë:

**a. Shërbimi i Transportit Publik;**

- Subvencionim i operimit të shërbimit të transportit qytetës në Bashkinë e Tiranës, për shkak të mosbulimit të kostove të operimit, ardhur si pasojë e reduktimit të volumeve të udhëtarëve për shkak të pandemisë Covid 19 si dhe për shkak të krizës energjitike që solli rritjen e cmimit të naftës.
- Shtim i blloqeve rezident në qytetin e Tiranës me qëllim rritjen e kapaciteteve të parkimit të qytetarëve.

**PROGRAMI “MENAXHIMI I MBETJEVE”**

Njësitë shpenzuese:

Aparati i Bashkisë Tiranë

Në këtë program buxhetor përfshihen të gjithë objektivat si më poshtë:

**a.** Shërbimi i stafit të menaxhimit të mbetjeve dhe pastrimit;

- Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për sektorin e Pastrimit të qytetit, NJA; mbledhjen, transportimin dhe depozitimin e mbetjeve.

**b.** Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat urbane dhe rurale;

- Mbetje të ngurta të mbledhura dhe të transportuara nga zonat urbane dhe rurale, drejt vend-depozitimeve në një vit. Këtu përfshihen shpenzimet kundrejt operatorëve që sigurojnë shërbimin e mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave një herë në ditë; blerjen, mirëmbajtjen dhe dizifektimin e kontenierëve të mbetjeve; mirëmbajtjen apo ripërtëritjen e mjeteve dhe pajisjeve, etj.

**c.** Pastrimi i rrugëve dhe parqeve;

- Këtu përfshihen shpenzimet për sipërfaqja e rrugëve urbane që fshihet/lahet çdo ditë gjatë gjithë vitit.

**d.** Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve;

- Mbetje të ngurta nga zonat urbane dhe rurale të depozituara dhe trajtuara në landfill kundrejt tarifës së depozitimit. Këtu përfshihen shpenzimet për tarifën që lidhen me këtë shërbim.

**dh.** Promovimi i mbrojtjes së mjedisit;

- Realizimi i aktiviteteve të ndryshme për sensibilizimin apo impakt të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e mjedisit.

## **PROGRAMI “PLANIFIKIMI URBAN VENDOR”**

Njësitë shpenzuese:

Aparati i Bashkisë Tiranë

Inspektoriati i Mbrojtjes Territoriale

Në këtë program buxhetor përfshihen të gjithë objektivat si më poshtë:

**a.** Projekte të zhvillimit urban të hartuara dhe monitoruara;

- Hartimi i projekteve të ndryshme nga drejtoria e urbanistikës dhe planifikimit urban; leje për zhvillimin e zonave/njësive të komunitetit (të reja ose rehabilituara); etj.

**2. Inspektoriati i Mbrojtjes Territoriale përfshin:**

**a.** Inspektime të zhvilluara për mbrojtjen e territorit;

- b. Këtu përfshihen të gjitha aktivitetet inspektuese dhe shpenzimet përkatëse të kryera Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit. Shpenzimet janë ato për paga dhe sigurime për stafin, si edhe shpenzime të tjera të operimit të shërbimit. Inspektim dhe kontroll i subjekteve ndërtuese.

## PROGRAMI “SHËRBIMET PUBLIKE VENDORE”

Njësitë shpenzuese:

Aparati i Bashkisë Tiranë  
Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit  
Agjencia Shërbimeve Funerale  
Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit

### 1. Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit përfshin:

a. Sipërfaqe e gjelbër e mirëmbajtur dhe rehabilituar;

- Mbjellje, shërbim, dhe mirëmbajtja e pemëve dekorative dhe shkurre me gjelbërim të përhershëm, shërbim bari i kultivuar, natyral, tapet bari, uje, punim rrënjësh, plehërim, spërkatje me pesticide. Kryerja e kontrolleve të rregullta të mirëmbajtjes. **Objektivat e institucionit:** Mirëmbajtjen, pastrimin, gjelbërimin rrugor dhe gjelbërimin e zonave të banimit.

### 2. Agjencia Shërbimeve Funerale përfshin:

a. *Shërbimi i stafit të ndërmarrjeve publike të gjelbërimit, varrezave;*

- Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve shoqërore për sektorët e mirëmbajtjes dhe menaxhimit të varrezave publike.

b. *Mirëmbajtja e sipërfaqes së varrezave;*

- Sipërfaqe ekzistuese e varrezave të qytetit të mirëmbajtura. Mirëmbajtja dhe sistemimi i parcelave të varrezave, rrugëve dhe trotuarëve ndarës; sistemimi i zonave të gjelbërta; etj. **Objektivat e institucionit:** Standartizimi i procesit të varrimit në nivele bashkekohore. Krijimi i varrezave të reja publike sipas kriterëve të BE.

### 3. Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit përfshin:

a. Sipërfaqe e gjelbër e mirëmbajtur dhe rehabilituar;

- Mbjellje, shërbim, dhe mirëmbajtja e pemëve dekorative dhe shkurre me gjelbërim të përhershëm, shërbim bari i kultivuar, natyral, tapet bari, ujë, punim rrënjësh, plehërim, spërkatje me pesticide. Kryerja e kontrolleve të rregullta të mirëmbajtjes për makineritë (prerëse bari, etj.). **Objektivat e institucionit:** Shtimi i ambienteve shlodhëse, argëtuese dhe terreneve sportive;-Rikonstrukcion i objekteve rekreative, sanitare, infopoit, objekteve të shërbimit në parqe. Rehabilitimi i sipërfaqeve të gjelbërta ekzistuese;
- Aparati I Bashkisë- Rehabilitimi i hapësirave publike, shtimi i gjelbërimit në të gjithë territorin e qytetit, krijimi i hapësirave të reja rekreative etj.

## **PROGRAMI “SPORT DHE ARGËTIM”**

Njësitë shpenzuese:

Aparati i Bashkisë  
Klubi Sportiv Tirana  
Klubi shumësportësh “Partizani”  
Klubi Sportiv Studenti  
Agjencia e Rinisë

Në këtë program buxhetor përfshihen të gjithë objektivat si më poshtë:

1. Aparati i Bashkisë Mbështetje për projekte të ndryshme sportive, Promovimin e Kryeqytetit dhe promovimin e jetesës Sportive e cila ndikon pozitivisht në jetën e njëjzve në aspektin shëndetësor dhe fizik.

### 2. Klubet Sportive:

**a.** Disiplinat e ndryshme sportive të mbështetura;

- Shpenzimet e planifikuara për të mbështetur sportistë, stafet mbështetëse të disiplinave sportive dhe trajtimin financiar të tyre. Sipas disiplinave do të kostohen shpenzimet referuar nevojave për paga, uniforma, dieta etj. Këtu do të përfshihen edhe shpenzimet për mirëmbajtjen dhe funksionimin e terreneve sportive në dispozicion të disiplinave të ndryshme sportive.

**b.** Menaxhimin dhe përgatitjen e cilësisë së lartë sportive të ekipeve dhe sportistëve më të zgjedhur të qytetit të Tiranës.

### 3. Agjencia e Rinisë:

Organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore fushën e mbrojtjes dhe të fuqëzimit të të rinjve; Kompensimin i biletës së pajtimit mujor të përgjithshëm (Abonese së Studentit) për studentët e pajisur me kartë studenti për të gjitha linjat në transportin qytetës në Bashkinë e Tiranës; vlerësimin dhe promovimin e aftësive të studentëve në fusha të ndryshme shoqërore si arti, kultura, edukimi, sporti etj;

## **PROGRAMI “TRASHËGIMIA KULTURORE, EVENTET ARTISTIKE DHE KULTURORE”**

Njësitë shpenzuese:

Aparati i Bashkisë  
Qendra Kulturore" Tirana"  
Qendra Rinore Ten  
Muzeu Vendor "Shtëpia Studio Kadare"  
Muzeu Vendor “Shtëpia Studio Agolli”  
Galeria e Artit Tirana  
Qendra e restaurimit dhe realizimit të veprave të artit  
Agjencia e Industrisë Kreative

Në këtë program buxhetor përfshihen të gjithë objektivat si më poshtë:

### 1. Aparati i Bashkisë:

#### a. Promovimi i trashëgimisë kulturore

- Shpenzimet për broshura, për pika informimi, shfaqje kulturore dhe artistike për promovimin e trashëgimisë kulturore apo forma të tjera për promovimin e trashëgimisë kulturore.

#### b. Funksionimi i Bibliotekave;

- Shpenzimet për mirëmbajtjen, funksionimin dhe shtimin e fondit të librave për përmirësimin e cilësisë së shërbimit që ofrojnë bibliotekat e Tiranës.

### 2. Qendra Kulturore" Tirana":

#### a. Shërbimet e stafit të Artit dhe Kulturës;

- Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në stafin që merret me aktivitetet artistike dhe kulturore.

#### b. Shfaqje teatri;

- Në këto shpenzime përfshihen shpenzimet për materialet e nevojshme të shfaqjeve të teatrit (kostume, skena, etj.), dieta, honorare apo transporti për realizimin e shfaqjeve. Këtu përfshihen gjithashtu shpenzimet për të mbuluar kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimit të teatrit publik në pronësi bashkise. **Objektivat e institucionit:** Krijimin, realizimin dhe interpretimin e veprave cilësore, mundëson edukimin, shlodhjen dhe argëtimin e të gjitha shtresave dhe grupmoshave të shoqërisë

### 3. Qendra Rinore Ten:

#### a. Fëmijë që frekuentojnë qendrat kulturore të fëmijëve;

- Shpenzimet për funksionimin e qendrave kulturore të fëmijëve ku përfshihen shpenzimet për mirëmbajtjen dhe funksionimin (materiale për kurset, ujë, energji elektrike, ngrohje, etj.) e këtyre qendrave, pagesat për ekspertët e jashtëm, zhvillimin e kurseve të ndryshme të baletit, kitarës, pikturës, etj.

**Objektivat e institucionit:** Mbështetja, promovimi i pjesëmarrjes dhe agazhimit aktiv rinor, si dhe kultivimi i talenteve të reja, me fokus të veçantë në krijimtarinë artistike dhe artin bashkëkohor.

### 4. Muzeu Vendor "Shtëpia Studio Kadare" dhe "Shtëpia Studio Agolli" :

#### a. Objekte të veprimtarisë kulturore dhe artistike të mirëmbajtura dhe funksionale

#### b. Shpenzime për mirëmbajtjen dhe sigurimin e funksionimit të plotë të muzeut.

**Objektivat e institucionit:** Shpalosjen, njohjen dhe promovimin e veprës letrare të shkrimtarëve të njohur Ismail Kadare dhe Dritëro Agolli.

### 5. Galeria e Artit Tirana përfshin:

#### a. Objekte të trashëgimisë kulturore të mirëmbajtura

#### b. Shpenzime për mirëmbajtjen dhe sigurimin e funksionimit të plotë të Galerisë. **Objektivat e institucionit:** Organizimin dhe koordinimin e veprimtarive artistike, kryesisht në fushën e artit



pamor dhe veprimtarive kulturore kreative bashkvepruese, me synimin, krijimin e një atmosfere dinamike për qytetarët, për të rinjtë, fëmijët dhe artistët e Tiranës; Zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive që gjallërojnë jetën kulturore artistike në Bashkinë Tiranë dhe njësitë administrative të saj.

7. Qendra e restaurimit dhe realizimit të veprave të artit përfshin:

- a. Objekte të trashëgimisë kulturore të mirëmbajtura
- b. Shpenzime për mirëmbajtjen dhe sigurimin e funksionimit të plotë të Qendrës. **Objektivat e institucionit:** Realizimi i veprave monumentale në skulpturë, plastike të parkut, zbukurime, dekoracione me rëndësi për trashigiminë dhe zbukurimin e qytetit të Tiranës; mirëmbajtjen, pastrimin dhe restaurimin e veprave ekzistuese në territorin e Bashkisë Tiranë.

8. Agjencia e Industrisë Kreative përfshin:

- a. Shfaqje kinemaje;
- b. Shpenzime për mirëmbajtjen dhe sigurimin e funksionimit të plotë të Agjencisë, dhe kinemave publike në administrim të saj. Në këto shpenzime përfshihen shpenzimet për materialet e nevojshme të funksionimit të kinemave, fondi për blerjen/marrjen me qera të filmave, etj. **Objektivat e institucionit:** Ri-vitalizimin e kinemave të qytetit; Shfaqjen e filmave shqiptarë dhe të huaj në sallat e kinemave; Ideimin dhe implementimin e programeve edukuese për fëmijë nëpërmjet artit të kinemasë; Organizimin e festivaleve të filmit kombëtar dhe ndërkombëtar në qytet; Organizimin e javës së filmit të huaj në Tiranë.

## PROGRAMI “ARSIMI PARASHKOLLOR PËRFSHIRË ARSIMIN BAZË”

Njësitë shpenzuese: Aparati i Bashkisë  
Drejtorja e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve  
Shkolla Speciale “Luigj Gurakuqi”

Në këtë program buxhetor përfshihen të gjithë objektivat si më poshtë:

1. Aparati i Bashkisë:

a. Investimet për ndërtimin e objekteve të reja arsimore dhe për rikonstrukcionin e objekteve arsimore si pasojë e amortizimit. Gjithashtu përfshihen investimet për mobilimin e këtyre objekteve.

2. Drejtorja e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve:

a. Shërbime mbështetëse të stafit të Kopshteve e Cerdheve;

- Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në shërbimet mbështetëse të kopshteve e cerdheve.

b. Fëmijë që ndjekin kopshtin e cerdhen;

- Shpenzimet për materiale te ndryshme didaktike që i shërbejnë fëmijëve të kopshteve. Këtu përfshihen shpenzimet për funksionimin e kopshteve e cerdheve (ujë, energji elektrike, ngrohje, shpenzimet e sigurisë), shpenzimet e mirëmbajtjes, kuzhinat e trajtimit ushqimor të fëmijëve, etj.

c. Edukatorë të kualifikuar/trajnuar;

- Shpenzimet për të mbuluar trajnimin apo kualifikimin e edukatorëve me qëllim rritjen e kapaciteteve.

3. Shkolla Luigj Gurakuqi përfshin:

a. Shërbime mbështetëse të stafit;

- Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në shërbimet mbështetëse të kësaj shkolle të specializuar.

b. Shpenzime të funksionimit;

- Shpenzimet për materiale te ndryshme didaktike që i shërbejnë fëmijëve. Këtu përfshihen shpenzimet për funksionimin (ujë, energji elektrike, ngrohje, shpenzimet e sigurisë), shpenzimet e mirëmbajtjes, etj. **Objektivat e institucionit:** Realizimi i lehtësirave për fëmijët me aftësi të vecanta.

**PROGRAMI "ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM "**

Njësitë shpenzuese:

Aparati i Bashkisë  
Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike  
Drejtoria e Konvikteve Shkollave të Mesme

Në këtë program buxhetor përfshihen të gjithë objektivat si më poshtë:

1. Aparati i Bashkisë përfshin:

a. Ndërtimi dhe Rikonstruksioni i shkollave të mesme të përgjithshme

b. Nxënës të trajtuar me bursë;

- Shpenzimet për trajtimin e nxënësve të arsimit të mesëm të përgjithshëm me bursë sipas kritereve të përcaktuara. Shpenzimet do të lidhen më numrin e nxënësve që do të jenë përfitues

2. Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike përfshin:

a. Objekte të arsimit të mesëm të mirëmbajtura dhe funksionale;

- Shpenzimet për mbulimin e kostove të mirëmbajtjes dhe funksionimit të objekteve të arsimit të mesëm të përgjithshëm. Mirëmbajtja ka të bëjë me atë elektrike, hidrosanitare,

klasat, dyer, dritare, lysterjet, etj. Këtu do të përfshihen gjithashtu edhe shpenzimet e funksionimit dhe ruajtjes (ujë, energji elektrike, ngrohje, dizifektim, sanitare, internet, kamerat e sigurisë, kancelari për sekretaritë, etj.)

**b. Shërbime Mbështetëse të stafit të Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm;**

- Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në shërbimet mbështetëse të arsimit të mesëm të përgjithshëm.

**c. Objekte publike të mirëmbajtura;**

- Mirëmbajtja rutinë dhe periodike e objekteve të ndryshme administrative në pronësi të bashkisë.

**3. Drejtoria e Konvikteve Shkollave të Mesme përfshin;**

**a. Nxënës të akomoduar në konvikt;**

- Shpenzimet për konviketet e arsimit të mesëm duke ju referuar numrit të nxënësve në këto objekte. Këto shpenzime përfshin rinovimin e paisjeve, rregullimet e brendshme, shpenzimet utilitare, të sigurisë, mençat dhe ushqimin për fëmijët konviktorë, etj. Përfshirë këtu shpenzimet për nxënësit e komuniteti rom të akomoduar në konvikte. **Objektivat e institucionit:** Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve të arsimit profesional (vetëm konviktet); Rritja e kapaciteteve të vazhdueshme të stafit, përmirësimi, motivimi dhe angazhimi i punonjësve.

**PROGRAMI "KUJDESI SOCIAL PËR FAMILJET DHE FËMIJËT"**

Njësitë shpenzuese:

Aparati i Bashkisë  
Qendra Sociale Multidisiplinare  
Qendra komunitare "Të qëndrojmë së bashku"  
Qendra Komunitare "Shkozë"  
Qendra Sociale "Strehëza"  
Qendra Komunitare "Gonxhe Bojaxhi"  
Qendra Komunitare e Terrenit  
Qendra Komunitare për personat me aftësi të kufizuar

Në këtë program buxhetor përfshihen të gjithë objektivat si më poshtë:

**1. Aparati i Bashkisë përfshin:**

**a. Shërbimi i stafit të Kujdesit për Fëmijët dhe Familjet;**

- Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në kujdesin social të familjeve dhe fëmijëve në nevojë.

**b. Fëmijë që përfitojnë nga shërbimi social;**

- Shpenzimet buxhetore për mbulimin e fëmijëve që përfitojnë shërbimet të caktuara nga qendrat e shërbimit social apo shtëpitë e foshnjës në administrimin e njësive të vetëqeverisjes vendore. Referuar numrit të fëmijëve që përfitojnë shërbim pranë këtyre funksioneve do të përlogariten shpenzimet e planifikuara për realizimin e këtij produkti.

c. Familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e NE;

- Shpenzimet që planifikojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore në buxhetin e tyre për mbështetjen e familjeve dhe individëve në nevojë që përfitojnë nga skemat e Ndihmës Ekonomike.

d. Shërbimi i Stafit të Kujdesit Social;

- Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në fushën e kujdesit social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara nën administrimin e njësive të vetëqeverisjes vendore.

e. Persona që përfitojnë kujdesin social;

- Shpenzimet që lidhen me qendrat ditore të kujdesit social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe kostot e tjera të funksionimit të këtyre qendrave përfshihen në këtë produkt. Përfshirë këtu treguesit e grave, të moshuarve dhe fëmijëve të asistuar me shërbim social.

ë. Individë PAK që përfitojnë trajtim;

- Fondi e veta në dispozicion të njësive të vetëqeverisjes vendore për të mbështetur shërbimet ndaj individëve me aftësi të kufizuara. Shpenzimet lidhen me numrin e individëve që përfitojnë trajtim me fondin mbi aftësitë e kufizuara.

2. Qendrat Komunitare përfshijnë:

a. Mbështetje sociale, psiko-mediko-emocionale, ligjore, edukative për fëmijët dhe familjet në nevojë; për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara, gra dhe vajza me probleme sociale, të moshuar dhe të vetmuar; Mbështetje sociale të komunitetit rom dhe familjeve në nevojë; Mbështetje sociale për njerëzit e pastrehë; fizioterapi; Identifikimin e individëve (të rritur dhe fëmijë) në situatë rruge dhe referimin e tyre pranë strukturave menaxhuese dhe të shërbimit; vlerësimin e shpejtë të nevojave bazë të individit; shërbime këshilluese, ndërmjetësuese lidhur me strehimin social, punësimin dhe aspektet ligjore; shoqërimin e rasteve të identifikuara në nevojë për mbrojtje të menjëhershme në struktura si komisarate, institucione shëndetësore etj;

b. Përfshirja e të gjitha aktiviteteve dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në fushën e kujdesit social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara

c. Shpenzimet që lidhen me qendrat ditore të kujdesit social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe kostot e tjera të funksionimit të këtyre qendrave përfshihen në këtë produkt. Përfshirë këtu treguesit e grave, të moshuarve dhe fëmijëve të asistuar me shërbim social.

## **PROGRAMI “STREHIMI SOCIAL”**

Njësitë shpenzuese:

Aparati i Bashkisë

### 1. Aparati i Bashkisë

#### **a. Shërbimi i stafit të strehimit social;**

- Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në fushën e strehimit social.

#### **b. Familje në nevojë/Individë të subvencionuar për qeranë;**

- Shpenzimet që planifikon njësia e vetëqeverisjes vendore për të mbuluar detyrimin për subvencionim në kuadër të mbrojtjes sociale të familjeve përfituese të programit të subvencionimit të qerasë së shtëpisë. Niveli i shpenzimeve do të mbështetet mbi numrin e familjeve apo individëve të cilët janë përfitues në atë program.

#### **c. Familje/Individë të subvencionuar për interesin e Kredisë;**

- Shpenzimet që planifikon njësia e vetëqeverisjes vendore për të mbuluar detyrimin për subvencionim në kuadër të mbrojtjes sociale të familjeve përfituese të kredisë me norma interesi favorizuese. Niveli i shpenzimeve do të mbështetet mbi numrin e familjeve apo individëve të cilët janë përfitues në atë program.

## 5. PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE TË VETA TË BASHKISË SË TIRANËS PËR PERIU DHËN 2024-2026

Për vitin 2024 të ardhurat nga taksat e tarifave vendore janë parashikuar në vlerën e 18,252,000,000 lekë. Një pasqyrim në vija të përgjithshme i parashikimit të të ardhurave për vitet 2024 - 2026, mund të shihet në tabelën më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026
Të ardhura tatimore	10,879,500,000	12,914,000,000	12,954,395,000	12,039,017,000
Të ardhura jo tatimore	5,554,000,000	5,338,000,000	5,416,500,000	5,464,935,000
<b>Total të ardhura</b>	<b>16,433,500,000</b>	<b>18,252,000,000</b>	<b>18,370,895,000</b>	<b>17,503,952,000</b>
Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	3,008,634,292	3,732,529,694	3,769,854,991	3,807,553,541
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	1,324,954,914	1,447,328,241	1,447,328,241	1,447,328,241
<b>Total Transferta</b>	<b>4,333,589,206</b>	<b>5,179,857,935</b>	<b>5,217,183,232</b>	<b>5,254,881,782</b>
Të ardhura të mbartura	8,000,000,000	10,000,000,000	5,000,000,000	3,000,000,000
Të ardhura të planifikuara nga donatorët	5,787,444	7,681,704	0	0
<b>Totali</b>	<b>28,772,876,650</b>	<b>33,439,539,639</b>	<b>28,588,078,232</b>	<b>25,758,833,782</b>

Bazuar në legjislacionin rregullator dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak, për mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, pjesë e paketës fiskale të Bashkisë Tiranë, janë përcaktuar edhe strukturat përkatëse për mbledhjen e tyre, si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore;
  - Tirana Parking;
  - Strukturat e Aparatit të Bashkisë;
  - Agjentët tatimorë.
- Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, është struktura kryesore për mbledhjen dhe rakordimin e të gjitha të ardhurave të Bashkisë së Tiranës, e cila administron plotësisht procesin e mbledhjes së të ardhurave nga taksat e tarifave vendore për kategorinë e bizneseve, si dhe arkëton dhe ndjek procesin e rakordimit për të ardhurat që mbledhen nga struktura të tjera të Bashkisë dhe nga Agjentët Tatimorë.
- Tirana Parking, është struktura e specializuar vetëm për mbledhjen e tarifës së parkimit sipas VKB Nr.48 datë 11.11.2016 “Për krijimin e Tirana Parking si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë”.

- Strukturat e Aparatit të Bashkisë janë të angazhuara në administrimin e tarifave të shërbimit që aplikon vetë institucioni si dhe në taksat që zbatohen direkt prej tyre, arkëtimi i të cilave bëhet me tej nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.
- Agjentët tatimorë të përcaktuar sipas ligjit dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak, janë:
  - DRSHTRR, për arkëtimin e taksës vjetore të mjeteve të përdorura;
  - Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për arkëtimin e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
  - Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sha, për arkëtimin e taksës së ndërtesës, taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore dhe tarifës së pastrimit nga kategoria Familjarë;
  - Drejtoria Rajonale Tatimore, për arkëtimin e Tatimit mbi të ardhurat personale

Të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2024, paraqiten me një rritje prej 11 % krahasuar me planin fillestar të vitit 2023. Në këtë parashikim ndikojnë disa elementë si më poshtë:

- Ndryshimi i çmimeve mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 457 datë 26.07.2023 dhe ndikimi i këtij ndryshimi në taksën e ndërtesës, taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe taksën e përkohshme të infrastrukturës arsimore.
- Kontributi në vlerë monetare i sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale nga ndërtimet e reja e barazvlefshme me 3% të sipërfaqes funksionale ndërtimore në pronësi të investitorit/zhvilluesit për sipërfaqe ndërtimore mbi 2,000 metër katrorë, sipas referencave të njësisë ku ndodhet ndërtimi nuk do të jetë më pjesë e parashikimeve të të ardhura pasi ky kontribut do të jepet vetëm në sipërfaqe ndërtimore
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja vazhdon të jetë një prej elementëve më të rëndësishëm të të ardhurave për Bashkinë Tiranë. Për vitin 2024 kjo taksë është parashikuar me rritje kundrejt planit aktual të vitit 2023.
- Të ardhurat nga Tatimi mbi të ardhurat Personale (TAP), për vitin 2024 parashikohen me rritje në raport me parashikimin e vitit 2023 duke iu referuar realizimit të pritshëm për vitin 2023 dhe parashikimit të DPT për vitin 2024 bazuar në mënyrën e shpërndarjes ndërmjet njësisë të qeverisjes vendore në bazë të popullsisë.
- Rritja e të ardhurave që priten të realizohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve me hapjen e disa strukturave të reja dhe me rritjen e tarifës së ushqimit për çerdhet dhe kopshtet.
- Në parashikimet për taksat dhe tarifatat tjera vendore, është marrë në konsideratë aplikimi i taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore vetëm për dy vite në vazhdim, për periudhën 2024-2025 sipas miratimit të saj për 3 vjet 2023-2025.
- Taksa e fjetjes në hotel është parashikuar të jetë në nivele më të larta krahasuar me vitet e mëparshme duke marrë parasysh dhe fluksin e lartë të turistëve që vizituan qytetin e Tiranës në vitin 2023, shtimi i strukturave akomoduese dhe subjekteve që merren me menaxhimin e tyre.

- Shtimi i abonimeve me kontratë, rritja e kapacitetit arkëtues me mënyra të reja alternative pagese do të sjell rritjen e të ardhurave nga tarifa e parkimit.
- Së fundi, në parashikimin e vitit 2024, paraqiten me rritje të ardhurat e trashëgueshme nga viti 2023. Ky fenomen është ndikuar specifikisht gjatë vitit 2023, pjesërisht për shkak të realizimit me tejkalim të të ardhurave të parashikuara, të cilat deri në 10 mujorin e parë, shënojnë një realizim prej 112% dhe pritshmëria deri në fund të vitit, vlerësohet në 110%.

Për sa më sipër të ardhurat për vitin 2024 paraqiten me një rritje prej 1,818,500,000 lekë ose 11% më shumë, krahasuar me parashikimet fillestare të vitit të mëparshëm.

Në mënyrë të detajuar parashikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore të Bashkisë Tiranë, për periudhën 2024-2026, paraqitet si më poshtë:

## **TAKSA VENDORE**

### **A) Taksa mbi ndërtesën**

Taksa mbi ndërtesën është ndër burimet më me peshë në buxhetin e Bashkisë Tiranë dhe përbën mesatarisht 21% të totalit të të ardhurave të veta.

Llogaritja e taksës për ndërtesën/njësi pronësore bazohet në shkallën në përqindje të taksës së miratuar me ligj, më specifikisht sipas pikes 5, te nenit 2, te VKM 132/2018, te ndryshuar dhe ligjit 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar sipas kategorive të ndërtesave, si më poshtë:

- a) 0,05%, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2%, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Për Bashkinë e Tiranës, struktura përgjegjëse për llogaritjen dhe mbledhjen e detyrimit për këtë taksë nga subjektet që realizojnë aktivitet ekonomik në territorin e Bashkisë Tiranë, është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, ndërsa për detyrimet e kategorisë familjarë, është përzgjedhur si Agjent tatimor Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a, me vendim të Këshillit Bashkiak dhe rregulluar sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 25505 datë 21.06.2019.

Databazat që Bashkia Tiranë përdor për ngritjen dhe arkëtimin e detyrimeve janë të bazuara në të dhënat e grumbulluara dhe të administruara nga sistemet e ngritura në dy strukturat e saj, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtorisë së Taksave pranë Agjentit Tatimor, Ujësjellës – Kanalizime Tirana sha.




Në datën 28.07.2023 hyri në fuqi aplikimi i çmimeve të reja të referencës ku u ndryshuan çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi të një pjesë të konsiderueshme të njësive administrative të Bashkisë Tiranë. Këto ndryshime u replikuan nga ana e Agjentit tatimor për subjektet familjare në faturimin e muajit gusht 2023 dhe për Drejtorinë e përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore do të aplikohen në vitin 2024 bazuar dhe në orientimin e marrë nga Ministrisë e Financave dhe Ekonomisë dhe do të jenë pjesë e të ardhurave të parashikuara nga kjo taksë në vitin 2024.

Ndryshimi i shkaktuar në nivelet e arkëtimit nga ndryshimi i pësuar i vitit 2023, me vendimin 457 datë 26.07.2023 do të vërehet në vitin 2024, pasi ngarkimi i detyrimeve për subjektet e biznesit për periudhën gusht – dhjetor 2023 do të bëhet me detyrimet e vitit 2024. Kjo është arsyeja pse në vitin 2024 kemi një rritje të ndjeshme të planifikimit për këtë taksë.

Ecuria në vitet 2018-2022 e kësaj takse tregon një nivel arkëtimesh gati të njëjtë. Në vitin 2020 arkëtimi i kësaj takse ishte në nivel të ulët për shkak të problematikave dhe vështirësive ekonomike që kanë përballuar bizneset gjatë periudhës së pandemisë Covid -19 si dhe marrjes së vendimit për uljen e detyrimit për sektorin hotelier në masën 30% për detyrimin vjetor të kësaj takse. Pjesa e detyrimeve të papaguara në vitin 2020 u arkëtua në vitin 2021 duke pasur nivelin më të lartë të arkëtimeve krahasuar me vitet e mëparshme. Në vitin 2023 kjo taksë pritet të ketë realizimin më të lartë ndër vite.

Më poshtë paraqitet realizimi në vite i taksës mbi ndërtesën për kategorinë e subjekteve të biznesit:

Taksa mbi Ndërtesën	2018	2019	2020	2021	2022	në lekë I pritshmi 2023
<i>Biznesi</i>	1,586,349,438	1,605,209,838	1,380,326,027	1,643,669,627	1,598,986,567	1,806,540,017



Për sa i përket kategorisë së ndërtesave që shfrytëzohen për banim, për shkak të mangësive thelbësore në databazën e Kadastrës Fiskale, që e bënin të pamundur implementimin e taksës mbi bazë të vlerës, Bashkia e Tiranës ka angazhuar agentin tatimor për të krijuar bazën e të dhënave, në përputhje me rradhën e prioriteteve të përcaktuara në Vendimin nr.132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”.

Agjenti Tatimor, me anën e strukturës së posaçme për përmbushjen e këtij detyrimi, ka marrë masa për plotësimin e bazës së të dhënave për faturimin, duke u bazuar fillimisht në vetëdeklarimet e qytetarëve pranë zyrave të agjentit tatimor.


Për familjet që nuk kanë kryer vetdeklarimin faturimi është kryer në bazë të hapave të parashikuar në Vendimin nr.132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” të ndryshuar.

Ky proces është vështirësuar gjatë këtyre viteve nga pamundësia e aksesit në banesat e qytetarëve për kryerjen e matjeve në terren të sipërfaqeve të banueshme.

Viti 2023 pritet të jetë viti me realizimin e më të lartë gjatë kësaj periudhe 6 vjeçare si nga rritja e arkëtive dhe nga fakti i ndryshimit të nivelit të taksës së ndërtesës për një periudhë 4 mujore që nga aplikimi i çmimeve të reja të referencës.

Më poshtë shohim realizimin e të ardhurave nga taksa e ndërtesës ndër vite për kategorinë “Familjarë” të pasqyruar si më poshtë:

Taksa mbi Ndërtesën	2018	2019	2020	2021	2022	Në lekë
						I pritshmi 2023
Familjarë	228,647,177	233,353,993	536,606,757	666,341,648	638,555,878	678,615,891



Planifikimi i të ardhurave për periudhën 2024 – 2026 merr në konsideratë planifikimin për kategorinë e bizneseve në bazë të të dhënave të DPTTV, ndërsa për kategorinë familjare në bazë të një vlerësimi paraprak, sipas të dhënave aktuale që disponohen nga baza e të dhënave e krijuar nga Agjenti Tatimor.

Në vitin 2024, të ardhurat nga taksa mbi ndërtesën janë parashikuar në vlerën 3,803,000,000 lekë.

Ky parashikim ka marrë parasysh ndryshimet e çmimeve mesatare të shitjes së banesave sipas VKM-së 457 datë 26.07.2023 dhe mundësinë e vjeljes për më shumë subjekte si ato të biznesit dhe ato familjare.

Në këtë parashikim përfshihen të ardhurat nga kategoria familjarë dhe kategoria e biznesit, si më poshtë:

në lekë				
Loji i të ardhurave	Plani 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026
<b>Taksa mbi pasurinë e paluajtshme</b>	<b>2,912,000,000</b>	<b>3,803,000,000</b>	<b>3,646,000,000</b>	<b>3,690,000,000</b>
- Familjarët	712,000,000	868,000,000	876,000,000	885,000,000
- Subjektet Tregtare	2,200,000,000	2,935,000,000	2,770,000,000	2,805,000,000

## B) Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja i nënshtrohen të gjitha subjektet që kërkojnë të pajisen me leje zhvillimore dhe leje ndërtimi për objekte banimi, administrative, prodhimi, shërbimi e tjera.


Struktura e ngarkuar për këtë taksë është Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila ndërkohë që pranon kërkesat, i shqyrton ato dhe pas miratimit nga Titullari, kryen edhe zbardhjen e kësaj leje kundrejt arkëtimit më parë të vlerës sipas përcaktimeve ligjore.

Realizimi i të ardhurave nga kjo taksë tejkalon planin e miratuar si rrjedhojë e aplikimeve përtej parashikimeve.

Në krahasim me fusha të tjera të aktivitetit tregtar, sektori i ndërtimit ka vazhduar të jetë një prej shtyllave bazë të zhvillimit ekonomik dhe njëri prej aktiviteteve që sjell më shumë të ardhura.

në lekë						
Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022	I pritshmi 2023
<b>Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja</b>	5,398,328,978	6,315,307,289	6,350,959,457	7,438,141,907	7,414,035,966	7,085,427,117

## Taksa e ndikimit në infrastrukturë



Parashikimi është bazuar referuar vlerësimeve të drejtorisë përgjegjëse dhe ecurisë së realizimit në vite. Planifikimi i TNI paraqet vështirësi pasi realizimi është në varësi të aplikimeve të cilat janë objekt i zhvillimit të tregut të pasurive të paluajtshme. Për periudhën e planifikuar, të ardhurat nga kjo taksë parashikohet të mbështeten kryesisht në zhvillimet e reja që pritet ti shtohen Tiranës në zonën e mirëplanifikuar të Bulevardit të Ri, ku është miratuar edhe Plani i Detajuar Vendor nga Këshilli Kombëtar i Territorit – plan ky që i hap rrugë zhvillimit.

Konkretisht për vitin 2024 dhe në vijim 2025 dhe 2026, parashikimet për këtë taksë, paraqiten si më poshtë:

Lloji i të ardhurave	Plani 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	5,559,000,000	6,360,000,000	6,500,000,000	6,500,000,000

në lekë

### C) Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore

Taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore i nënshtrohen të gjitha familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore arkëton detyrimin e kësaj takse nga subjektet që realizojnë aktivitete ekonomike në territorin e Bashkisë Tiranë, ndërsa detyrimi nga kategoria familjarë arkëtohet nga agjenti tatimor i përzgjedhur për këtë qëllim, “Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë” sh.a.


Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore ka një realizueshmëri të kënaqshme që nga koha e hyrjes në fuqi, në vitin 2016, si për kategorinë biznese edhe për kategorinë familjarë. Në fillim të vitit 2023 akëtimet nga kjo taksë u reduktuan nga miratimi i kësaj takse për një periudhë të re 3 vjeçare dhe limitimi i vlerës së saj në masën 35% të detyrimit të taksës së ndërtesës për të njëjtin subjekt.

Niveli i pritshëm i realizimit për vitin 2023 do të jetë mbi vlerën e parashikuar për subjektet “Familjare” duke marrë parasysh hyrjen në fuqi të VKM-së së re në datën 28.07.2023 dhe aplikimit të ndryshimeve të çmimeve të referencës në faturimet e muajit gusht 2023 për taksën e ndërtesës dhe respektivisht dhe për taksën e përkohshme për infrastrukturën arsimore.

Për subjektet e biznesit ky ndryshim nuk do të ndikoj vlerën e pritshme të realizimit për vitin 2023 dhe efekti për periudhën 5 mujore do të vihet re në vitin në vazhdim bashkë me parashikimin e vitit 2024. Gjithsesi, ndryshimi i çmimeve të referencës për apartamentet e banimit dhe si rrjedhojë çmimet referuese për strukturat që përdoren për qëllime biznesi dhe parashikimet për taksën e ndërtesës për këto subjekte do të shërbejnë si kufi të sipërm të parashikimeve për taksën e përkohshme të infrastrukturës arsimore.

Të dhënat e ecurisë paraqiten në tabelën më poshtë:

Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022	I pritshmi 2023
<b>Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore</b>	730,095,161	699,773,149	649,392,794	756,967,278	759,519,645	747,727,133



Për periudhën 2024 – 2026, parashikimi i të ardhurave nga kjo taksë e përkohshme, është si vijon:

Lloji i të ardhurave	Plani 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026
<b>Taksa e përkohshme për infrastrukturën Arsimore</b>	751,000,000	926,500,000	971,850,000	0
- Familjarët	200,000,000	251,500,000	276,600,000	0
- Subjektet Tregtare	551,000,000	675,000,000	695,250,000	0

Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore e ka vitin e fundit të aplikimit, vitin 2025. Parashikimi për periudhën 2024-2026 do të jetë në vlerat e mëposhtme duke iu referuar si kufij maksimalë realizimit të pritshëm të taksës mbi pasurinë e paluajtshme “ndërtesë” për të dy kategoritë e taksapaguesve.

#### D) Taksa e tabelës

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve, subjekteve të transportit dhe profesioneve të lira.

Taksa e tabelës përbëhet :


- I. Tabelë për qëllime identifikimi të trupëzuara ose jo brenda territori ku zhvillon veprimtarinë e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtarinë e të tretëve, ku shënohet emri dhe ose aktiviteti i biznesit:
  - ✓ Tabelë deri në 2 m<sup>2</sup>;
  - ✓ Tabelë mbi 2 m<sup>2</sup> deri në 10 m<sup>2</sup>;
    - e thjeshtë (pa ndricim)
    - me ndricim të thjeshtë;
    - elektronike.
  - ✓ Tabelë mbi 10 m<sup>2</sup> deri në 20 m<sup>2</sup>;
    - e thjeshtë (pa ndricim)
    - me ndricim të thjeshtë;
    - elektronike.
  - ✓ Tabelë mbi 20 m<sup>2</sup> deri në 40 m<sup>2</sup>;
    - e thjeshtë (pa ndricim)
    - me ndricim të thjeshtë
    - elektronike
  - ✓ Tabelë mbi 20 m<sup>2</sup> deri në 40 m<sup>2</sup>;
    - e thjeshtë (pa ndricim)
    - me ndricim të thjeshtë
    - elektronike

- II. Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelës për orientim.
- III. Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme/e palëvizshme deri në tavanin 35 m<sup>2</sup>:
  - ✓ Tabelë e thjeshtë me/pa ndricim;
  - ✓ Tabelë elektronike.
- IV. Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj. (të të gjitha përmasave)

Ecuria e taksës së tabelës ndër vite është përgjithësisht e qëndrueshme edhe pse arkëtimet nga kjo taksë varen nga përdorimi i tabelave reklamuese nga ana e bizneseve, i cili është i ndryshueshëm në varësi të zgjedhjes së biznesit për të reklamuar ose jo në një vit të caktuar, ndërkohë që për tabelën për qëllime identifikimi, deri në 2 m<sup>2</sup>, masa e taksës është zero.

Realizimi në vite pasqyrohet në tabelën më poshtë:

në lekë						
Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022	I pritshmi 2023
<b>Taksa e tabelës dhe reklamës</b>	307,879,375	268,203,139	236,214,879	260,113,743	296,186,327	298,634,960



Referuar realizimit të pritshëm të të ardhurave për vitin 2023, nivelit të taksës së miratuar sipas ligjit, si dhe vlerësimeve paraprake mbi përdorimin e tabelave reklamuese, parashikimi i të ardhurave për vitet 2024 – 2026, paraqitet në tabelën si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026
<b>Taksa e tabelës</b>	<b>320,000,000</b>	<b>330,000,000</b>	<b>333,300,000</b>	<b>336,633,000</b>
Tabelë identifikuese/sinjalizuese	250,000	250,000	250,000	250,000
Tabelë reklamuese	319,750,000	329,750,000	333,050,000	336,383,000


## E) Taksa për fjetjen në hotel

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore. Llogaritja e kësaj takse, bazuar në legjislacionin në fuqi, bëhet sipas ndarjes në dy kategori:

- Subjekte hoteleri me 4–5 yje me nivel takse për 350 lekë/dhoma;
- Subjekte hotele, bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin në nivel takse për 140 lekë/dhoma

Performanca e kësaj takse ndër vite paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022	I pritshmi 2023
<b>Taksa e fjetjes në hotel</b>	98,004,072	113,966,275	35,815,582	67,226,382	111,515,607	123,474,213



Bazuar në të dhënat historike të realizimit të arkëtimit, parashikimi i të ardhurave nga taksa e fjetjes në hotel për vitet 2024–2026 duke marrë parasysh nivelin e lartë të turistëve për vitin



2023 dhe rritjen e strukturave akomoduese në përshtatje të këtij fluksi dhe frekuentimit të këtyre strukturave hoteliere paraqitet si më poshtë:

Lloji i të ardhurave	Plani 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026
<i>Taksa e fjetjes në hotel</i>	100,000,000	150,000,000	157,500,000	165,375,000

në lekë


## F) Taksa mbi truallin

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit në m<sup>2</sup>, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim.

Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022	I pritshmi 2023
<i>Taksa mbi truallin</i>	55,345,234	56,079,090	50,714,059	65,136,671	85,213,072	88,662,714

në lekë



Bashkitë ndodhen në mungesë të bazës së të dhënave për këtë taksë si dhe në pritje të akteve ligjore plotësuese për taksimin e truallit, si një taksë qendrore për t'u aplikuar nga njësitë vendore dhe si rrjedhim, planifikimi bazohet në të dhëna historike dhe trendin vjetor përkatës të ndryshimeve të arkëtimit.

Për vitet 2024 – 2026, parashikimi të ardhurave nga kjo taksë jepet në tabelë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026
<b>Taksa mbi truallin</b>	85,000,000	90,000,000	90,900,000	91,809,000

### G) Taksa mbi tokën bujqësore.

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, Këshilli Bashkiak mund të miratojë nënkategorizime. Vlera e taksës në lekë/hektar/vit, miratuar me akte ligjore sipas bashkive dhe kategorisë së tokës, paraqitet në tabelë:


Kategoritë e tokës bujqësore	Lekë/ha/vit
I	5 600
II	4 900
III	4 200
IV	3 600
V	3 000
VI	2 400
VII– X	1 800

Aktualisht, në mungesë të një baze të dhënash mbi tokën bujqësore, planifikimi bazohet në të dhënat historike të arkëtimit dhe trendit vjetor përkatës të ndryshimeve të arkëtimit për këtë taksë.

Realizimi i kësaj takse të pasurisë së paluajtshme është në nivele shumë të ulëta për shkak të mungesës së regjistrimit të tokave bujqësore dhe pamundësine e vjeljes së detyrimeve edhe kundrejt atyre tashmë të regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave vendore dhe pamundësia e shkëmbimit të komunikimit me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për rritjen e numrit të subjekteve.

në lekë

Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022	I pritshmi 2023
<b>Taksa mbi tokën bujqësore</b>	22,757,271	20,299,189	21,207,054	22,183,650	23,431,924	24,607,063



Parashikimi i të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore për vitet 2024 –2026 gjithmonë në nivele më të larta se realizimi faktik , paraqitet si më poshtë.

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026
<b>Taksa mbi tokën bujqësore</b>	32,500,000	34,500,000	34,845,000	35,200,000

## **AGJENTËT TATIMORË JASHTË BASHKISË TIRANË**

### **H) Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.**

Mbledhja e kësaj takse realizohet nga strukturat e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, agjent tatimor që përfiton edhe 3% të shumës së arkëtuar.


Të dhënat për parashikimin e kësaj takse merren nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës e cila finalizon dhe evidenton të gjitha rastet e transkriptimit të pronës duke llogaritur detyrimin si për llojin e pronësisë por dhe vlerën e detyrimit mbi bazën e sipërfaqes së taksueshme.

Kështu detyrimi për banesat është në nivelin 1,000 lekë/m<sup>2</sup> dhe për objektet e biznesit është 2,000 lekë/m<sup>2</sup>. Numri i objekteve që transkriptohen është i lidhur ngushtë me lejet e shfrytëzimit të lëshuara nga njësitë vendore për objektet e përfunduara por dhe nga ALUIZNI për ato të legalizuara.

Ecuria në vite për këtë taksë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

në lekë

Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022	I pritshmi 2023
<b>Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme</b>	326,192,912	326,363,132	365,273,593	445,977,729	538,304,919	419,821,252



Bazuar në ecurinë faktike të viteve të kaluara, realizimin e të këtij viti dhe në informacionin nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, parashikimi për vitet 2024 – 2026, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026
<b>Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme</b>	480,000,000	480,000,000	480,000,000	480,000,000

### l) Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

E ardhura nga taksa, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (Drejtoria Rajonale Tiranë), para kryerjes së kontrollit teknik të detyrueshëm të mjetit, në zbatim të parashikimeve të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar.

Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësive të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore por e konvertuar në përqindje, në masën 25 % e të ardhurave të realizuara për çdo muaj nga agjentët tatimor të DPSHTRR.

Realizimi i të ardhurave nga taksa e mjeteve të përdorura nga viti 2018 deri në vitin 2023, paraqitet në tabelen e mëposhtme:

në lekë						
Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022	I pritshmi 2023
<b>Taksa vjetore e mjeteve të përdorura</b>	406,962,488	433,146,135	442,712,995	466,305,347	490,556,445	501,719,137



Parashikimi për vitet 2024 – 2026, paraqitet si vijon:

në lekë				
Lloji i të ardhurave	Plani 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026
<b>Taksa vjetore e mjeteve të përdorura</b>	450,000,000	490,000,000	490,000,000	490,000,000


## J) Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale që u takon Njësisë të qeverisjes vendore përfaqësojnë vlerën 2% e totalit të të ardhurave nga Tatimi mbi të ardhurat personale që arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Shpërndarja e të ardhurave të realizuara nga Tatimi mbi të ardhurat personale nga ana e MFE për vitet 2020 e në vazhdim është bërë duke marrë si bazë llogaritje përqindjen e numrit të banorëve për Bashkinë e Tiranës kundrejt numrit total të banorëve në vend.

në lekë

Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022	I pritshmi 2023
<b>Tatimi mbi të ardhurat personale</b>	0	0	115,736,351	153,892,321	175,245,014	229,619,950



Në parashikimet nga kjo taksë, ndryshimi në krahasim me parashikimet e mëparshme i atribuohet edhe mënyrës së shpërndarjes ndërmjet bashkive i të ardhurave të përgjithshme të njësive vendore nga Tatimi mbi të ardhurat personale. Ndërkohë që sipas parashikimeve fillestare ligjore shpërndarja do të duhej të bëhej sipas juridiksionit ku mblidhet taksa, për arsye të pamundësisë teknike, sipas MFE, shpërndarja është bërë në bazë të numrit të popullsisë të njësive vendore.

Bashkia e Tiranës, për vitet 2024–2026, nisur nga llogaritjet e përafërta mbi përkatësinë e pjesës takuese nga totali i parashikuar nga DPT prej 65,200 milionë lekë, pjesë e buxhetit të vitit 2024, ka parashikuar nivelin prej 250 milionë lekë të ardhurash për Bashkinë e Tiranës, si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026
<b>Tatimi mbi të ardhurat personale</b>	190,000,000	250,000,000	250,000,000	250,000,000

## TARIFA VENDORE

### K) Tarifa e pastrimit

Tarifës së Pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.


Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave mblidhet nga dy struktura, përkatësisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore për kategorinë e biznesit dhe “Ujësjellës – Kanalizime Tiranë” Sha për kategorinë familjarë.

Që prej vitit 2012 e në vijim tarifa e pastrimit mblidhet nga agjenti tatimor UKT sha, periudhë e cila shënon një rritje të ndjeshme të të ardhurave nga kjo tarifë, megjithëse jo në nivelin e kapacitetit. Si pasojë e reformimit të UKT sha, forcimit të administratës së institucionit dhe shtrirjes së kontrollit në të gjithë territorin e ri të Bashkisë së Tiranës në vitin 2023 taksa e pastrimit për familjarë ka arritur të ketë një ecuri mjaft pozitive duke shënuar nivelin më të lartë të arritur ndonjëherë nga kjo tarifë.

Paraqitja në vite e mbledhjes së këtyre të ardhurave është si më poshtë:

në lekë

Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022	I pritshmi 2023
<b>Tarifa e pastrimit Familjarë</b>	743,133,619	651,984,449	726,552,679	790,364,210	761,759,858	816,365,452




Lidhur me tarifën e pastrimit nga kategoria biznesi, vihet re një ecuri pozitive që tregon një ritëm në rritje të arkëtimeve në katër vitet e fundit, në sajë të mirë administrimit të saj nga strukturat e DPTTV.

E njëjta tarifë për kategorinë “Subjekte tregtare” paraqitet në tabelën dhe grafikun në vijim:

në lekë

Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022	I pritshmi 2023
<b>Tarifa e pastrimit Subjekte biznesi</b>	1,141,146,525	1,138,546,202	1,215,758,389	1,448,405,768	1,538,436,158	1,614,797,703



Parashikimi i të ardhurave nga subjektet e biznesit është mbështetur në kapacitetin e taksapaguesve që përfaqësojnë numrin e subjekteve aktive të evidentuara dhe nivelin e tarifës për vitin ushtrimor, në të ardhurat që trajtohen nga strukturat e DPTTV që do të kryejnë në kohë njoftimet e subjekteve për detyrimin por në veçanti do të ndjekin edhe mbledhjen e tyre. Për kategorinë familjarë parashikimi është bazuar në numrin e familjeve raportuar nga Agjenti tatimor.

Për vitin 2024-2026, parashikimi i arkëtimit të tarifës së pastrimit për kategorinë familjarë dhe subjektet tregtare, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Loji i të ardhurave	Plani 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026
<b>Tarifa e pastrimit</b>	<b>2,590,000,000</b>	<b>2,614,500,000</b>	<b>2,635,000,000</b>	<b>2,661,000,000</b>
- Familjarët	890,000,000	827,500,000	835,000,000	843,000,000
- Subjektet Tregtare	1,700,000,000	1,787,000,000	1,800,000,000	1,818,000,000

#### L) Tarifa për zënien e hapësirave publike

Tarifa për zënien e hapësirave publike llogaritet për sipërfaqen në m<sup>2</sup> të shfrytëzuar nga subjekti për ushtrimin e aktivitetit të indeksuar sipas zonës së vendndodhjes dhe nivelit të taksës për njësi të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Tarifa për zënien e hapësirave publike përbëhet nga:

- Zënia e hapësirës publike me kangjella, platforma, vazo, etj
- Zënia e hapësirës publike në tregjet publike.




- Zënia e hapësirës publike për organizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme.

Realizmi i kësaj tarife për vitin 2023 realizimi pritet të jetë në nivele të mira duke synuar të arrijmë në nivelet e para pandemisë.

në lekë

Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022	I pritshmi 2023
<b>Tarifa per zënie e hapësirave publike</b>	386,489,538	385,666,800	223,680,468	276,055,695	346,830,117	365,496,540



Parashikimi i të ardhurave të kësaj tarife për vitet 2024 - 2026, është si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026
Tarifa për zënie e hapësirave publike	<b>315,000,000</b>	<b>350,000,000</b>	<b>353,500,000</b>	<b>357,035,000</b>
Tarifa për zënie e hapësirave publike me platforma betoni, kangjella.	294,000,000	329,000,000	332,000,000	335,035,000
Tarifa për zënie e hapësirave në tregjet publike	21,000,000	21,000,000	21,500,000	22,000,000

### M) Tarifa e parkimit


Tarifa për parkimin e automjeteve në vend parkime publike përfaqëson pagesën e shërbimit që ofron Bashkia Tiranë për vendqëndrime të mjeteve kundrejt biletës, atyre të rezervuara dhe për taksitë e liçensuara.

Me qëllim evidentimin dhe ndjekjen operacionale të parkimit, territori i Bashkisë Tiranë është detajuar në zona tarifore sipas tipologjive, me qëllim vendosjen dhe vjeljen e tarifës së shërbimit të parkimit publik me pagesë – mbështetur në karakteristikat funksionale të tyre.

Arkëtimet nga tarifa e parkimit kanë shënuar trend rritës që nga fillimi i aplikimit të kësaj tarife me përjashtim të vitit 2020, vit i pandemisë, ku kufizimi i lëvizjes reduktoi dhe parkimin e automjeteve në rrugë e sheshe.

Realizimi në vite dhe pritshmëria për vitin 2023, paraqiten në tabelën si më poshtë:

Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022	në lekë I pritshmi 2023
<b>Tarifa per zenien e hapësirave publike</b>	454,788,832	469,401,688	400,015,660	498,689,407	530,063,937	575,379,837



Parashikimi i të ardhurave të realizuara nga tarifat e parkimit nga Tirana Parking për vitet 2024-2026 për parkimin në rrugë është bërë duke marrë parasysh numrin e subjekteve që parashikohet të përdorin shërbimet e parkimit sipas tipologjive;

Emërtimi i të ardhurave	Numër subjektsh
<b>Parkim me kontrate</b>	4,101
Taxi	1,000
Abonime	2560
Kontrata	541
<b><u>Parkim me Bileta</u></b>	<b><u>1828</u></b>
<b><u>Parkim me SMS</u></b>	<b><u>2,305</u></b>

Të ardhurat nga sektori i inspektimit në rrugë janë parashikuar të rriten me një normë 1% në vitin 2024 dhe përkatësisht me 2% dhe me 3% për vitet 2025 dhe 2026 si pasojë e faktorëve të mëposhtëm si:

- Shtimi i një metode të dytë alternative të pagesës së shërbimit të parkimit
- Shfrytëzimi më efikas i vendparkimeve aktuale

Në të njëjtën kohë është marrë parasysh vështirësia në realizim e të ardhurave që vjen si pasojë e dy faktorëve të mëposhtëm:

- Duke qenë se gjoba për mospagesën e tarifës së parkimit vendoset dhe arkëtohet nga Policia Bashkiake sjell vështirësi në realizimin e planit të parashikuar.
- Mosshfrytëzimi maksimal i vendparkimeve me pagesë për shkak të kantierëve të ndërtimeve, punimeve në rrugë dhe aktiviteteve.
- Reduktimi i rrugëve të Zonës A me potencial të lartë frekuentimi, për shkak të realizimit të projekteve të Bashkisë Tiranë.

Së dyti, synohet të mblidhen detyrimet e prapambetura nga subjektet që operojnë si “taksi” duke bërë të mundur rritjen e të ardhurave për vitin 2024 e në vazhdim.

Së treti, numri i abonimeve në sheshe i cili pretendohet të rritet me gati 4% duke marrë parasysh:

- Heqja e disa prej rrugëve me kapacitet të konsiderueshëm të vendparkimeve të Zonës A do të sjellë rritje të numrit të abonimeve.
- Tarifat e shërbimit të parkimit në rrugë dhe tarifat e ekonomike të shesheve të parkimit gjithashtu ndikojnë për rritjen e numrit të abonimeve në sheshe.

Së fundmi, duke marrë parasysh gjithë elementët e mësipërm dhe interesit të shprehur për kontrata të reja dhe rinovim të atyre ekzistuese nga subjektet private, edhe ky zë i të ardhurave të parashikuara nga Tirana Parking parashikohet të rritet me 3-4%.

Parashikimet për arkëtimin e tarifës së parkimit për vitet 2024 - 2026, paraqiten si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026
<b>Tarifa e parkimit te automjeteve</b>	<b>602,000,000</b>	<b>623,000,000</b>	<b>647,000,000</b>	<b>665,700,000</b>
Parkim me kontratë	165,000,000	170,000,000	177,000,000	184,700,000
Parkim me bileta	437,000,000	453,000,000	470,000,000	481,000,000

## N) Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime


Tarifa paguhet në masën 1% të vlerës së investimit, vetëm një herë për të njëjtin aplikim për leje zhvillimi, infrastrukture dhe ndërtimi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit. Siç mund të vihet re kemi një ulje të kësaj tarife në vitin 2022 pasi më parë kjo tarifë

paguhej për cdo aplikim pavarësisht se lidheshin me të njëjtin ndërtim objekti. Në vitin 2023 vlera e pritshme e realizimit vlerësohet të jetë në vlerën 502 milionë lekë duke marrë parasysh nivelin e lartë të ndërtimeve për vitin 2023.

Realizimi i të ardhurave nga kjo tarifë për periudhën 2018-2023 paraqitet si më poshtë:

në lekë

Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022	I pritshmi 2023
<b>Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime</b>	462,929,640	477,529,142	594,764,275	664,327,871	324,432,169	502,042,595



Parashikimi për tarifën e shqyrtimit e kërkesës për leje për punime për vitet 2024 – 2026 bazohet dhe lidhet me parashikimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja dhe sipas historikut kjo tarifë ka një përqindje prej 7-9% kundrejt kësaj takse, me paraqitjen si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026
<b>Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime</b>	255,000,000	450,000,000	480,000,000	480,000,000

## O) Të ardhura të tjera

Në të ardhurat e tjera përfshihen kryesisht të ardhura destinacioni i të cilave nuk identifikohet që në momentin e arkëtimit dhe shpërndahen në destinacionet përkatëse sipas rakordimeve që realizohen nga DPTTV. Gjithashtu këtu përfshihen edhe të ardhurat nga qeratë e ndërtesave dhe trojeve, të ardhura nga penalitete administrative apo gjoba të vendosura nga DPTTV apo strukturave të tjera si Policia Bashkiake, Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit, Agjencia për


Mbrojtjen e Konsumatorëve, etj. Parashikimi i tyre bazohet në trendin e realizimit të viteve të fundit.

## P) Të ardhura nga pagesat për kopshte, çerdhe e konvikte

Për fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet paguhet tarifa mujore, e cila përbëhet nga tarifa për ushqimin që llogaritet me tarifën ditore dhe ditët e frekuentimit të fëmijës gjatë një muaji. Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve në vitet e fundit kanë hasur në vështirësi në përballimin e shpenzimeve për ushqim duke qenë se çmimet e artikujve ushqimorë janë rritur dhe për këtë qëllim është kërkuar dhe rritja e tarifës së ushqimit për të dy nëndarjet; tarifa e ushqimit për kopshtë nga 160 lekë në ditë në vlerën 170 lekë në ditë dhe tarifa e ushqimit në çerdhe nga 130 lekë në 150 lekë në ditë. Në vlerat e parashikuara për arkëtim nga pagesat e tarifës për ushqim për të dy tipologjitë e institucioneve është marrë parasysh vlera e rimbursimeve për shtresat të cilat janë të përjashtuara nga tarifa e ushqimit.

në lekë

Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022	I pritshmi 2023
<b>Të ardhura DPÇK</b>	<b>188,452,835</b>	<b>203,445,619</b>	<b>139,884,930</b>	<b>216,992,553</b>	<b>241,513,594</b>	<b>288,264,162</b>
Pagesa për kopshtet	119,123,817	128,533,229	89,124,960	138,846,520	156,159,803	187,507,671
Pagesa për çerdhet	69,329,019	74,912,390	50,759,970	78,146,033	85,353,791	100,756,491



Parashikimi i të ardhurave për vitet 2024 – 2026 paraqitet si më poshtë vijon:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026
Pagesa për kopshtet e fëmijëve	230,000,000	255,000,000	255,000,000	255,000,000
Pagesa për çerdhet e fëmijëve	108,000,000	140,000,000	140,000,000	140,000,000

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve.

Të ardhurat e mbledhura nga pagesat e konvikteve të shkollave të mesme paraqiten si më poshtë:

në lekë

Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022	I pritshmi 2023
Pagesa për konviktet e Shkollave të mesme	6,744,125	6,103,881	4,572,310	4,777,298	9,745,085	12,000,150



Siç mund të vihet re të ardhurat nga pagesa për konviktet e shkollave të mesme kanë ardhur duke u rritur ne periudhën 2022 dhe parashikohet të arrij në nivelin 12 milionë lekë në fund të vitit 2023.

Parashikimi i të ardhurave nga pagesa për konviktet e shkollave të mesme, për vitet 2024 – 2026, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026
Pagesa per Konviktet e Shkollave te Mesme	7,000,000	7,800,000	8,000,000	8,200,000

## 6. PARASHIKIMET BUXHETORE AFATMESME 2024-2026


### 6.1. Transferta nga Buxheti i Shtetit dhe Fonde të mbartura

#### Transferta e Pakushtëzuar

Transferta e pakushtëzuar që buxheti qendror i transferon pushtetit vendor, përfshin fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme shpërndahet ndërmjet njësive të pushtetit vendor sipas formulës së paraqitur në ligjin nr.68 datë 27.04 2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit vjetor të buxhetit si dhe udhëzimeve plotësues.

Ecuria e transfertës së pakushtëzuar për Bashkinë e Tiranës për periudhën 2016 – 2024 paraqitet si vijon:

	Ne Leke								
Emertimi	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Transferta e pakushtezuar	1,531,458,969	1,913,119,744	2,138,631,000	2,348,723,419	2,424,942,357	2,438,116,570	2,523,450,650	3,008,634,292	3,732,529,694
Trendi i rritjes	13%	20%	11%	9%	3%	1%	3%	3%	19%



Transferta e pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit për vitin 2024, do të jetë në vlerën 3,732,529,694 lekë, me një rritje prej 19 %, krahasimisht me vitin e mëparshëm. Kjo transfertë përbën rreth 11% të buxhetit të planifikuar për vitin 2024.

Transferta e pakushtëzuar duhet t'i sigurojë Njësive të Qeverisjes Vendore diferencën mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur. Në vitin 2024, ashtu sikurse edhe në vitin 2023, transferta e pakushtëzuar do të përdoret për financimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale. Këtë vit buxhetor pjesë e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme është dhe fondi për rritjen e pagave për Bashkinë e

Tiranës të cilin nuk e kemi detajuar në buxhetin që po prezantojmë për ta bërë në një moment të dytë gjatë vitit 2024 në vijim të VKM-ve që priten të miratohen për ndryshime në shpenzimet e personelit.


### Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Funksionet e reja që iu transferuan bashkive në vitin 2016, me Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” si Transferta Specifike do të vazhdojnë të financohen edhe në buxhetin e vitit 2024 nëpërmjet Transfertës së pakushtëzuar sektoriale. Më konkretisht:

- Konviktet e arsimit para universitar
- Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH)
- Personeli mësimor dhe jo mësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jo mësimor në arsimin para universitar
- Rrugët rurale
- Administrimi i pyjeve
- Ujitja dhe kullimi
- Klubet sportive shumësportëshe , “Partizani” dhe “Studenti”

Ecuria e transfertës së pakushtëzuar sektoriale për Bashkinë e Tiranës për periudhën 2017 – 2024 paraqitet si vijon:


Emertimi	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	874,641,054	992,080,016	1,159,433,601	1,176,039,602	1,368,453,014	1,269,437,150	1,324,954,914	1,447,328,241
Trendi i rritjes		12%	14%	1%	14%	-8%	4%	8%



Transferta e pakushtëzuar sektoriale nga Buxheti i Shtetit për vitin 2024, do të jetë në vlerën 1,447,328,241 lekë, me një rritje prej 8 %, krahasimisht me vitin e mëparshëm. Kjo rritje është



rreth 3-4 % për cdo funksion të deleguar përveç funksionit të Klubeve sportive shumësportëshe “Partizani” dhe “Studenti”. Në transfertën e këtij viti janë përfshirë dhe fondet shtesë akorduar për të përballuar efektin financiar të pagave.



### **Transfertat e Kushtëzuara**

Fondet e kushtëzuara për financimin e funksioneve të deleguara, Bashkia e Tiranës nuk i miraton si pjesë përbërëse e buxhetit të njërive vendore, por reflektohen në dokumentin e realizimit të buxhetit, si fonde të administruara nga njësitë vendore. Sipas akteve ligjore në fuqi, funksione të deleguara në pushtetin vendor si dhe fonde të kushtëzuara që priten të akordohen në vijim si rezultat dhe i angazhimeve buxhetore janë si më poshtë:

*Shërbimi i gjendjes civile* si funksion i deleguar i detyrueshëm, parashikimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative bëhen nga bashkitë, në bazë të kuotave dhe udhëzimeve më të detajuara që bëhen nga Ministria e Brendshme. Numri i punonjësve dhe kuotat përkatëse për këtë funksion përcaktohen nga Ministria e Punëve të Brendshme.

*Përkrahja sociale*, si funksion i deleguar i detyrueshëm, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale detajon në fillim të vitit fondet për përkrahjen sociale për çdo njësi të qeverisjes vendore, në mënyrë specifike për ndihmën ekonomike dhe për pagesën e paaftësisë.

- o Subvencionimi i qirasë për familjet e prekura nga tërmeti
- o Projekti i ri për rikonstrukcionin e Kampusit të UT, për ndërtimin e Universitetit të Arteve, si dhe ndërtimin e Akademisë së Policisë së Tiranës.
- o Fondi i mbrojtjes civile
- o Godina e Teatrit të Tiranës
- o Për përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës (PPP)

## Parashikim Fonde të mbartura

Fondet e mbartura përfaqësojnë gjendjen në fund të vitit buxhetor të likuiditeteve të pashpenzuara brenda vitit, për arsye të ndryshme, dhe të cilat, sipas legjislacionit, trashëgohen për t'u përdorur në vitin pasardhës.

Në mbyllje të vitit 2023, Bashkia e Tiranës parashikohet të ketë një gjendje likuiditetesh të papërdorur, për t'u trashëguar në vitin 2024, në vlerën 10,000,000,000 lekë.

Arsyet që kanë ndikuar këtë nivel të fondeve të trashëguara janë si më poshtë:

1. Tejkalmi në realizimin e të ardhurave: Për vitin 2023, të ardhurat e Bashkisë së Tiranë janë me tejkalm kundrejt planit të miratuar. Deri në fundin e muajit Tetor të ardhurat janë tejkaluara në vlerën 1,671,945,000 lekë, 112 %. Pritshmëritë deri në fund të vitit janë që tejkalmi të ardhurave të jetë në vlerën 1,678,920,000 lekë.
2. Realizimi i ulët kryesisht për shpenzimet kapitale, ku arsyeja kryesore është rishikimi i kostove për objekte ekzistuese në buxhetin e vitit 2023, si pasojë e hyrjes në fuqi, gjatë muajit Nëntor 2023, të VKM-së Nr.216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të cmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Duke qenë në pritje të ndryshimeve në fjalë, procedurat e prokurimit nuk kanë vijuar gjatë pjesës së dytë të vitit 2023. E njëjta situatë është paraqitur edhe në vitin 2022, kur nëpërmjet Aktit Normativ Nr.10 datë 18.05.2022 për “Kompensimin financiar të çmimit për disa materiale ndërtimi, sipas përcaktimeve në kontratat publike për punë, si pasojë e situatës të veçantë të krijuar në treg gjatë vitit 2022”, u ndryshuan cmimet referencë për kostot e ndërtimit në kontratat publike dhe u paraqit nevoja për rishikimin e kostove të objekteve të planifikuara dhe si rrjedhim shtyrja e lidhjes së kontratave. Duhet mbajtur gjithashtu parasysh që, shpenzimet kapitale duke qenë zëri më me peshë në buxhetin vjetor, afektojnë drejtpërdrejt normën e përgjithshme të realizimit të buxhetit, dhe që, vecanërisht vitet 2022 dhe 2023 janë vitet me buxhetin më të madh të shpenzimeve kapitale. Konkretisht në vitin 2023 totali i shpenzimeve kapitale ka qenë në vlerën 14,623,115,152 lekë, rreth 41%. Për efekt ilustrimi, vlera e investimeve që janë objekt i rishikimit të kostove, të cilat do të miratohen me PBA 2024-2026 është 3,995,666,105 lekë. Për periudhën Janar–Tetor 2023 treguesit e realizimit të buxhetit janë në vlerën 45% nga të ardhurat dhe transfertat e përgjithshme dhe ajo sektoriale. Referuar një prognoze të kryer për muajt Nëntor – Dhjetor 2023 duke marrë në konsideratë dhe % e realizimit të dy mujorit të fundit të vitit të kaluar, pritet një realizim i buxhetit deri në 50 – 55 % të planeve të miratuara.
3. Diferenca mes fondit limit të planifikuar për objektet e investimeve dhe atij të kontraktuar. Kostot buxhetore të planifikuara në shumë raste tejkalojnë vlerën me të cilën përfundohet lidhja e kontratave, në varësi të ofertimeve. Për ilustrim, për investime të viteve 2022-2023, të cilat janë prokuruar dhe është vijuar me lidhjen e kontratave, vërehet që diferenca mes

buxhetimit dhe kontratës, është në vlerën rreth 1.8 mld lekë, e cila detyrimisht konsiderohet si e parealizuar në buxhet.

4. Trashëgimi nga vitet e mëparshme. Që prej 2019, realizimin faktik i buxheteve, është përfshirë në një rrjedhë jo të natyrshme, që lidhet me dy ngjarje madhore, emergjenca civile, ajo e pandemisë dhe tërmetit. Të dyja këto situata kanë impaktuar buxhetin e viteve 2019, 2020 dhe 2021, nga ku ka filluar në fakt të rritet gjendja e fondeve të trashëguara që deri në këtë moment ka qenë në një trend normal (jo më shumë se 10% e buxhetit total). Situata e pandemisë në vitin 2020, e shtrirë edhe në vitin 2021, fokusimi i vëmëndjes për realizimin me prioritet të programeve të rindërimit, gjatë këtyre viteve, kanë ndikuar në akumulimin e likuiditetit nga të ardhurat e veta, vit pas viti. Duhet përmendur gjithashtu, se të gjitha vitet e fundit, janë paraqitur me tejkalim të planit të të ardhurave, i cili lidhet më së shumti me taksën e ndikimit në infrastrukturë. Parashikimi i TNI me saktësi, është i vështirë, pasi lidhet me ngarkesën e aplikimeve, e cila nuk mund të parashikohet me saktësi. Nga ana tjetër parashikimi në nivele të larta na vendos përballë riskut të mosrealizimit të të ardhurave.
5. Për të gjitha arsyet e përmendura më sipër, të cilat do të afektojnë edhe periudhën në vijim, zëri “fonde të mbartura” është shtrirë për të gjithë periudhën e PBA-së, për të reflektuar një parashikim më realist të pritshmërisë tre vjeçare. Në këtë parashikim është marrë parasysh një normë mos-realizimi i shpenzimeve të planifikuara parimisht deri në 10%, duke konsideruar fondet e mbartura për vitin 2024, të cilat janë në një masë të konsiderueshme, por edhe arsye të tjera që mund të cojnë në mosrealizim.

## **6.2 PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE PËR PERIUdhËN 2024 -2026**

Shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2024 - 2026, për të gjitha funksionet parashikohen respektivisht në masën 33,439,539,639 lekë, 28,588,078,232 lekë dhe 25,758,833,783 lekë.

Në parashikimin e viteve buxhetorë është përfshirë edhe një pjesë e konsiderueshme e fondit që planifikohet të mbartet nga viti paraardhës. Fondet e mbartura në këtë fazë përfshijnë fondet e papërdorura në vitin respektiv nga të Ardhurat e Bashkisë Tiranë.

Shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë së Tiranës për vitet 2024-2026, parashikohen të ndara në formë tabelare dhe grafikut si më poshtë sipas kategorisë ekonomike dhe sipas klasifikimit funksional.


Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.

## Shpenzimet Totale te Bashkisë sipas Kategorive Ekonomike

Ne leke

Raport		Shpenzimet Totale te Bashkisë sipas Kategorive Ekonomike			PBA 2024-2026		
Shpenzimet e Bashkisë (Në Lekë)							
Emri I Artikullit	Kodi I Artikullit	2021 Fakt	2022 Fakt	2023 Plan	2024 Plan	2025 Plan	2026 Plan
<b>Paga dhe Sigurime</b>							
Paga	600	5,119,869,397	5,233,457,452	6,501,183,275	7,732,992,510	7,429,631,000	7,429,631,000
Sigurime Shoqërore & Shëndetësorë	601	817,927,820	872,670,011	1,034,304,169	1,281,266,104	1,280,212,000	1,280,212,000
<b>Korente</b>							
Mallra dhe Shërbime	602	6,307,091,740	7,024,982,491	7,166,781,987	8,379,805,591	8,225,328,063	8,355,487,845
Subvencion/Transferta te Brendshme	603/604	135,743,659	779,891,649	454,894,108	520,729,270	37,400,000	39,400,000
Fondi I Veçante	608	-	-	-	371,797,600	371,482,000	371,482,000
Transferta për Familje & Individë	606	252,987,346	595,191,999	399,520,000	638,500,000	810,500,000	614,500,000
Fondi Rezerve	609	-	-	340,000,000	440,000,000	440,000,000	440,000,000
<b>Shpenzime Kapitale</b>							
Aktive te trupëzuara	230	68,237,399	92,202,900	355,657,826	704,412,028	310,512,708	171,224,008
Aktive te trupëzuara	231	3,038,035,349	3,010,191,581	12,520,535,285	13,370,036,536	9,683,012,461	7,056,896,930
Transferimet Kapitale/huadhënie	232/255	132,000,000	195,000,000	-	-	-	-
<b>Totali</b>		<b>15,871,892,710</b>	<b>17,803,588,083</b>	<b>28,772,876,650</b>	<b>33,439,539,639</b>	<b>28,588,078,232</b>	<b>25,758,833,783</b>


### Shpenzime Totale BT sipas kategorive ekonomike



Shpenzimet Totale sipas Programeve Buxhetore:

Ne leke

KODI NËNFUNK.	KODI PROGR.	PROGRAMI	Fakt 2021	Fakt 2022	Buxheti 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
011	01110	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	2,870,602,313	2,979,888,456	4,239,061,896	4,528,188,894	4,015,936,399	3,793,634,480
	01120	Çështjet financiare dhe fiskale			-			
031	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	490,073,548	577,932,343	716,600,000	762,045,000	740,145,000	724,645,000
032	03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	298,002,267	238,810,481	1,421,623,284	348,386,375	252,930,000	252,930,000
041	04130	Mbështetje për zhvillimin ekonomik	165,436,159	88,787,206	752,474,179	741,340,242	921,900,638	636,594,235
042	04220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve	240,211,756	221,977,146	415,839,714	429,776,666	315,759,374	316,716,535
	4240	Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	20,068,549	24,231,094	58,669,015	23,851,233	23,851,233	23,851,233
	4260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	9,237,924	11,377,762	11,669,502	11,794,754	11,794,754	11,794,754
045	4520	Rrjeti rrugor rural	1,507,404,673	1,548,889,631	4,717,652,961	4,718,218,203	3,619,132,020	2,836,783,377
	4570	Transporti publik	178,980,087	500,621,894	815,656,868	886,708,040	784,984,252	682,014,052
051	05100	Menaxhimi i mbetjeve	2,024,635,327	2,396,267,159	2,652,199,916	2,916,889,090	3,088,260,395	3,230,929,665
061	06140	Planifikimi Urban Vendor	1,075,540,330	851,046,265	2,547,945,742	1,624,906,359	1,604,245,734	1,569,180,377
062	6260	Shërbimet publike vendore	2,607,736,083	2,662,897,414	6,329,348,386	5,063,803,118	4,886,260,056	3,813,950,950
081	08130	Sport dhe Argëtim	311,972,529	828,162,085	868,435,775	551,330,000	465,684,000	490,743,220
082	08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	457,183,339	675,710,913	1,296,004,192	873,536,572	654,852,594	566,363,000
091	09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.	1,881,445,164	2,145,362,354	3,728,062,250	3,664,905,309	3,706,991,069	3,504,747,886
092	09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	1,422,304,199	1,503,103,737	2,152,892,248	2,190,355,384	1,984,105,074	1,988,609,379
104	10430	Përkujdesi social	250,972,942	235,237,062	370,858,941	391,775,740	381,795,640	381,895,640
106	10661	Strehimi social	60,085,522	313,285,081	2,254,894,326	3,271,728,660	689,450,000	493,450,000
	04910	Fondi rezerve			510,627,564	300,000,000	300,000,000	300,000,000
	04940	Fondi I Kontigjences			40,000,000	140,000,000	140,000,000	140,000,000
		<b>Total</b>	<b>15,871,892,710</b>	<b>17,803,588,083</b>	<b>35,900,516,759</b>	<b>33,439,539,639</b>	<b>28,588,078,232</b>	<b>25,758,833,783</b>



### III.4.1 Shpenzime Kapitale

Për vitin 2024 fondi total për shpenzime kapitale është në shumën 14,074,448,563 lekë dhe zë 42 % ndaj totalit të shpenzimeve. Për vitet 2025 dhe 2026, buxheti i investimeve parashikohet respektivisht 9,993,525,168 lekë dhe 7,228,120,936 lekë. Për vitin 2024 peshën më të madhe e zënë shpenzimet kapitale për programet e Zhvillimit të Komunitetit, Transportit dhe Urbanistikës.

Tabela më poshtë paraqet fondin e shpenzimeve kapitale për vitet 2024-2026, sipas programeve buxhetore:

*Në Lekë*

Nr	Funksioni	Plan 2023	Plan 2024	% ne strukturë	Plan 2025	Plan 2026
1	Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme	282,723,627	306,642,396	2%	208,798,098	66,500,000
2	Shërbime policore	54,744,000	37,400,000	0%	15,500,000	-
3	Shërbime të mbrojtjes ndaj zjarrit	130,748,888	75,160,375	1%	-	-
4	Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës	215,969,660	558,159,268	4%	743,431,252	455,999,235
5	Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia	133,841,984	108,119,608	1%	-	-
6	Transporti	2,994,541,005	3,843,449,104	27%	3,055,021,301	2,159,176,611
7	Menaxhimi i mbetjeve ,Reduktimi i ndotjes,Mbrojtja e mjedisit	-	-	0%	-	-
8	Urbanistika	1,988,687,038	1,225,440,359	9%	1,187,779,734	1,152,714,377
9	Zhvillimi i komunitetit	3,903,873,349	3,164,711,118	22%	2,947,168,056	1,864,858,950
10	Shërbimet rekreative dhe sportive	24,806,395	25,100,000	0%	-	-
11	Shërbimet kulturore	143,499,850	201,558,572	1%	154,474,594	65,125,000
12	Arsimi bazë dhe parashkollor	760,285,857	1,006,675,900	7%	1,055,277,060	833,590,386
13	Arsimi parauniversitar	552,111,454	782,525,384	6%	626,075,074	630,156,379
14	Familja dhe femijet,Te moshuarit,Semundjet dhe paaftesia	3,512,820	9,227,820	0%	-	-
15	Strehimi Social	1,686,847,184	2,730,278,660	19%	-	-
16	Fondi rezerve	-	-	0%	-	-
17	Fondi i Kontigjences	-	-	0%	-	-
<b>TOTALI</b>		<b>12,876,193,111</b>	<b>14,074,448,564</b>	<b>100%</b>	<b>9,993,525,169</b>	<b>7,228,120,938</b>



### III.4.2. Shpenzime për Personelin

Në kuadër të përgatitjes së PBA 2024-2026, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj publikut dhe menaxhimit me efikasitet të burimeve njerëzore, bazuar në shtimin e funksioneve dhe kapaciteteve të punës, për institucionin e Bashkisë së Tiranës janë propozuar nga Institucionet në varësi të saj ndryshimet e mëposhtme strukturore si dhe kërkesat për shtesa në numër punonjësish si më poshtë vijon.

Më poshtë gjeni të pasqyruara shpenzimet e personelit për vitet 2022 – 2026 në mënyrë tabelare.

*Në Lekë*

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plan 2023	Plan 2024	% n strukturë	Plan 2025	Plan 2026
Shpenzime personeli	7,535,487,444	9,014,258,614	27%	8,709,843,000	8,709,843,000

Kërkesat gjithnjë e në rritje, problematikat por edhe sfidat që ndeshen për mirëmenaxhimin e territorit të qytetit të Tiranës si dhe zgjerimin e funksioneve të reja, kërkojnë rritjen e numrit të personelit në Aparatin e Bashkisë së Tiranës dhe disa prej njësive organizative në varësi të këtij institucioni.

Ky miratim është i nevojshëm duke marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- Rritjen e efikasitetit dhe e performancës së strukturave organizative.
- Përmirësimin e procedurave dhe respektimin e afateve procedurale.
- Përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve dhe rritjen e besueshmërisë ndaj institucionit.
- Koordinimin e administrimit territorial.
- Realizimin e plotë të objektivave.

Gjatë vitit 2024, me qëllim rritjen e cilësisë dhe menaxhimit sa më me efikasitet të burimeve njerëzore si dhe transparencën e administratës ndaj publikut, për t'i shërbyer sa më mirë këtij të fundit dhe për përfundimin e interesave maksimale, për institucionin e Bashkisë së Tiranës janë propozuar nga Institucionet në varësi të saj ndryshimet e mëposhtme strukturore si dhe kërkesat për shtesa në numër punonjësish si më poshtë vijon;

#### **Aparati i Bashkisë së Tiranës**

Si rezultat i zhvillimit e zgjerimit të veprimtarive të qytetit dhe shtimit të funksioneve ka qenë i domosdoshëm riorganizimi e shtimi i burimeve njerëzore të strukturës organike të Aparatit të Bashkisë.

*Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit* planifikon e menaxhon çështjet që lidhen me hartimin e politikave dhe strategjive që synojnë intensifikimin e jetës artistike, kulturore, sportive,

nxitjen e turizmit dhe trashëgimisë kulturore, përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës sportive, me qëllim intensifikimin e jetës artistike, kulturore dhe sportive.

Promovimi i turizmit dhe produkteve turistike të konsoliduara, përballimi i masivizimit të tij kërkon ngritjen e një sistemi eficient të formimit të vazhdueshëm profesional të burimeve njerëzore të angazhuara në turizëm si një sfidë serioze e një sistemi eficient i formimit profesional duke mundësuar përmirësimin e cilësisë së tyre.

*Drejtoria e Përgjithshme e Teknologjise së Informacionit Inovacionit dhe të Dhënave*, e cila merret me administrimin, grumbullimin e planifikimin e të dhënave të trajtuara me metodologji e softëare të rinj me qëllim arritjen e objektivave dhe kërkesave në rritje të vazhdueshme dhe përmbushjen e rezultateve të kërkuara nga kjo njësi organizative nëpërmjet përdorimit eficient dhe efikas të burimeve financiare dhe njerëzore të institucionit, ka të nevojshëm zgjerimin e kapaciteteve me burime njerëzore për, informatizimin e digjitalizimin e proceseve të punës në institucion.

Duke parë anën funksionale dhe organigramën e përgjithshme aktuale të Bashkisë së Tiranës janë propozuar ndryshimet strukturore si dhe shtesa për 20 punonjës në total, me qëllim rritjen e cilësisë dhe menaxhimit sa më me efikasitet të këtyre funksioneve

### **Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik,**

Bazuar në VKM nr. 600, datë 13.10.2021, "Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve", ku është miratuar kalimi i pronësisë së tyre nga Autoriteti Rrugor Shqiptar tek entet lokale, Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik i është ngarkuar mirëmbajtja e 14 segmenteve rrugore, nga të cilat 8 prej tyre shtrihen jo vetëm në zonat urbane, por edhe ato rurale. Ky proces kërkon angazhim maksimal për mirëmbajtje në të gjithë komponentët e infrastrukturës rrugore si; mirëmbajtje rrugësh të sistemit parësor, dytësor, rural, në skarifikim e mbushje të shtresave asfaltike, mirëmbajtje rruge me zall, sitemim, rikualifikim me pllaka, bordura, rampa, mirëmbajtje periodike të rrjetit të kullimit të ujrave të shiut, kunetave, ndriçimit publik, sinjalistikës, pastrimin e kanaleve kullues dhe vaditës dhe rehabilitimin e tyre në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë së Tiranës. Nisur nga shtimi i funksioneve e objektivave të punës, rritjen e sipërfaqeve për mirëmbajtje, shpërndarja e madhe gjeografike e zonave të veprimit të qytetit, krijimit të blloqeve të reja, bën të nevojshëm ndryshime strukturore dhe shtimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore me punonjës të rinj duke propozuar shtim me 50 punonjës.

### **Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike**

Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike mbulon funksionet në drejtim të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së objekteve publike, ku përfshihen mirëmbajtja e objekteve arsimore, bodrumeve dhe vendstrehimeve, shërbimi DDD (dezinfektim, deratizim, dezinfektim), administrimi i banesave sociale, ndjekja e procedurave të privatizimit të banesave shtetërore si dhe mirëmbajtja, lyerja dhe pastrimi i grafiteve të paautorizuara, figurave, reklamave apo ngjitjeve

me materiale të ndryshme në sipërfaqet e mbikalimeve, nënkalimeve dhe muret rrethues, janë shtuar objekte të tjera publike si dhe objekte arsimore të reja në juridiksionin e Bashkisë Tiranë. Përsa më sipër, si dhe nisur nga volumi i madh i punës dhe i rritjes së përgjegjësisë si rrjedhojë e ndryshimeve të vazhdueshme që kanë prekur zgjerimin e inventarit të objekteve të ndryshme arsimore dhe publike, propozohet shtesa për 22 punonjës në strukturën organike të institucionit si dhe shtesa për 25 punonjës mbështetës *nga funksionet e pakushtëzuara sektoriale*.

### **Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve**

Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve ka vijuar punën për vënien në funksion të Çerdheve me vendodhje në Lagjen nr. 14 dhe në Njësinë Administrative Ndroq, Çerdhen dhe Kopshtin “Ylberi” Shkozë, hapjes së shërbimit të plotë dhe me ushqim në institucionet arsimore parashkollore “Buzëqeshja e Artë”, Njësia Administrative nr.11; “Hojëzat” Njësia Administrative nr. 8; “Ishulli i Thesarit”, Njësia Administrative nr.2, rikonstruksionit dhe shtimit të kapaciteteve në shërbim të Kopshtit nr.41 “Luledielli”;

Në kuadër të marrjes së masave për funksionimin e shërbimit me kohë të plotë dhe me ushqim në këto institucione, mbulimit të nevojave për burime njerëzore (staf edukator dhe mbështetës në çerdhe dhe kopshte, staf psikosocial, mësues ndihmës, drejtues kopshti, përgjegjëse çerdhe, punonjës administrate), lind nevoja e rritjes së kapacitetve të burimeve njerëzore të strukturës organike në këtë institucion duke shtuar numrin e përgjithshëm të punonjësve si të Çerdheve dhe të Kopshteve që mbulohen nga *transferta pakushtëzuara sektoriale* dhe konkretisht është *propozuar shtesa prej 60 punonjësish në numrin e përgjithshëm të punonjësve të Çerdheve si dhe 53 punonjës nga funksionet e pakushtëzuara sektoriale*.

### **Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit,**

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka në administrim dhe mirëmbajtje parqet Në kuadër të investimeve të kryera nga Bashkia Tiranë, një park i ri, Parku në Liqenin e Farkës i është shtuar qytetit të Tiranës, i cili është i pajisur me shëtitore, biseda, bimësi të shtuar, ambjente të përshtatura për sporte ujore, çiklizëm, kënde force, etj.

Parku i Farkës ka një sipërfaqja totale 89.1 ha, nga kjo: sipërfaqe ujore 75 ha, sipërfaqe djerrë 4.5 ha, sipërfaqe e mbjellë 9.6 ha. Me fillimin e punës nga APR, sipërfaqja e mbjellë përreth perimetrit të gjurmës së pedonale në liqenin e Farkës ka shkuar në 14.1 ha, është investuar në gjatësi pedonale 7.3 km, duke e bërë parkun e dytë më të rëndësishëm, rritur ndjeshëm sipërfaqen e gjelbër dhe kthyer këtë park në një nga vendet më të frekuentuara të qytetit të Tiranës.

Aktualisht mirëmbajtja dhe shtimi i bimësisë në Parkun e Farkës është kryer nga Drejtoria e Gjelbërimit Dekorativ, por nga puna e përditshme është vlerësuar se është i domosdoshëm krijimi i një sektori të dedikuar vetëm për këtë park, sikundër Parku Rinia, apo Parku i Varrezave të Dëshmorëve. Për këto arsye propozojmë që në Drejtorinë e Administrimit të Parqeve Tematike, të shtohen 12 punonjës. Krijimi i këtij sektori do të mbulojë një sipërfaqe prej 14.1 ha,

ku janë mbjellë 34 560 drurë dhe shkurre, bimësi e cila ka nevojë për shërbime përfshirë këtu prashitje, vaditje, krasitje, plehërim, pastrim etj.

### **Agjencia e Shërbimeve Funerale**

Agjencia e Shërbimeve Funerale për arsye të shtimit të sipërfaqeve dhe infrastrukturës së re në varrezat e Sektorëve Tufinë dhe Sharrë kemi evidentuar nevojën për shtimin e punonjësve të pastrimit për mbulimin e këtyre sipërfaqeve shtesë.

Gjithashtu ASHF ka në administrim mirëmbajtjen e 13 Njësive Administrative të Bashkisë Tiranë, për të cilat ka aktualisht 2-3 punonjës për njësi. Gjatë ushtrimit të punës për mirëmbajtjen e këtyre varrezave është vënë re problematika e pamundësisë së realizimit të plotë të punës, pasi një Njësi Administrative mbulon disa varreza të copëzuara sipas fshatrave me distanca të konsiderueshme nga njëra-tjetra. Për sa më sipër, për të siguruar një shërbim sa më cilësor në mirëmbajtje dhe në shërbimin e varrimit kërkohet miratimi për një shtesë të numrit të punonjësve.

### **Tirana Parking**

Tirana Parking, ka si detyrë funksionale administrimin e shërbimit të Parkimit Publik me/pa Pagesë të Bashkisë së Tiranës, mbi tokë dhe nën tokë, në përputhje me zonat e përcaktuara për këtë qëllim.

Monitorimi dhe vlerësimi i situatës në rrugë, sheshe dhe terminale, konsiston në kufizimin e shërbimeve, si pasojë e shtimit të hapësirave për parkimin e automjeteve të orientuara në sheshe mbi/nën tokë, Kjo situatë, kërkon përmirësimin e performancës së shërbimeve aktuale, si dhe trajtimin e mangësive të identifikuar nëpërmjet zbatimit të strategjive funksionale.

Me qëllim, efektivitetin e punës, kthimin në kohë, ofrimit të shërbimeve me cilësi, nivel të lartë profesionalizmi dhe kompetence, ka paraqitur kërkesat për plotësimin e strukturës me burime të tjera njerëzore ku kërkohet të shtohen 20 punonjës.

Me zgjerimin e shesheve për parkim në qytetin e Tiranës, shtohet edhe përgjegjësia për mirëmbajtjen e tyre dhe zgjidhjen e problemeve rast pas rasti,, rehabilitimit në kohë të dëmtimit fizik të ambjentit, sigurimit të stabilitetit në marrëdhënie me qytetarët si dhe kontributit në ruajtjen e imazhit të këtij shërbimi,

Gjithashtu zgjerimi dhe shtrirja e Projektit të Rezidentit në të gjithë qytetin e Tiranës., duke qënë se, janë pajisur me sinjalistikë horizontale dhe vertikale 25 blloqe rezidenciale dhe aktualisht proceset e punës për mirëfunksionimin e këtij projekti mbulohe nga Sektori i Inspektimit në Rrugë. Zgjerimi i stafit me burime njerëzore lidhur me nevojat aktuale, si dhe sheshet që do të hapen në vijim, është nevojë e cila i përgjigjet me efektivitet procesit të punës në terren dhe favorizon vazhdimësinë normale të shërbimit të parkimit publik.

### **Agjencia e Administrimit të Tregjeve**

Aktiviteti i Agjencisë së Administrimit të Tregjeve konsiston në administrimin e tregjeve publikë të lëvizshme, tregjeve publikë e sezonal. si dhe në zbatimin e një sërë projekteve

Agjencia ka realizuar shtimn në numër të Tregjeve të Lëvizshëm, bazuar dhe në kërkesate të shumta nga ana e qytetarëve.

Mirëmbajtja e vazhdueshme e tregjeve dhe inspektimet e kryera me frekuencë kohore të përditshme, si dhe angazhimi e planifikimi i Agjencisë për të ndërtuar një treg të ri në një nga zonat e pa mbuluara si e restaurimi i një tregu ekzistues, kanë krijuar nevojën e zgjerimit të stafit të punonjësve.

Për realizimin e detyrave funksionale të projekteve brenda afateve dhe standarteve të kërkuara, vlerësohet se është e domosdoshme shtimi i 5 punonjësve.

### **Agjencia e Industrisë Kreative**

Agjencisë së Industrisë Kreative Tiranë i ka kaluar në administrim objekti i Kinema Agimit, në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 71, datë 12.07.2022 “Për kalimin në administrim të Agjencisë së Industrisë Kreative Tiranë.

Në vijim të zhvillimit të aktiviteteve dhe krijimit të ambienteve rekreative, të cilat do të ofrohen gjatë gjithë javës dhe me orare të zgjatura dhe organizimit të punës me turne kjo sjell kërkesën për shtesën e numrit të punonjësve, e cila do të ndihmojë në mbarëvajtjen e punës pranë kinema Agimit dhe do të gjenerojë të ardhura.

Për të realizuar mbarëvajtjen e aktiviteteve, të cilat po zhvillohen në këtë ambient jo vetëm gjatë gjithë ditës, por dhe në mbrëmje, si dhe edhe gjatë gjithë ditëve të javës (përfshirë fundjavën dhe ditët e pushimeve zyrtare) lind nevoja për organizimi të punës me turne. Si rezultat kjo sjellë një kërkesë për shtesë prej 4 punonjësish.

### **Klubi Sportiv Tirana**

Me qëllim përmirësimin e funksionimit, menaxhimit dhe administrimit, ngritjen e nivelit dhe performancës së sportistëve të Klubit Sportiv “Tirana”, propozohet ndryshimi i strukturës organike të Klubit Sportiv Tirana, që parashikon përmbushjes e misionit të këtij klubi duke synuar veprimtari me efikasitet dhe efikasitet, sistem menaxhimi dhe kontrolli efektiv, si dhe arritje të larta sportive.

Për këto arsye propozohet shtesa prej 3 punonjës në strukturën e Klubit Sportiv “Tirana”

### **Qendra Komunitare e Terrenit**

Qendra Komunitare e Terrenit ka për mision parandalimin dhe reduktimin e rasteve në situatë rruge përmes identifikimit proaktiv në terren, referimit, shoqërimin, ndihmën e menjëherëshme dhe koordinimin e veprimeve me strukturat përgjegjëse të sistemit të mbrojtjes dhe përkujdesit shoqëror për çdo rast të raportuar dhe identifikuar në situatë rruge në territorin e Bashkisë Tiranë.

Puna e stafit është e fokusuar në terren, 24/7 ditë të javës dhe punonjësit punojnë me 3 turne. Nga analiza e punës vazhdon të mbetet sfiduese menaxhimi efektiv i terrenit dhe rasteve apo shoqërimin e tyre në kohë drejt strukturave dhe largimit nga rruga. Prandaj del i nevojshëm shtimi i stafit për 15 punonjës.

#### **Qendra Komunitare "Për persona me aftësi të kufizuar"**

Shërbimet që ofrohen në këtë qendër përfshijnë një larmi programesh të hartuara për të përmbushur nevojat dhe interesat e frekuentuesve si dhe shërbimit të mbështetjes psiko-sociale për familjet që në përbërjen e tyre kanë PAK.

Qendra në sektorin e të rriturve frekuentohet nga 60 të rinjë çdo ditë dhe 20 të tjerë në listë pritje. Veç sektorit të të rriturve është dhe sektori i fëmijëve nën 13 vjeç ku aktualisht janë 50 raste që marrin shërbim dhe shpërndarja e punës ka nevojë për më shumë staf. Duke parë nevojën që paraqesin për trajtim këta fëmijë dhe të rinj nevojitet që të bëhet një shtesë për 2 punonjës në stafin e Qendrës sepse kërkesat për frekuentim të Qendrës Komunitare PAK janë në rritje.

#### **Qendra Sociale "Strehëza Tiranë"**

Qendra Sociale "Strehëza Tiranë", ka në fokus mundësimin i një strehe emergjente për të pastrehët e identifikuar në situatë rruge, akomodimin e përkohshëm (fjetje) për personat e në situatë rruge dhe në raste emergjence, sigurim të paketës së shërbimeve bazë: higjenë, muncë sociale, kujdes shëndetësor e psiko-social, sigurim i një mënyre jetese të shëndetshme e të pavarur për personat me aftësi të kufizuar

Në bazë të rritjes së aktivitetit të tyre dhe shtrirjes e zgjerimit të shërbimit për shtresat në nevojë, si dhe të rekomandimeve të Auditit të Brendshëm për riorganizimin e tyre propozohet të shtohet 1 punonjës në strukturën organike, me qëllim përmbushjen me efektivitet të misionit dhe detyrave e aktivitetit si dhe shtrirjes e zgjerimit të shërbimit për shtresat në nevojë.

#### **Qendra e Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit Tirana**

Qendra e Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit Tirana për një shpërndarje sa më të drejtë të ngarkesës së detyrave të punonjësve dhe një mbarëvajtje sa më të mirë të punës për secilin profil, si edhe në zbatim të rekomandimeve të auditit, kërkon një riorganizim të ri të personelit. Shtesa e propozuar në total është për 2 punonjës.

#### **Agjencia e Rinisë**

Agjencia e Rinisë administron procesin e shpërndarjes së kartës së studentit në qytetin e Tiranës. Në kuadër të Paktit për Universitetin, Agjencia e Rinisë është angazhuar për procesin e përgatitjes dhe lëshimit të Kartës së Studentit në përputhje me kërkesat ligjore.

Procedura e inventarizimit dhe rivlerësimit të pajisjeve elektronike sipas legjislacionit kërkon që pjesë e komisionit të inventarizimit, rivlerësimit dhe asgjësimit, të jetë një Specialist IT gjë që e bën të domosdoshëm shtimin në strukturën organike të Agjencisë së Rinisë për të evituar problemet lidhur me Kartën e Studentit, përfitimin e abonesë së studentit në kohë dhe

shërbimeve të tjera me çmime të reduktuara që përfitohen nëpërmjet saj.prandaj është propozuar shtesa për 1 punonjës.

Ndryshimet kanë sjellë rritjen e efekteve financiare dhe shpenzimeve të personelit për të gjitha institucionet të cilat janë reflektuar në planifikimin e artikujve 600 dhe 601 të buxhetit të vitit 2024.

### **III.4.3. Shpenzime Operative dhe të tjera**

Shpenzimet operative dhe të tjera janë parashikuar në shumën 19,365,091,074 lekë për vitin 2024, 18,594,553,063 lekë për vitin 2025 dhe 18,530,712,845 lekë për vitin 2026. Këto shpenzime përbëjnë 31% të totalit të buxhetit për vitin 2024 dhe përbëhen nga:

- Shpenzimet operative të aparatit të Bashkisë dhe institucioneve në varësi;
- Përdorimi i Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës;
- Transferta të tjera për individët

Fondi Rezervë do të përdoret për financimin e shpenzimeve që nuk mund të parashikohen gjatë hartimit të buxhetit, me vendime të Këshillit Bashkiak.

Fondi i Kontigjencës do të përdoret për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara të programeve egzistuese, në rast se do të jetë e nevojshme gjithmonë me miratimin e Këshillit Bashkiak.

Transfertat për individët përbëhen nga transfertat në mbështetje sociale të shtresave në nevojë si bonusi i strehimit, dëmshpërblime në raste fatkeqësish natyrore, stimuj ekselence, si ai për nxënësit e shkëlqyer dhe stimuj të tjerë si shporta e bebes , të cilat do të vazhdojnë të paguhen edhe gjatë vitit 2024.

Shpenzimet operative dhe të tjera për vitet 2024 - 2026 parashikohen sipas programeve buxhetore si më poshtë:

*Në Lekë*

Nr	Funksioni	Plan 2023	Plan 2024	% ne strukturë	Plan 2025	Plan 2026
1	Organet ekzekutive dhe legjislativ, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme	3,454,088,582	4,221,546,498	22%	3,807,138,301	3,727,134,480
2	Shërbime policore	640,100,000	724,645,000	4%	724,645,000	724,645,000
3	Shërbime të mbrojtjes ndaj zjarrit	209,219,000	273,226,000	1%	252,930,000	252,930,000
4	Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës	130,984,693	183,180,974	1%	178,469,386	180,595,000
5	Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia	290,869,078	357,303,045	2%	351,405,361	352,362,522
6	Transporti	1,582,392,780	1,761,477,139	9%	1,349,094,971	1,359,620,818
7	Menaxhimi i mbetjeve ,Reduktimi i ndotjes,Mbrojtja e mjedisit	1,934,948,672	2,916,889,090	15%	3,088,260,395	3,230,929,665
8	Urbanistika	366,800,000	399,466,000	2%	416,466,000	416,466,000
9	Zhvillimi i komunitetit	1,690,700,000	1,899,092,000	10%	1,939,092,000	1,949,092,000
10	Shërbimet rekreative dhe sportive	570,614,800	526,230,000	3%	465,684,000	490,743,220
11	Shërbimet kulturore	426,500,000	671,978,000	3%	500,378,000	501,238,000
12	Arsimi bazë dhe parashkollor	2,394,696,626	2,658,229,409	14%	2,651,714,009	2,671,157,500
13	Arsimi parauniversitar	1,215,100,000	1,407,830,000	7%	1,358,030,000	1,358,453,000
14	Familja dhe femijet,Te moshuarit,Semundjet dhe paaftesia	353,170,000	382,547,920	2%	381,795,640	381,895,640
15	Strehimi Social	296,499,308	541,450,000	3%	689,450,000	493,450,000
16	Fondi rezerve	300,000,000	300,000,000	2%	300,000,000	300,000,000
17	Fondi i Kontigjences	40,000,000	140,000,000	1%	140,000,000	140,000,000
<b>TOTALI</b>		<b>15,896,683,539</b>	<b>19,365,091,075</b>	<b>100%</b>	<b>18,594,553,063</b>	<b>18,530,712,845</b>



Në Lekë

Nr	Funksioni	Plan 2023	Plan 2024	% ne strukturë	Plan 2025	Plan 2026
1	Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme	3,736,812,209	4,528,188,894	14%	4,015,936,399	3,793,634,480
2	Shërbime policore	694,844,000	762,045,000	2%	740,145,000	724,645,000
3	Shërbime të mbrojtjes ndaj zjarrit	339,967,888	348,386,375	1%	252,930,000	252,930,000
4	Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës	346,954,353	741,340,242	2%	921,900,638	636,594,235
5	Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia	424,711,062	465,422,653	1%	351,405,361	352,362,522
6	Transporti	4,576,933,785	5,604,926,243	17%	4,404,116,272	3,518,797,429
7	Menaxhimi i mbetjeve ,Reduktimi i ndotjes, Mbrojtja e mjedisit	1,934,948,672	2,916,889,090	9%	3,088,260,395	3,230,929,665
8	Urbanistika	2,355,487,038	1,624,906,359	5%	1,604,245,734	1,569,180,377
9	Zhvillimi i komunitetit	5,594,573,349	5,063,803,118	15%	4,886,260,056	3,813,950,950
10	Shërbimet rekreative dhe sportive	595,421,195	551,330,000	2%	465,684,000	490,743,220
11	Shërbimet kulturore	569,999,850	873,536,572	3%	654,852,594	566,363,000
12	Arsimi bazë dhe parashkollor	3,154,982,483	3,664,905,309	11%	3,706,991,069	3,504,747,886
13	Arsimi parauniversitar	1,767,211,454	2,190,355,384	7%	1,984,105,074	1,988,609,379
14	Familja dhe femijet, Te moshuarit, Semundjet dhe paaftesia	356,682,820	391,775,740	1%	381,795,640	381,895,640
15	Strehimi Social	1,983,346,492	3,271,728,660	10%	689,450,000	493,450,000
16	Fondi rezerve	300,000,000	300,000,000	1%	300,000,000	300,000,000
17	Fondi i Kontigjences	40,000,000	140,000,000	0%	140,000,000	140,000,000
<b>TOTALI</b>		<b>28,772,876,650</b>	<b>33,439,539,639</b>	<b>100%</b>	<b>28,588,078,232</b>	<b>25,758,833,783</b>

Bilanci përmbledhës i të ardhurave dhe shpenzimeve të parashikuara për periudhën 2024 – 2026 paraqitet në tabelën si më poshtë në lekë:

	Emërtimi	Plan 2023	PARASHIKIMI 2024	Ne %	PARASHIKIMI 2025	PARASHIKIMI 2026
<b>I</b>	<b>Të ardhura të taksueshme</b>	<b>10,879,500,000</b>	<b>12,914,000,000</b>	<b>39%</b>	<b>12,954,395,000</b>	<b>12,039,017,000</b>
1	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	2,912,000,000	3,803,000,000	11%	3,646,000,000	3,690,000,000
a	Familjarët	712,000,000	868,000,000	0	876,000,000	885,000,000
b	Subjektet Tregtare	2,200,000,000	2,935,000,000	0	2,770,000,000	2,805,000,000
2	Taksa mbi token Bujqesore	32,500,000	34,500,000	0	34,845,000	35,200,000
3	Taksa mbi truallin	85,000,000	90,000,000	0%	90,900,000	91,809,000
4	Tatimi Thjeshtuar mbi Fitimin e BV	0	0	0%	0	0
5	Taksa e fjetjes në hotel	100,000,000	150,000,000	0%	157,500,000	165,375,000
6	Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	5,559,000,000	6,360,000,000	19%	6,500,000,000	6,500,000,000
7	Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtsh	480,000,000	480,000,000	1%	480,000,000	480,000,000
8	Taksa vjetore e mjeteve te perdorura	450,000,000	490,000,000	1%	490,000,000	490,000,000
9	Taksa mbi te ardhurat personale	190,000,000	250,000,000	1%	250,000,000	250,000,000
10	Taksa e tabelës	320,000,000	330,000,000	1%	333,300,000	336,633,000
a	Tabelë identifikuese/sinjalizuese	250,000	250,000	0%	250,000	250,000
b	Tabelë reklamuese	319,750,000	329,750,000	1%	333,050,000	336,383,000
11	Taksa e përkohëshme për infrastrukturen Arsimore	751,000,000	926,500,000	3%	971,850,000	0
	Familjarët	200,000,000	251,500,000	1%	276,600,000	0
	Subjektet Tregtare	551,000,000	675,000,000	2%	695,250,000	0
<b>II</b>	<b>Të ardhura jo tatimore</b>	<b>5,554,000,000</b>	<b>5,338,000,000</b>	<b>16%</b>	<b>5,416,500,000</b>	<b>5,464,935,000</b>
1	Tarifat	3,771,000,000	4,047,200,000	12%	4,125,500,000	4,173,735,000
a	Tarifa e pastrimit	2,590,000,000	2,614,500,000	8%	2,635,000,000	2,661,000,000
a.1	Familjarët	890,000,000	827,500,000	2%	835,000,000	843,000,000
a.2	Subjektet Tregtare	1,700,000,000	1,787,000,000	5%	1,800,000,000	1,818,000,000
b	Tarifa e parkimit te automjeteve	602,000,000	623,000,000	2%	647,000,000	665,700,000
b.1	Parkim me kontratë	165,000,000	170,000,000	1%	177,000,000	184,700,000
b.2	Parkim me bileta	437,000,000	453,000,000	1%	470,000,000	481,000,000
c	Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	255,000,000	450,000,000	1%	480,000,000	480,000,000
d	Tarifa dhenie licence tregtim karburanti +Lende djegese	0	0	0%	0	0
e	Tarifa për zënien e hapësirave publike	315,000,000	350,000,000	1%	353,500,000	357,035,000
e.1	Tarifa për zënien e hapësirave publike me platforma betoni,kangjella.	294,000,000	329,000,000	1%	332,000,000	335,035,000
e.2	Tarifa për zënien e hapësirave në tregjet publike	21,000,000	21,000,000	0%	21,500,000	22,000,000
f	Tarifa e sherbimit veterinar	0	0	0%	0	0
g	Tarifa sherbimi te MZSH	9,000,000	9,700,000	0%	10,000,000	10,000,000
2	Të ardhura të tjera	1,438,000,000	888,000,000	3%	888,000,000	888,000,000
a	Te ardhura nga qerate	48,000,000	48,000,000	0%	48,000,000	48,000,000
b	Te ardhura te institucioneve te varesise	190,000,000	240,000,000	1%	240,000,000	240,000,000
	Te ardhura te tjera (penalitetet administrative; te padetajuara; etj.)					
d	Kontributi i subjekteve private ne Fondin social	600,000,000	0	0%	0	0
3	Pagesa	345,000,000	402,800,000	1%	403,000,000	403,200,000
a	Per kopshtet e femijeve	230,000,000	255,000,000	1%	255,000,000	255,000,000
b	Per çerdhet e femijeve	108,000,000	140,000,000	0%	140,000,000	140,000,000
c	Per Konviktet e Shkollave te Mesme	7,000,000	7,800,000	0%	8,000,000	8,200,000
	<b>Shuma</b>	<b>16,433,500,000</b>	<b>18,252,000,000</b>	<b>55%</b>	<b>18,370,895,000</b>	<b>17,503,952,000</b>
	<b>Transferta e pakushtezuar e pergjithshme</b>	<b>3,008,634,292</b>	<b>3,732,529,694</b>	<b>11%</b>	<b>3,769,854,991</b>	<b>3,807,553,541</b>
	<b>Transferta e pakushtezuar sektoriale</b>	<b>1,324,954,914</b>	<b>1,447,328,241</b>	<b>4%</b>	<b>1,447,328,241</b>	<b>1,447,328,241</b>
	<b>Të ardhura të mbartura</b>	<b>8,000,000,000</b>	<b>10,000,000,000</b>	<b>30%</b>	<b>5,000,000,000</b>	<b>3,000,000,000</b>
	<b>Te ardhura te planifikuar nga donatoret</b>	<b>5,787,444</b>	<b>7,681,704</b>	<b>0%</b>		
	<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>28,772,876,650</b>	<b>33,439,539,639</b>	<b>100%</b>	<b>28,588,078,232</b>	<b>25,758,833,782</b>
<b>I.</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>15,556,683,539</b>	<b>18,925,091,075</b>	<b>1</b>	<b>18,154,553,063</b>	<b>18,090,712,845</b>
1	Personeli (Paga dhe Sigurime Shoqerore)	7,535,487,444	9,014,258,614	0	8,709,843,000	8,709,843,000
2	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	7,166,781,987	8,379,805,591	0	8,225,328,063	8,355,487,845
3	Subvencione/transferta te brendshme	454,894,108	892,526,870	0	408,882,000	410,882,000
4	Transferta per familje dhe individ	399,520,000	638,500,000	0	810,500,000	614,500,000
<b>II.</b>	<b>Fondi Rezervë, Kontigjenca</b>	<b>340,000,000</b>	<b>440,000,000</b>	<b>0</b>	<b>440,000,000</b>	<b>440,000,000</b>
1	Fondi Rezervë	300,000,000	300,000,000	0	300,000,000	300,000,000
2	Fond Kontigjenca	40,000,000	140,000,000	0	140,000,000	140,000,000
<b>III</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>12,876,193,111</b>	<b>14,074,448,564</b>	<b>0</b>	<b>9,993,525,169</b>	<b>7,228,120,937</b>
	Financim i Brendshëm	12,876,193,111	14,074,448,564		9,993,525,169	7,228,120,937
	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>28,772,876,650</b>	<b>33,439,539,639</b>	<b>100%</b>	<b>28,588,078,232</b>	<b>25,758,833,782</b>

Në pasqyrat më poshtë po prezantojmë planet e menaxhimit të dy risqeve që mendojmë se ndikojnë në realizimin e PBA 2024-2026 që janë mbartja e të ardhurave si dhe mosfunksionimi në mënyrë duhur të grupeve GMS dhe EMP.

## **7. PLANET E MENAXHIMIT TE RISQEVET QE NDIKOJNE NE PBA 2024-2026**

### **7.1 Analiza e Risqeve dhe masat parandaluese**

Me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.35 datë 06.04.2022, Bashkia e Tiranës ka miratuar planin e Integritetit për periudhën 2022-2025. Miratimi i Planit të Integritetit të Bashkisë Tiranë, pasqyron përkushtimin e Bashkisë për të hedhur themelet e një sistemi më të gjerë, që menaxhon risqet që kërcënojnë integritetin institucional.

Besueshmëria, mirëqeverisja e brendshme dhe integriteti, janë parimet kryesore të cilat garantojnë funksionim të qëndrueshëm të institucioneve publike. Integriteti është një koncept kyç në ndërtimin e një administrate publike vendore, efektive dhe cilësore. Konsolidimi i një sistemi efektiv të menaxhimit të integritetit në Bashkinë Tiranë, fillon me vullnetin e punonjësve për të forcuar integritetin institucional, me qëllim final, krijimin e një administrate publike të përgjegjshme, transparente dhe me integritet, e cila zgjon besimin e shoqërisë ndaj institucionit. Vullneti ynë për një administratë të tillë pasqyrohet edhe përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të politikave të vazhdueshme për integritetin, që nxisin dhe promovojnë etikën dhe sjelljet profesionale në institucion, transparencën e institucionit dhe pjesëmarrjen e publikut në veprimtarinë e bashkisë.

Bashkia Tiranë është e vendosur të rrisë nivelin e llogaridhënies, transparencës, efektivitetit të burimeve njerëzore, sjelljes dhe komunikimit, brenda dhe jashtë institucionit, duke rritur besimin publik.

Plani i veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në institucion, i cili përfshiu masa të reja kontrolli apo përmirësimin e masave ekzistuese të cilat përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e tyre i hap rrugë procesit të menaxhimit të riskut në tërësi, sidomos atij lloj risku që lidhet me objektivat e PBA-së.

Në kuadër të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, "Risk" është mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar, e cila do të ndikonte negativisht në arritjen e objektivave afatshkurtra, afatmesme dhe strategjike të bashkisë.

Analiza dhe trajtimi i risqeve është puna më domethënëse dhe më frytdhënëse gjatë hartimit të dokumentave bazë të funksionimit të bashkisë (Rregullorja e brendshme, manualët e procedurave të punës, plani i përgjithshëm vendor dhe/ose strategji afatgjatë, programi buxhetor afatmesem, etj), si dhe me tej gjatë zbatimit dhe monitorimit të tyre. Konkretisht në këtë dokument, kur themi

“Objektiva”, i referohemi objektivave afatmesme 2024- 2026 (PBA) të cilat përkthehen deri në plane vjetore operacionale të drejtorive të bashkisë. Menaxhimi i këtyre risqeve në vetvete do të thotë të identifikosh, vlerësosh dhe kontrollosh ato situata të cilat ndikojnë negativisht deri në arritjen e objektivave vjetore të secilës drejtori të bashkisë. Pra menaxhimi i drejtuar me rezultate/produkte me fokus në risk është instrumenti kryesor që con në arritjen e objektivave vjetore dhe më tej.

Bashkia e Tiranës si çdo institucion tjetër i qeverisjes vendore dhe qendrore ka një sistem të vendosur të Menaxhimit dhe Kontrollit, të cilin përpiqet vazhdimisht për ta përmirësuar në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi. Sipas raportit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për Parlamentin publikuar në 2023, Bashkia e Tiranës renditet e 5-ta midis 61 bashkive të vendit sa i takon nivelit të efektivitetit të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit deri në fund të vitit 2022. Treguesit e performancës së buxhetit dhe menaxhimi i risqeve mbeten fushat më të vështira brenda kornizës së kontrollit të brendshëm për bashkinë. Kjo do të thotë që vëmendja kryesore e çdo hallke drejtimi dhe çdo funksion kontrolli duhet të fokusohet në menaxhimin e punës dhe kërkesën e llogarisë mbi bazën e risqeve të identifikuara më parë, dhe mbi të gjitha në parashikimin realist të të ardhurave të bashkisë, përdorimin me efektivitet të fondeve vendore dhe menaxhim sa më të mirë të situatave financiare.

Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve të integritetit në Bashkinë, është bërë sipas fushave funksionale të bashkisë, duke patur në konsideratë proceset dhe nënproceset kryesore të punës. Në tërësinë e tij, menaxhimi i integritetit të Bashkisë, paraqet sfida të cilat hasen më së shumti në fusha të veçanta të përgjegjësisë, të tilla si: fusha e menaxhimit financiar, menaxhimi i burimeve njerëzore, menaxhimi i pronave të bashkisë, shërbime publike si edhe planifikimi i territorit. Disa prej tyre konsistojnë në: rregullimi i ulët normativ i proceseve; paqartësi rreth proceseve dhe procedurave; linjave të hierarkisë dhe raportimit; kapacitete njerëzore të pamjaftueshme dhe të kufizuara teknike në shumicën e proceseve të punës; mbingarkesa e punës;; infrastruktura fizike dhe pajisjet e pamjaftueshme në bashki etj.

Në pasqyrat më poshtë po prezantojmë planet e menaxhimit të dy risqeve që mendojmë se ndikojnë jo vetëm në planifikimin por dhe në realizimin e PBA 2024-2026 që janë mbartja e të ardhurave si dhe mangësitë në funksionimin e grupeve GMS dhe EMP.

	<b>Numri i Referencës së Riskut</b> <i>(programi buxhetor/kategoria e riskut/ numri kronologjik)</i>	<b>PBA. FMO - 1</b>
<b>IDENTIFIKIMI I RISKUT</b>	<b>KATEGORIA E RISKUT</b>	Financiar, Menaxherial, Operacional
	<b>PROGRAMI BUXHETOR</b>	Programi Buxhetor Afatmesëm në tërësinë e tij
	<b>OBJEKTIVI I POLITIKES SE PROGRAMIT</b>	Planifikim i nje buxheti sa më eficient, konkret dhe në funksion të realizimit të qëllimit të politikave afatgjata.
	<b>NGJARJA E RISKUT</b>	<b>Mbartja e të ardhurave të papërdorura nga një vit në tjetrin.</b>

	<p style="text-align: center;"><b>SHKAKU I RISKUT</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tejkalim i realizimit të të ardhurave,</li> <li>• Realizimi i ulët kryesisht për shpenzimet kapitale, ku arsyeja kryesore është rishikimi i kostove për objekte ekzistuese në buxhetin e vitit 2023, si pasojë e hyrjes në fuqi, gjatë muajit Nëntor 2023, të VKM-së Nr.216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të cmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.</li> <li>• Diferenca mes fondit limit të planifikuar për objektet e investimeve dhe atij të kontraktuar. Kostot buxhetore të planifikuara në shumë raste tejkalojnë vlerën me të cilën përfundohet lidhja e kontratave, në varësi të ofertimeve.</li> <li>• Trashëgimi nga vitet e mëparshme. Që prej 2019, realizimi faktik i buxheteve, është përfshirë në një rrjedhë jo të natyrshme, që lidhet me dy ngjarje madhore, emergjenca civile, ajo e pandemisë dhe tërmetit.</li> <li>• Tejkalim të planit të të ardhurave, i cili lidhet më së shumti me taksën e ndikimit në infrastrukturë. Parashikimi i TNI me saktësi, është i vështirë, pasi lidhet me ngarkesën e aplikimeve, e cila nuk mund të parashikohet me saktësi. Nga ana tjetër parashikimi në nivele të larta con në risk të mosrealizimit të të ardhurave.</li> </ul>
	<p style="text-align: center;"><b>NDIKIMI / PASOJA</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mos realizim 100% i buxhetit</li> <li>• Objektiva të realizuara pjesërisht për bashkinë.</li> <li>• Vështirësi për planifikim investime të reja .</li> </ul>
<p><b>ANALIZA E RISKUT</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>MASAT EKZISTUESE TE KONTROLLIT</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në mënyrë periodike monitorohet realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të Bashkisë dhe bëhen vlerësime në baze të ecurisë së evidentuar</li> <li>• Në bazë të realizimit të buxhetit dhe raporteve 4 mujorë që dorëzohen jo vetëm pranë Këshillit Bashkiak por dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, duke argumentuar arsyet, kërkohen ndryshime në buxhet kryesisht për zëra që nga strukturat përgjegjëse mendohet që nuk do realizohen si dhe duke përfshirë në buxhet investime apo shpenzime të reja.</li> <li>• Njoftim i gjithë strukturave përgjegjëse mbi udhëzimet apo masat e nevojshme që duhen ndjekur mbi afatet e prokurimit apo dhe ndryshimeve në buxhet.</li> </ul>
	<p style="text-align: center;"><b>Mundësia (1-5)</b></p>	<p><i>Për shkak se fenomeni ka ndodhur 5 vitet e fundit, por është ndikuar nga situatë e jashtëzakonshme, si</i></p>

		<i>dhe nga ndryshime në tregjet ndërkombëtare, mundësia e përsëritjes së të cilave është e ulët, për peridhën në vijim risku vlerësohet I ulët. 2 – Pak e mundur të ndodhë</i>
	<b>Pasoja (1-5)</b>	Duke qenë se risku kërkon bashkëpunim mes drejtuesve të programeve, NZ dhe kryetarit pasoja është e moderuar 3 – Pasoja te vogla
	<b>Rezultati</b>	$M * P = (2 \times 2) = 4$
<b>VLERESIMI</b>	<b>Prioriteti i Riskut</b>	<b>I ULET</b>
	<b>Përshtatshmëria e masave ekzistuese</b>	Nëse proceset nuk zbatohen apo zbatohen pjesërisht, duhen masa trajtuese dhe korrektuese.
	<b>REAGIMI NDAJ RISKUT (Veprimi)</b>	Masa parandaluese rregullatore si dhe masa që do duhet të reduktojnë pasojat nëse ndodh risku.
<b>MENAXHIMI / MASAT PER TRAJTIMIN / MINIMIZIMIN E RISKUT</b>	<b>MASAT SHITESHE PER TRAJTIMIN E RISKUT Plani i Veprimit (aktivitetet + afat)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësim i procesit të menaxhimit të flukseve të parase, që përfshin cdo informacion paraprak dhe faktik si persë i perket të ardhurave ashtu edhe për shpenzimet. <b>Afat</b> <u>në mënyrë periodike.</u></li> <li>• Hartimi dhe miratimi i procesi standard të menaxhimit të cashit/flukseve të parasë me përgjegjësi për secilën strukturë të Bashkisë Tiranë. <b>Afat</b> : <u>brenda 6-mujorit të parë 2024.</u></li> <li>• Caktim i një kordinatori/ sektori që të menaxhojë cashin jo vetëm për aparatet e Bashkisë por për të gjithë Bashkinë. <b>Afat</b> : <u>brenda 6-mujorit të parë 2024.</u></li> <li>• Monitorim i regjistrit të prokurimit të Bashkisë Tiranë dhe institucioneve në varësi të saj. <b>Afat</b> : <u>cdo muaj.</u></li> <li>• Trainim profesional për kostimin e aktiviteteve dhe produkteve të shërbimeve vendore, komunikimin e jashtëm/qasjen me komunitetin/komunikimin e brendshëm/monitorimin, etj të anëtarëve të GMS-së dhe EMP-ve, dhe realizimi i ëorkshop-eve me MFE dhe Ministrinë e Pushtetit vVendor. <b>Afat</b> I <u>vazhdueshem</u></li> </ul>
	<b>BURIMET E KERKUARA</b>	Burime ekzistuese dhe asistencë teknike nga ASPA në bashkëpunim me ekspertë të jashtëm.
	<b>PRONARI I RISKUT Administratori i Riskut</b>	Kryetari /NA i deleguar Administratori /raportuesi i riskut: Nëpunësi Zbatues i Bashkisë.
	<b>SHPESHTESIA E RAPORTIMIT</b>	Monitorim mujor
	<b>DATA E PERFUNDIMIT</b>	Trajtim i vazhdueshëm për masat cdo cikël planifikim buxheti

	<b>LIDHJA ME STRUKTURA / INSTITUCIONE TE TJERA</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtoria e te ardhurave</li> <li>- Drejtoria e Buxhetit</li> <li>- Drejtoria e Financës</li> <li>- Drejtoritë e Bashkisëe dhe Institucionet e Varësisë</li> <li>- Drejtoria e Auditit</li> <li>- Ministria e Financave dhe Ministria e Pushteti Vendor</li> </ul>
	<b>GJENDJA E RISKUT PAS ZBATIMIT TE MASAVE</b>	Niveli i riskut i synuar pas realizimit të masave të propozuara dhe zbatimit të këtyre masave është risk i ulët.

	<b>Numri i References së Riskut</b> <i>(programi buxhetor/kategoria e riskut/ numri kronologjik)</i>	<b>PBA.SRF -2</b>
<b>IDENTIFIKIMI I RISKUT</b>	<b>KATEGORIA E RISKUT</b>	Strategjik, Rregullator, me pasoja Financiare
	<b>PROGRAMI BUXHETOR</b>	Programi Buxhetor Afatmesëm në tërësinë e tij
	<b>OBJEKTIVI I POLITIKES SE PROGRAMIT</b>	Planifikim i një buxheti sa më eficient, konkret dhe në funksion të realizimit të qëllimit të politikave afatgjata.
	<b>NGJARJA E RISKUT</b>	<b>Mosfunksionim efektiv i grupeve të GMS-ve dhe EMP-ve</b>
	<b>SHKAKU I RISKUT</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e koordinimit ndërmjet EMP-ve GMS-së, NA-së dhe NZ-së në lidhje me prioritetet e strukturës/njesisë në kuadrin e hartimit të kërkesave buxhetore referuar programeve që mbulojnë.</li> <li>• Mungesa e azhornimit në kohë apo mungesa e trainimit për zbatimin e VKM-ve të cilat sjellin ndryshime në vlerat, koston e shpenzimeve që afektojnë planifikimin.</li> <li>• Mungesa e komunikimit dhe e dokumentimit ndërmjet anëtarëve të EMP-së të materialeve të nevojshme për procesin e PBA-së (planet/strategjite afatgjata, raportet e monitorimit, nevojat aktuale të komunitetit, statusi i projekteve/kontratave të realizuara dhe në proces, kostimi i aktiviteteve deri tek produkti, etj.)</li> <li>• Anëtarët e EMP dhe Drejtuesi i programit nuk diskutojnë rregullisht statusin e kërkesave buxhetore në faza të ndryshme të planifikimit, hartimin e deklaratës së politikës dhe produktet e programit me kostot respektive.</li> <li>• Pasojat jane ne reaksion zinxhir dhe komplekse me shtrirje afatgjate, duke perfshire riskun e mosrealizimit financiar dhe</li> </ul>

		<p>mospërbushjen e objektivave perballë qytetareve.</p>
	<b>NDIKIMI / PASOJA</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• .Mosperfshirje ose planifikim jo i sakte i kostove ne buxhet i investimeve, sherbimeve apo shpenzimeve ne funksion te komunitetit.</li> <li>• Pakënaqësi në komunitet.</li> <li>• Mosrealizim i objektivave të bashkisë.</li> <li>• Mosrealizim i buxhetit në mënyrë efektive</li> </ul>
<b>ANALIZA E RISKUT</b>	<b>MASAT EKZISTUESE TE KONTROLLIT</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktualisht ne bashkine tone referuar dhe Kalendarit të programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor te miratuar ne fund te vitit buxhetor per vitin pasardhes, me Urdhërin Nr. 13988, datë 05.04.2023 “Për ngritjen e grupit për menaxhim strategjik” Kryetari i Bashkisë ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik i cili është përgjegjës për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të planifikimit për Bashkinë Tiranë, si dhe me Urdhërin Nr. 13989, datë 05.04.2023 “Për ngritjen e ekipeve të menaxhimit të programeve” Kryetari i Bashkisë ka ngritur grupet e menaxhimit të programeve për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026.</li> <li>• Përvec diskutimeve apo vendimeve që merren gjatë takimit të anëtarëve të grupeve të sipërcituara, Kryetari I Bashkisë Tiranë zhvillon një herë në javë takim me të gjithë drejtorët e përgjithshëm të institucionit ku diskutohet mbi objektivat, realizimet, problematikat e hasura në kuadër të realizimit të buxhetit e më tej.</li> </ul>
	<b>Mundësia (1-5)</b>	<i>Per shkak se fenomeni ka ndodhur te pakten nje here ne vit, por po merren masa për tu përmirësuar, (pra mundësia mbetet e larte 3 – ka mundësi të ndodhë</i>
	<b>Pasoja (1-5)</b>	Duke qene se risku kerkon bashkepunim mes dretjueve te programeve, NZ dhe kryetarit pasoja eshte e moderuar 3 – Pasoja te moderuara
	<b>Rezultati</b>	$M * P = (3 \times 3) = 9$
	<b>R E S</b>	<b>Prioriteti i Riskut</b>



	<b>Përshtatshmëria e masave ekzistuese</b>	Nese proceset nuk zbatohen apo zbatohen pjeserisht, duhen masa trajtuese dhe korrektuese.
	<b>REAGIMI NDAJ RISKUT (Veprimi)</b>	Masa parandaluese rregullatore si dhe masa qe do duhet te reduktojne pasojat nese ndodh risku.
<b>MENAXHIMI / MASAT PER TRAJTIMIN / MINIMIZIMIN E RISKUT</b>	<b>MASAT SHITESE PER TRAJTIMIN E RISKUT Plani i Veprimit (aktivitet + afat)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Grupet e GMS-se dhe EMP-ve te ngritura me urdher Kryetari te funksionojne duke ushtruar pergjegjesite e tyre jo vetem te hartohen per te qene konform legjislacionit ne fuqi. <b>Afati Vazhdimisht</b></li> <li>Hartimi dhe miratimi i manualit te procedures me pergjegjesi te qarta, per te orientuar anetaret e GMS-se, EMP-ve dhe GMR, si te realizojne nje komunikim efektiv midis tyre dhe me Drejtorine e Buxhetit, ku te perfshihen gjithë etapat si nje procedure standarde pune qe duhet te ndiqet ne te tilla raste nga te gjitha strukturat pergjegjese. <b>Afati brenda dy muajve nga miratimi i Planit te riskut.</b></li> <li>Trainim profesional per kostimin e aktiviteteve dhe produkteve te sherbimeve vendore, komunikimin e jashtem/qasjen me komunitetin/ komunikimin e brendshem/monitorimin, etj i anetareve te GMS-se dhe EMP-ve, dhe realizimi i ëorkshopeve me MFE dhe Ministrine e pushtetit vendor. <b>Afati Viti i pare pas miratimit te planit dhe i vazhdueshem</b></li> <li>Krijimi i nje sistemi/databaze ku te hidhen te dhenat sipas instrumentit te buxhetit afatmesem dhe risqeve, duke krijuar mundesine e aksesimit nga nje perfaqesues i cdo drejtorie ose drejtues EMP/GMS, NZ ne menyre qe te thjeshtohet procesi dhe nderkohe mundesia e marrjes se te dhenave referuar udhezimeve te planifikimit do te jete me e mire. <b>Afati Fillim viti 2024.</b></li> </ul>
	<b>BURIMET E KERKUARA</b>	Burime ekzistuese dhe asistence teknike nga ASPA në bashkëpunim me ekspertë të jashtëm.
	<b>PRONARI I RISKUT Administratori i Riskut</b>	Kryetari dhe Keshilli Bashkiak/NA Administratori /raportuesi i riskut: Kryetari i GMR dhe/ose Koordinatori I GMS
	<b>SHPESHTESIA E RAPORTIMIT</b>	Referuar kalendareve qe do duhet te miratohen ne mbledhjet e GMS-se dhe EMP-ve.
	<b>DATA E PERFUNDIMIT</b>	Trajtimi I vazhdueshem per masat cdo cikel planifikimi buxheti
	<b>LIDHJA ME STRUKTURA / INSTITUCIONE TE TJERA</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtoria Juridike</li> <li>- Drejtoria e Buxhetit</li> <li>- Drejtoria e Finances</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtoria e Auditit per rekomandimet e dhena lidhur me permiresimin e kontrollit te brendshem dhe anetaresine ne GMS dhe GMR.</li> <li>- Drejtorite e Bashkise</li> <li>- Ministria e Financave dhe Ministria e Pushteti Vendor</li> </ul>
	<b>GJENDJA E RISKUT PAS ZBATIMIT TE MASAVE</b>	Niveli i riskut i synuar pas realizimit të masave të propozuara dhe zbatimit të këtyre masave është risk i ulet.

### Tabelat e Referencës për Analizën e Riskut

#### Kriteret e matjes së Mundësisë dhe Pashjës

Mundësia per ndodhjen e riskut	Piket	Kriteret	Probabiliteti
Pothuajse e sigurte	5	Pritet te ndodhe. Patjeter qe ndodh kete vit ose gjate tre viteve te ardhshme	80% to 100% ose disa here gjate nje viti
Me shume mundesi	4	E presim te ndodhe. Do te ishte surprize qe te mos ndodhi.	61% to 79% ose te pakten nje here ne vit
Ka mundesi te ndodhe	3	Po aq e mundur te ndodhi sa edhe jo. Nuk presim te ndodhe por ka nje mundesi.	40% to 60% ose nje here ne 3 vjet
Pak e mundur te ndodhi	2	Nuk është parashikuar. Nuk ka vend per tu shqetesuar	11% to 39% ose nje here ne 5 vjet
Pothuaj e sigurte s'ndodh	1	Do ishte surprize nese ndodh. Do te ishte nje kombinim i ngjarjeve te padeshiruara qe do ta shkaktonin (zakonisht katastrofat & pandemite).	0 to 10% ose nje here ne 10 vjet

Pasoja nese ndodh risku	Piket	Kritere/ Shembuj
Katastrofike	5	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Problem i Madh prej te cilit nuk ka rimekembje;</li> <li>- Demtim i madh i integritetit ose emrit te mire te bashkise;</li> <li>- Humbje totale e aftesise per te plotesuar objektivin.</li> </ul>
Te medha	4	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Ngjarje qe kerkon rishikim te menyres se si eshte kryer sherbimi;</li> <li>- Ngjarje e rendesishme qe kerkon periudhe te gjate rimekembjeje;</li> <li>- Deshtim i permbushjes se nje angazhimi te rendesishem politik.</li> </ul>
Te Moderuara	3	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rimekembja nga ngjarja kerkon bashkepunim midis drejtorive dhe/ose njesive vartese;</li> <li>- Mund te gjeneroje interesin e medias, donatoreve dhe publikut</li> </ul>
Te vogla	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mund te trajtohet ne nivel drejtorie/njesie vartese por kerkon nje njoftim tek Kryetari, Menaxhimi i larte;</li> <li>- Vonese fondesh ose ndryshim ne kriteret e financimit;</li> <li>- Mbjajtje shenim nga Kryetari, Keshilli bashkiak ose palet e treta qe lidhen me te.</li> </ul>
Te paperfillshme	1	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mund te vepohet se brendshmi dhe ne nivel zyre; - Nuk ka pershalleezim te metejshem. - Nuk ka interes nga media.</li> </ul>

### Matrica e Analizës së Risqeve

MUNDËSIA E NDODHJES	5	I ULET	I MESEM	I LARTE	EKSTREM	EKSTREM
	4	I ULET	I MESEM	I LARTE	I LARTE	EKSTREM
	3	I ULET	I MESEM	I MESEM	I LARTE	I LARTE
	2	I ULET	I ULET	I MESEM	I MESEM	I MESEM
	1	I ULET	I ULET	I ULET	I ULET	I ULET
		1	2	3	4	5
		PASOJA E NDODHJES				

**Legjenda:**

Rezultati: M x P

1 deri 5 I Ulet

6 deri 10 I Mesem

12 deri 16 I larte

20 deri 25 Ekstrem

## 7.2 Parashikimi i Planit të Arkës për vitin 2024

Buxheti i vitit 2024 i Bashkisë së Tiranës është planifikuar nga të ardhurat e veta, donatori, transfertat e pakushtëzuar sektoriale e përgjithshme akorduar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë si dhe parashikimit të fondeve që mbarten në fund të vitit 2023.

Në pasqyrën më poshtë po japim një informacion mbi planin paraprak të arkës të të hyrave dhe të dalave sipas llojit të burimit të financimit dhe sipas klasifikimit ekonomik. Ndarja e grantit në 4 tremujorë është bërë në bazë të % që përcaktohen çdo vit në udhëzimet e zbatimit të buxhetit ndërsa të ardhurat janë ndarë sipas parashikimit të mbledhjes së tyre gjatë vitit.

Parashikimi Fiksistë parës - Viti 2024													
Mbarëte - Fonde të përditura 2023 (te ardhura+donatore)													
Gjendje Cash (fillim muaji)													
Të hyrat 2024													
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Te ardhura nga taksat	796,200,000	880,900,000	1,258,800,000	2,402,000,000	991,600,000	1,150,700,000	952,200,000	876,800,000	883,300,000	1,056,300,000	817,500,000	867,700,000	12,914,000,000
Te ardhura nga tariflat	209,893,000	260,939,000	415,678,000	1,009,400,000	295,950,000	283,720,000	224,320,000	250,780,000	304,650,000	332,350,000	221,450,000	237,870,000	4,047,200,000
Te ardhura të tjera	83,000,000	77,000,000	75,000,000	69,000,000	74,000,000	73,000,000	80,000,000	78,000,000	74,000,000	69,000,000	68,000,000	68,000,000	888,000,000
Pagosa kopshtie, çerdhe, konnkte të shkollave të më	33,800,000	32,800,000	35,800,000	38,000,000	39,100,000	27,800,000	25,500,000	18,100,000	32,700,000	38,700,000	40,900,000	39,600,000	402,800,000
Transferita të pakushtëzuara 2024	1,553,957,381	-	-	1,294,964,484	-	-	1,191,367,225	-	-	1,139,568,746	-	-	5,179,857,935
<b>Total të hyrat mujore</b>	<b>2,678,850,381</b>	<b>1,251,639,000</b>	<b>1,785,078,000</b>	<b>4,813,364,484</b>	<b>1,400,650,000</b>	<b>1,535,220,000</b>	<b>2,473,387,225</b>	<b>1,223,680,000</b>	<b>1,294,650,000</b>	<b>2,615,918,746</b>	<b>1,147,850,000</b>	<b>1,213,170,000</b>	<b>23,431,857,935</b>
Të dësat 2024													
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Shpenzime personale	1,194,406,653	580,000,000	580,000,000	1,095,338,878	580,000,000	580,000,000	1,035,711,767	580,000,000	580,000,000	1,015,898,212	580,000,000	612,903,104	9,014,258,614
Shpenzime operative	775,741,645	583,898,064	702,245,231	1,063,118,037	450,000,000	550,000,000	769,068,594	650,000,000	700,000,000	657,760,890	950,000,000	2,500,000,000	10,350,832,461
Shpenzime kapitale	483,809,083	550,000,000	850,000,000	1,036,507,569	1,322,968,638	1,765,116,490	1,510,212,818	1,300,000,000	1,197,707,305	1,058,126,661	1,500,000,000	1,500,000,000	14,074,448,564
<b>Total të dësat mujore</b>	<b>2,453,957,381</b>	<b>1,713,898,064</b>	<b>2,132,245,231</b>	<b>3,194,964,484</b>	<b>2,352,968,638</b>	<b>2,895,116,490</b>	<b>3,313,993,179</b>	<b>2,530,000,000</b>	<b>2,477,707,305</b>	<b>2,731,785,763</b>	<b>3,030,000,000</b>	<b>4,612,903,104</b>	<b>33,439,539,639</b>
<b>Gjendje (fund muaji)</b>	<b>10,230,574,704</b>	<b>9,768,315,640</b>	<b>9,421,548,409</b>	<b>11,039,948,409</b>	<b>10,087,629,771</b>	<b>8,727,733,281</b>	<b>7,887,127,427</b>	<b>6,580,807,427</b>	<b>5,397,750,122</b>	<b>5,281,883,104</b>	<b>3,399,733,104</b>	<b>0</b>	<b>-</b>